



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË
PËRPUTHSHMERISË SË
VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE.

SPITALI RAJONAL KORÇË

SHTATOR 2019

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 211/1 prot, datë 18.04.2019, i ndryshuar me nr. 211/2, datë 27.05.2019.

Auditimi është kryer nga:

1. S. H. përgjegjës grupi
2. B. Sh. anëtar
3. E. S. anëtare
4. M. H. anëtar

Auditimi ka filluar më datë 22.04.2019.

Auditimi ka përfunduar më datë 28.06.2019.

Periudha e auditimit 01.01.2017 - 31.12.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Ky Raport Auditimi mbështetet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4100. 149. b), të INTOSAI, Pranuar dhe Sanksionuar në Rregulloren e Brendshme të KLSH, dhe strukturuar në “Udhëzuesin për Auditimin e Përputhshmërisë”, botim i KLSH, 2013, Kreu II, Pika 9, 149 b), ii.

Përmbajtja.

Emërtimi	Faqe
Përmbledhje	3-11
Hyrje	12-15
Qëllimi dhe procesi i auditimit	
Rezultatet e auditimit, nga të cilat:	
A. Mbi planifikimin dhe vlerësimin e riskut.	15-20
B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit dhe në Ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, me ndryshimet e tij, Ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”.	20-36
C. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.	36-90
D. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	90-93
E. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.	93-97
F. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dita, sponsorizime, etj).	97-108
G. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	108-109
III. Gjetjet dhe rekomandimet .	109-124
V. Anekset.	125-131

Përmbledhje

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi përputhshmërinë e aktivitetit të Spitalit Rajonal “Teni Konomi” Korçë (këtu e në vazhdim SRK), me periudhë veprimtarie 01.01.2017 deri më datë 31.12.2018, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, në administrimin e vlerave materiale e monetare, në prokurimin e fondeve publike etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Nga auditimi i kryer për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin që u vu në dispozicion grupit të auditimit, u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi, të cilat paraqiten si më poshtë:

A. Mbi planifikimin dhe vlerësimin e riskut.

Në zbatim të pikës A, të programit të auditimit “Mbi planifikimin dhe vlerësimin e riskut”, duke u fokusuar në planifikimin dhe identifikimin e riskut, strategjinë dhe vlerësimin e riskut si dhe identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

-Në Spitalin Rajonal Korçë ka një mangësi të theksuar të njohjes së Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pasi ky Ligj nuk është vënë në funksionim, dhe për pasojë nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë ku drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Për planifikimi dhe identifikimin e riskut, nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për përcaktimin e strategjisë dhe vlerësimi i riskut u identifikuan klasat e transaksioneve dhe kontroleve kyçe konkretisht, (A) mbi transaksionet e Spitalit Rajonal Korçë, ku u aplikuan:

- teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizuan menaxhimi financiar dhe kontrolli);

Në gjykimin e audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin; dhe
- ✓ Pësia specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit dhe në ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e Shtetit të vitit 2017”, me ndryshimet e tij, ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”.

Nga SRK në hartimin dhe planifikimin e projektbuxhetin për vitet 2017, 2018. Nga grupi i punës nuk është analizuar dhe detajuar në mënyrë të hollësishme përlllogaritja në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime mbështetur në kërkesën e MSH. Në relacion nuk është përshkruar gjëndja e detyrimeve të palikujduara në fillim të vitit dhe ecuria e shlyerjes së tyre si dhe nuk është përshkruar as planifikimi i të ardhurave detyësore të SRK. Lidhur me shpenzimet për “barna dhe materiale mjekësore” të cilat tre vitet e fundit janë rritur ndjeshëm nuk është bërë asnjë detajim ose analizë në hartimin e PB. Nga ana tjetër konstatohet realizimi i shpenzimeve në një shumë më të vogël sesa ajo e paraqitur në PBA e cila është e kushtëzuar nga çelja paraprake. Vlerat të cilat janë shpenzuar në buxhetin e vitit 2018 për të cilat nuk është planifikuar në fillim të vitit ose është planifikuar shumë më tepër nga se është realizuar. Nga këto diferenca të realizuara konstatohet një planifikim jo i saktë i nevojave të vitit të prishëm buxhetor si pasojë e ndryshimit të niveleve të realizimit. Planifikimi kryhet në bazat e një përqindje të caktuar në rritje në krahasim me shpenzimin faktik të vitit të kaluar.

-Nga ana e Spitalit Rajonal “Teni Konomi” Korçë mbi bazën e pasqyrave dhe analizën e Projekt Buxhetit është kryer kërkesë sipas artikujve:

Mbi realizimin dhe zbatimin e buxhetit për vitet 2017/2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

-Fondi i çelur për vitin 2017 është në shumën 565,800,000 lekë sipas zërave :shpenzime personeli 319,200,000 lekë, Shpenzime kontribute 53,300,000 lekë, mallra shërbime 193,300,000 lekë si dhe ka pasur çelje e fondit shtesë në shumën 63,650,000 lekë.

Investimet për vitin 2017 është çelur fondi në shumën 30,630,000 lekë.

Në zbatim të buxhetit për vitin 2017 nuk ka detyrime të mbartura nga viti 2016 dhe nuk lë detyrime për vitin 2018.

-Fondi i çelur për vitin 2018 është në shumën 614,250,000 lekë sipas zërave: shpenzime personeli 368,300,000 lekë, shpenzime kontribute 60,950,000 lekë, mallra dhe shërbime 185,000,000 lekë si dhe ka pasur çelje e fondit shtesë në shumën 5,000,000 lekë.

Investimet për vitin 2018 është çelur fondi në shumën 177,390,937 lekë. Fondet për investimet për periudhën objekt auditimi janë përdorur për rikonstruksionin e Maternitetit të spitalit.

Mbi afatet e përdorimit të barna të skaduara në jo më pak se 12 muaj për rrjedhoj pranimi i barnave në shkelje të afateve të përcaktuar në kontratë të cilat nga verifikimi në farmaci rezultuan të skaduara përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 235,800 lekë.

Në zbatim të buxhetit për vitin 2018 ka mbetur detyrime për vitin 2019 në shumën 31,023,000 lekë në 22 kontrata dhe 4 procese gjyqësore sipas zërave si mëposhtë:

(1013019) Nr. kontratave 1;	Lëndë djegëse	8,752,800 lekë
(1013019) Nr. kontratave 13,	Medikamente	9,525,870 lekë
(1013019) Nr. kontratave 4,	Materiale mjekimi	4,354,620 lekë
(1013019) Nr. kontratave 1,	Filma skaneri	552,780 lekë
(1013019) Nr. kontratave 2,	Ushqime	907,626 lekë
(1013019) Nr. kontratave 1,	Të ndryshme	25,300 lekë

Proceset gjyqësore:

1. Medikamente me përmbaues (V. Z.) çështje e vitit 2011	4,501,403 lekë
2. Mjekun anatopatholog R.B., me përmbaues (A. S.)	404,400 leke
3. Mjekun B. I., përmbaues (S. Ç.)	454,263 lekë
4. Juristen V. D. përmbaues (B. S.)	200,000 lekë

C. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

-Ndryshe nga Spitalet e tjerë në Spitalin Rajonal Korçë furnizimi me medikamente, kite reagen e materile mjekimi dhe pranimi i tyre kryhet me devijime të vogla, gjithashtu nga verifikimi i gjëndjes së barnave në farmaci dhe sasitë e skaduar për periudhën objekt auditimi vlera e medikamenteve të skaduara në këtë institucion paraqitet në vlerën 235,800 lekë dhe për këto është nxjerr urdhëri për dëmshpërblim nga grupi i marrjes në dorzim. Për vitin 2017 buxheti i miratuar për këtë zë është 90,721,817 ndërsa për vitin 2018 paraqiten në vlerën 67,426,450 lekë të shpenzuara dhe 15,981,804 të mbetur debitorë ose në total 83,408,254 lekë ose 9% më pak se viti 2017. Nga ana e grupit të auditimit është audituar 56,122,807 lekë të investimeve për vitin 2017 dhe 101,019,900 lekë për vitin 2018 ku 53,915,472 lekë e zënë investimi në furnizim vendosje paisjesh mjeksore ose 45% e totalit të shpenzimeve janë audituar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

-Në lidhje me auditimi i zbatimit të kontratës nr. 341 prot, datë 07.03.2018, lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë “V. S.” SHPK, me objekt “Shërbim me roje private Spitali Korçë”, me vlerë 1720 lekë/ditë për roje ose 20,089,600 lekë si vlerë totale e kontratës pa TVSH, me afat shërbimi nga 01.03.2018 – 31.03.2019, u konstatua se:

Nga verifikimi i listë pagesave punonjësit e ofrimit të shërbimit të rojeve në Spitalin Rajonal Korçë paguhen me 36,000 lekë në muaj pagë bazë pa përfshirë shtesat e përcaktuara për këtë pozicion pune ku sipas ofertës dhe kontratës duhet të paguheshin me 50,146 lekë pagë në muaj.

Operatori ekonomik “V. S.” ka përfituar padrejtësisht 14,146 lekë në muaj nga secili punonjës shërbimi dhe në total **shumën e pagave bruto prej 5,432,064 lekë** për 32 punonjës për 12 muaj të papaguara ndaj punonjësve.

Për pasojë operatori ka shmangur detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për pagat e papaguara në shumën **1,515,264 lekë**, si dhe detyrimin për Tatimin mbi të ardhurat personale në shumën **705,792 lekë**, vlera të cilat përbëjnë shmangie të detyrimeve dhe **dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit**.

-Në lidhje me kontratën e furnizimit nr. 955 prot., datë 17.08.2018 midis operatorit ekonomik “O. D.” përfaqësuar nga znj. O. J. dhe Spitalit Rajonal Korçë përfaqësuar nga titullari z. A. K. në zbatim të procedurës së prokurimit nr. REF-Nr 376 datë 08.05.2018 zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë për furnizim vendosje të pajisjeve mjeksore nga verifikimi i zbatimit të kontratës u konstatua se: Kontrata midis palëve e lidhur më 17.08.2018 me vlerë 5,582,450 lekë pa TVSH ose 6,698,940 lekë me TVSH është nënshkruar me një afat realizimi kontrate prej 45 ditësh duke filluar më 03.09.2018 dhe afat përfundimi 18.10.2018 u konstatua se:

-Nga furnizimi përtej afateve të parashikuara në kontratë nr. 955 prot., datë 17.08.2018 dhe në shkelje të nenit nr. 3 afati i kontratës i cili është 45 ditë me afat përfundimi 18.10.2018 si dhe në mos llogaritjen e penaliteve në respektim të nenit 5 “kushtet e kontratës” ku citohet: *...Në rast se kontraktuesi vonon furnizimin sipas kërkesave të institucionit atëhere detyrohet të paguaj penalitet në vlerën 1,451,235 lekë.*

-Ofrimi i produkte pa asnjë origjinë dëshmuuese e vërtetuese për origjinalitetin e tyre, mungesa e tyre në katalogun e produkte të kompanisë prodhuese të deklaruara nga “O. D.” dhe mos identifikimi të asnjë të dhëne për origjinalitetin e tyre nga prodhuesi, nisur dhe nga fakti se janë për përdorim spitalore dhe ofrimi i produkteve pa asnjë garaci në cilësinë e tyre **përbën dëm e konomik për buxhetin e shtit në vlerën 1,751,448 lekë** dhe duhen zëvendësuar me produktet e kërkuara dhe deklaruara.

-Në lidhje me kontratën e furnizimit nr. 1569/1 prot., datë 02.10.2018 midis operatorëve ekonomik “B. A.” përfaqësuar nga z. A. K. dhe “M.” Shpk përfaqësuar nga z. S. L. me Spitalit Rajonal Korçë përfaqësuar nga titullari z. A. K. në zbatim të procedurës së prokurimit nr. REF-Nr 376 datë 08.05.2018 zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë për “Furnizim vendosje të pajisjeve mjeksore dhe hotelerie për godinën e maternitetit të Spitalit Korçë dhe kirurgjinë e re dhe patologjinë e Spitalit Sarandë” nga verifikimi i zbatimit të kontratës u konstatua se: Kontrata midis palëve nr. 1569/1 e lidhur më 02.10.2018 me vlerë 14,259,600 lekë pa TVSH ose 17,111,520 lekë me TVSH, është nënshkruar me një afat realizimi kontrate prej 45 ditësh duke filluar nga data e nënshkrimit dhe afat përfundimi 16.11.2018 u konstatua se:

-Nga furnizimi me vonesë në mosrespektim të kontratës nr. 1569/1 datë 02.10.2018 neni 2 i saj, Afati i lëvrimit ku në pikën 2.4 citohet: *Nëse furnizuesi vonon lëvrimin e mallit në depon e blerësit , përtej afateve kohore të përcaktuara në kontratë, do ti paguaj blerësit penalitet prej 4/1000 të vlerës*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

së mallit të pa lëvruar për çdo ditë vonesë, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës. Nga llogaritja e ditë vonesave për furnizimi nga operatori ekonomik atij i lind detyrimi ndaj SRK në vlerën $3,564,900(25\% \text{ i kontratës}) \times 4/1000 \times 17 \text{ ditë vonesë} = \mathbf{242,413 \text{ lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik, dhe duhet pagaur nga operatori ekonomik “M.”}$

-Në lidhje me kontratën e furnizimit nr. 1570/1 prot datë 02.10.2018 midis operatorëve ekonomik “B. A.” përfaqësuar nga z. A. K. dhe “M.” SHPK përfaqësuar nga z. S. L. me Spitalit Rajonal Korçë përfaqësuar nga titullari z. A. K. në zbatim të procedurës së prokurimit nr. REF-Nr 376 datë 08.05.2018 zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë për furnizim vendosje të pajisjeve mjeksore dhe hotelerie për godinën e maternitetit të Spitalit Korçë dhe kirurgjinë e re dhe patologjinë e Spitalit Sarandë” nga verifikimi i zbatimit të kontratës u konstatua se: Kontrata midis palëve nr. 1570/1 e lidhur më 02.10.2018 me vlerë 25,087,510 lekë pa TVSH ose 30,105,012 lekë me TVSH, është nënshkruar me një afat realizimi kontrate prej 45 ditësh duke filluar nga data e nënshkrimit dhe afat përfundimi 16.11.2018.

-Nga furnizimi me vonesë në mosrespektim të kontratës nr. 1570/1 datë 02.10.2018 neni 2 i saj, Afati i lëvrimit ku në pikën 2.4 citohet: *Nëse furnizuesi vonon lëvrimin e mallit në depon e blerësit , përtej afateve kohore të përcaktura në kontratë, do ti paguaj blerësit penalitet prej 4/1000 të vlerës së mallit të pa lëvruar për çdo ditë vonesë, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.* Nga llogaritja e ditë vonesave për furnizimi nga operatori ekonomik atij i lind detyrimi ndaj SRK në vlerën **401,400 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik, dhe duhet pagaur nga operatori ekonomik “B.”**

-Nga furnizimi me vonesë në mosrespektim të kontratës nr. 1570/1 datë 02.10.2018 neni 2 i saj, Afati i lëvrimit ku në pikën 2.4 citohet; *Nëse furnizuesi vonon lëvrimin e mallit në depon e blerësit , përtej afateve kohore të përcaktura në kontratë, do ti paguaj blerësit penalitet prej 4/1000 të vlerës së mallit të pa lëvruar për çdo ditë vonesë, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.* Nga llogaritja e ditë vonesave për furnizimi nga operatori ekonomik atij i lind detyrimi ndaj SRK në vlerën $6,271,877 (25\% \text{ i kontratës}) \times 4/1000 \times 14 \text{ ditë vonesë} = \mathbf{351,225 \text{ lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik, dhe duhet pagaur nga operatori ekonomik “M.”}$

Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Riparim, mirmbajtje të automjeteve për nevojat spitalore, të spitalit Korçë”, për vitin 2017 rezultoi se: Në riparimin e mjeteve u konstatuan shpenzimet riparimi të pa parashikuara në shumën 335,040 lekë, vlerë e cila përbën shpenzime të pa justifikuar, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

6-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *“Shërbim i rojeve private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 6 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dhe dy ndërtesa me kamera” me fond limit 15,768,893 lekë* zhvilluar në vitin 2017 u konstatua se për 1 vendroje me një turn është llogarit më tepër vlera **122,847 lekë pa TVSH** e cila përbën efekt financiarë negativ për buxhetin e shtetit.

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *“Shërbim i rojeve private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 6 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dhe dy ndërtesa me kamera” me fond limit 20,118,566 lekë* zhvilluar në vitin 2017 u konstatua se për 1 vendroje me një turn është llogarit më tepër vlera **310,626 lekë pa TVSH** e cila përbën efekt financiarë negativ për buxhetin e shtetit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

-Në procedurën e prokurimit me objekt **“Furnizim me lëndë djegëse për ngrohje Biomase (pellet)”** për vitin 2017 me fond limit prej 7,336,000 lekë pa TVSh, u konstatua se:

Spitali rajonal Korçë kryen procedure e blerjes së lëndës djegëse pellet së bashku me marrjen me kontratë Huapërdorimi të kaldajës për djegien e pelletit. Nga auditimi i specifikimeve teknike për paisjen “Kaldajë” dhe “bruçatorë” u konstatua se nga hartuesit e specifikimeve teknike dhe nga njësia e prokurimit janë hartuar dhe miratuar specifikime teknike për keto dy paisje në kundërshtim me ligjin për prokurimin public duke kufizuar konkurrencën .

Për periudhë Prill –Tetor nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është llogaritur qiraja për zënia e hapsirës nga ana e kladajave në referencë të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për dhënie me qira ose efiteozë të pasurive shtetrorë”, sipërfaqja e zënë sipas inventarit të pronave 75 m² x 150lek/m² = 11,250 lekë x 7 muaj= **78,750 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit **“Blerje Medikamentesh për nevojat Spitalore, Spitali Korçë”**, e ndarë në lotë me nr. REF-Nr 286 prot., datë 06.02.2017 me operator fitues “F.” dhe vlerë kontrate 1,720,740 lekë me afat zbatimi kontrate deri më 31.03.2017 u konstatua se:

Nga ana e autoritetit kontraktorë nuk janë llogaritur penalitetet për këtë operatorë në vlerën **34,446 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Si dhe nga auditimit i furnizimeve u konstatua se për disa artikujt nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar cilësia e medikamenteve sipas nenit 3 të kontratë sku citohet: *Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës por në çdo rast jo më e vogël se 12 muaj.*

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit ‘Blerje barna Antineoplastik dhe immunomodularë, hormone seksuale dhe gjaku dhe organet formuese të gjakut, e ndarë në lotë’ marrëveshje kuadër. REF-Nr 122 prot., datë 02.02.2018 me operator fitues “A.” SHKP dhe vlerë kontrate 2,046,465 lekë nr. 522 prot., datë 10.05.2018 me afat zbatimi kontrate deri 4 muaj nga nënshkrimi i saj u konstatua se:

Nga ana e autoritetit kontraktorë nuk janë llogaritur penalitetet për këtë operatorë në vlerën **182,135 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit ‘B1 - Blerje barna sistemi anti-infektiv të përgjithshme për nevoja spitalore, ndarë në lotë’ me nr. REF-Nr 86 prot., datë 17.02.2017 me operator fitues “F.” dhe vlerë kontrate 1,197,900 lekë: për disa artikujt nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar cilësia e medikamenteve sipas nenit 4 të kontratë sku citohet: *Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës por në çdo rast jo më e vogël se 12 muaj, nga data e lëvrimit të mallit.*

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit ‘B3 - Blerje barna sistemi anti-infektiv të përgjithshme, antineoplastik dhe immunomodulare, antiparazitare dhe dermatologjike për nevoja spitalore, ndarë në lotë’ me nr. REF-Nr 88 prot., datë 17.02.2017 me operator fitues “F.” dhe vlerë kontrate 1,378,000 lekë me afat zbatimi kontrate deri më 15.12.2017, u konstatua se: nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar afatet e furnizimit sipas kushteve të kontratës ku nën nenin 3 citohet: *Sasia e lëvrimit do të jetë 20% muajin e parë, 20% në muajin e dytë, 10 % në muajin e tretë, 10% në të katërtin dhe pjesa tjetër deri më 15.12.2017, sipas kërkesave të institucionit.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit 'B9 - Blerje barna anti-infektiv të përgjithshme, për nevoja spitalore, ndarë në lotë' me nr. REF-Nr 118 prot., datë 02.02.2017 me operator fitues "M." dhe vlerë kontrate 1,506,000 lekë me afat zbatimi kontrate deri më 15.12.2017, u konstatua se: nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar afatet e furnizimit sipas kushteve të kontratës ku nën nenin 3 citohet: *Sasia e lëvrimit do të jetë 20% muajin e parë, 20% në muajin e dytë, 10 % në muajin e tretë, 10% në të katërtin dhe pjesa tjetër deri më 15.12.2017, sipas kërkesave të institucionit.*

Nga zhvillimi i procedurës së blerjeve me vlera të vogla, komisioni i vlerësimit të ofertave ka zgjedhur ofertën me vlerën më të ulët, të OE "M.", në shumën 99,000 lekë pa TVSH. Më datë 23.03.2017, AK ka lidhur kontratën me OE fitues, me afat 3 mujor.

Me urdhrin nr. 897 prot., datë 28.06.2017, drejtori znj. E. B. ka ngritur grupin e punës i përbërë nga znj. E. B., znj. K. B. dhe znj. M. L. për përlllogaritjen e fondit limit.

Në relacionin e përgatitur nga grupi llogaritja e çmimit është kryer mbështetur në kontratën e vitit 2016, kur AK, ka pasur një kontratë të lidhur në 6-mujorin e parë të vitit 2017.

Diferenca në llogaritje nga çmimi 381.16 lekë/kg me 330 lekë/kg, në shumën 30,690 lekë përbën efekt negativ ekonomik për Spitalin Rajonal Korçë.

Nga verifikimi i urdhër shpenzimeve të pagesave për shërbimin e mësipërm, për periudhën 2017-2018 u konstatua se në shumë raste fatura tatimore ishte lëshuar në datën e marrjes në dorëzim nga komisioni i dorëzimit të mbetjeve, dhe si dokumentacion shoqërues ishin vetëm formularët e dorëzimit dhe transportit të mbetjeve mjekësore.

Objekti i kontratës është dhe trajtimi i mbetjeve dhe jo vetëm marrja në dorëzim dhe transporti si dhe nga kushtet që parashtrajnë udhëzimet sa më sipër dhe pikat e kontratës nga OE nuk janë sjellë dokumentacion vërtetues për trajtimin e mbetjeve të marra në dorëzim.

Për sa më sipër vlera 627,000 lekë përbën shpenzime jo të justifikuar nga OE "M."shpk.

D. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre është konstatuar se:

-Nuk është ngritur Këshillin Administrativ dhe Këshillin Tekniko-Administrativ në kundërshtim me rregulloren nr. 4884 prot., datë 31.12.2008 "Për disa ndryshime në rregulloren e shërbimit të kujdesit shëndetësor dytësor (spitalor) dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë".

-Mos-ngritja e kësaj strukture ndikon në uljen e besueshmërisë dhe përpikërisë së zbatimit të politikave të Ministrisë së Shëndetësisë në Spital duke krijuar problematika në zbatimin e pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në kundërshtim me nenet 19-24 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

-Nuk analizohen pasqyrat financiare duke rritur riskun e devijimeve të cilat janë materiale nga ana cilësore dhe sasiore, nuk analizohet buxheti duke rritur riskun e ndryshimit të destinacionit të shpenzimeve buxhetore dhe nuk jepen opinione për domosdoshmërinë e investimeve të kryera ndër vite në spital. Mungesa e Këshillit krijon dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

-Të gjitha funksionet që duhet të kryeshin nga Këshilli Administrativ kryhen nga Drejtori i Spitalit. Mungesa e Këshillit ka sjellë efekte në mos-përmbyshjen e plotë të detyrave të drejtorit ekzekutiv në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë", Neni 19.

-Nuk është ngritur gjithashtu Komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë", Neni 40. Mungesa e Komitetit për planifikimin spitalor ka sjellë mangësi në hartimin dhe raportimin e planit spitalor në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë", Kreu V, Neni 42, Pika 2,3,5.

E. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

-Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave janë konstatuar disa raste të personave të punësuar, ku për procedurën e marrjes në punë nuk figuron miratimi i Ministrit në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë, "Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore", ku punësimi është kryer sipas urdhrave të brendshme.

-Rregullorja me të cilën ka funksionuar Spitali Rajonal i Korçë është e papërshtatur me ndryshimet e bëra në strukturë gjatë viteve të fundit duke krijuar pengesë në mirëfunksionimin administrativ të institucionit. Detyrat e secilit pozicion nuk janë të qarta duke qenë pengesë jo vetëm në procesin e administrimit por dhe të rekrutimit të stafit të ri në SRK.

Nga auditimi i sistemit tatimor rezultojnë **gjoba** në vlerën **5,000 lekë** si gjobë për deklarim të vonuar të tvsh të muajit tetor 2018 e cila përbën **efekt negativ financiar**.

Janë audituar listëprezencat dhe listëpagesat për muajt mars, gusht, dhjetor 2017 dhe mars, gusht, dhjetor 2018 ku janë vënë re diferenca në përllogaritjen e pagave të cilat vijnë si pasojë e:

- mosllogaritjes së saktë ose mos përditësimit të vjetërsisë në punë;
- mospozicionimit të saktë të pagës së grupit;
- luhajtjeve të theksuara të pagës së grupit për të njëjtët punonjës për të njëjtat pozicione pune, për të njëjtat nivele arsimore nga muaji në muaj e cila ka krijuar diferenca pozitive dhe negative në pagën e grupit dhe për pasojë edhe në pagën totale bruto;
- ka punonjës me paga grupi të cilat nuk ekzistojnë në legjislacion edhe pse kanë punuar gjatë muajit 22 ditë pune;
- mosllogaritje e saktë e pagës bazë mujore;

Gjithashtu nga aplikimi i pasaktë i pagës së grupit rrjedhin diferenca të vjetërsisë në punë duke shkaktuar një **efekt negativ financiar** në shumën **148,546 lekë**. Paga e grupit ishte paguar më pak në muajt para ardhës dhe në muajt pasardhës është bërë korigjimi, por aplikimi i shtësës së vjetërsisë duhet të kryhej mbi pagën reale të grupit. Mos aplikimi në kohë i ligjit dhe mos njohja e tij kanë sjellë efektet negative të mësipërme.

Nga auditimi i proceseve gjyqësore të largimeve nga puna për periudhë objekt auditimit në Spitalin Rajonal Korçë janë dëmshpërblyer pas fitimit të procedurave gjyqësore dy punonjës të cilët kanë përfituar në total **911,067 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar** për buxhetin e shtetit.

F. Auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta, sponsorizime etj).

Gjatë auditimit me zgjedhje të likuidimeve nëpërmjet bankës rezultoi se gjatë vitit 2017 dhe vitit 2018 janë pranuar dhe likuiduar nga komisioni i pritjes së mallit barna, kite dhe reagente të cilat e kanë pasur afatin e skadencës më të vogël se 1 vit, veprim që bie në kundërshtim me DST të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

paraqitura në procedurën e prokurimit dhe në kontratën e nënshkruar mes palëve si dhe në dokumentet standarde të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe APP.

-Në lidhje me pagesat institucioni vepron vetëm nëpërmjet llogarisë së Degës së Thesarit, Korçë.

Në Spitalin Rajonal, Korçë të ardhurat realizohen dhe arkëtohen nga 5 (pesë) recepsione. Këto 5 pika recepsioni ndodhen në poliklinikën e Spitalit, Maternitet, Urgjenca e spitalit, Senatorium dhe Imazheri.

Mbledhja e të ardhurave bëhet në pikat e recepsionit, nga personat e pa siguruar sipas tarifave të përcaktuara dhe të miratuara nga MSHMS në zbatim të Urdhrit Nr. 28, datë 26.01.2016 Ministrisë të Shëndetësisë “Për zbatimin e sistemit të referimit dhe tarifave të sistemit shëndetësor publik”, si dhe nga tarifave për formular patente, kml, ekzaminime etj.

Nga arkëtaria qendrore bëhet mbyllja ditore e cila i regjistron në mënyrë kronologjike në librin e arkës. Të ardhurat derdhen në banke për llogari të Degës së Thesarit. Të gjitha arkëtimet regjistrohen në ditarin e arkës. Në fund të çdo muaji ekonomistja përpilon evidencën e arkëtimit të ardhurave dytësore sipas sektorëve dhe çdo muaj përgjegjësja e sektorit të financës kuadron me degën e thesarit duke bërë akt rakordimin për të ardhurat. Shpenzimet bëhen ndërmjet llogarisë së Thesarit.

- Me vendimin nr. 85/6 prot., datë 15.05.2017 të përmbauesit gjyqësor të shoqërisë “D.” SHPK, institucioni është detyruar të kryej pagesën për shoqërinë “T. A.” SHA, vlerën 1,796,991 lekë, si dhe vendimin nr. 75/19 prot., datë 15.05.2017 për vlerën 347,832 lekë, më datë 16.05.2017 me urdhër shpenzimit nr. 237. Kjo vlerë ka ardhur sipas pretendimeve se Spitali Rajonal Korçë, ka përdorur shërbimet e kompanisë për disa vjet dhe kishte mbetur papaguar vlerën më sipër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se palët kishin lidhur marrëveshje për ofrimin e shërbimit të telefonisë për punonjësit e Spitalit Rajonal me kontratat e lidhura nga 20.07.2007 deri më 04.04.2008, nga ish drejtori z. I. J.. Megjithatë pretendimet se faturimi i çdo numri bëhej në mënyrë individuale, gjykata vendosi në favor të kompanisë. ***Vlera 2,144,823 lekë përbën dëm ekonomik që duhet të dëmshpërblehet nga z. I. J..***

-Gjatë auditimit të procedurës së “Trajtimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme periudha 2017”, u konstatua se: grupin e punës i ngritur për llogaritjen e fondit limit që do të prokurohet për evadimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore me përbërje znj. E. B., znj. K. B. dhe znj. M. L., me urdhrin nr. 897 prot., datë 28.06.2017, llogaritjen e çmimit e ka kryer mbështetur në kontratën e vitit 2016, kur AK, ka pasur një kontratë të lidhur në 6-mujorin e parë të vitit 2017. ***Vlera 30,690 lekë përbën efekt negativ ekonomik për Spitalin Rajonal Korçë.***

-Gjatë auditimit të pagesave të procedurës së prokurimit për evadimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, për periudhat 2017-2018, u konstatua se OE fitues, nuk ka sjellë dokumentacion justifikues, për pjesën e trajtimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore si dhe dokumentacion provues që materialet janë trajtuar sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Vendimin Nr. 798, datë 29.9.2010, Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, kreu II, detyrimet e prodhuesve të mbetjeve spitalore. ***Vlera 627,000 lekë përbën shpenzime jo të justifikuara nga OE “M.” shpk.***

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës me nr. 617 prot., datë 19.04.2017 lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë “T.” SHPK, me objekt “Blerje barna”, me vlerë 1,018,247 lekë pa TVSH, me afat lëvrimit deri më 15.12.2017, u konstatua shkelje në afatin e lëvrimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Në lidhje me lëvrimet e medikamentit Amikacinë, u konstatuan shkelje të afateve për 20 % e sasisë që duhej të dorëzohej në muajin e parë, për sasinë që duhej të dorëzohej në muajin e dytë si dhe atë të tretë. ***Penalitetet e maturuara janë në vlerën 137,463 lekë.***

Në lidhje me lëvrimet e medikamentit Amoksilinë, u konstatuan shkelje të afateve për 20 % e sasisë që duhej të dorëzohej në muajin e parë, për sasinë që duhej të dorëzohej në muajin e dytë si dhe atë të tretë. ***Penalitetet e maturuara janë në vlerën 222,996 lekë.***

Lidhur me mos dorëzimin e barnave sipas afateve të kontratës OE ka maturuar penalitete në vlerën **360,459 lekë** pa Tvsh, e cila përbën dëm ekonomik, dhe duhet të dëmshpërmbledhet nga OE “T.” SHPK .

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës me nr. 401 prot., datë 27.02.2017 lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë “ M.” SHPK, me objekt “Blerje materjale mjekimi për nevojat spitalore”, me vlerë 1,561,830 lekë pa TVSH, dhe me vlerë 1,874,196 lekë me TVSH me afat lëvrimi deri më 31.03.2017, u konstatua shkelje në afatin e lëvrimet.

Afatet e zbatimit të kontratës përcaktojnë se të paktën 20 % e sasive të kontraktuara duhet të lëvroheshin brenda 10 ditëve dhe pjesa tjetër brenda muajit mars.

Me faturat nr. 10022, 10029, dhe 10030, të datës 10.03.2017, OE “M.” SHPK, ka lëvruar sasi të e para të materialeve të mjekimit.

Afati i dorëzimit është tejkualuar me dy ditë duke maturuar ***penalitete në vlerën 142,439 lekë me TVSH, për OE.***

Me faturën nr. 10164, të datës 19.04.2017, OE “M.” SHPK, ka lëvruar sasi të e mbetura për 5 materjale të mjekimit.

Afati i dorëzimit është tejkualuar me 10 ditë duke maturuar ***penalitete në vlerën 93,709 lekë me TVSH për OE.***

Lidhur me mos dorëzimin e barnave sipas afateve të kontratës OE ka maturuar penalitete në vlerën **236,148 lekë** pa Tvsh, e cila përbën dëm ekonomik.

-Gjatë auditimit të shpenzimeve për konsumin e karburantit nga ambulancat e Spitalit, u konstatuan diferenca të dhënat e dërguara nga Qendra Kombëtare e Urgjencave për lëvizjet e automjeteve të marra nga sistemi GPS me sasi të e naftës të marra në dorëzim dhe normativat e konsumit të automjeteve. ***Vlera 971,263 lekë përbën dëm ekonomik për Spitalin Rajonal, Korçë.***

G. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve u krye në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “*Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH*”.

Nga auditimi i ushtruar në Spitalin Rajonal “Teni Konomi” Korçë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, u konstatohet se: nuk është kryer më parë auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në 10-vjeçarin e fundit.

XI. Të ndryshme të rezultuara nga auditimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi përputhshmërinë e aktivitetit të Spitalit Rajonal “Teni Konomi” Korçë (këtu e në vazhdim SRK), duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, në prokurimin e fondeve publike etj.

Qëllimi i auditimit

Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që SRK u ka bërë fondeve të çelura, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së tij dhe planeve strategjike të miratuara nga strukturat përkatëse. Auditimi jonë ka për qëllim promovimin e transparencës duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi, promovimin e përgjegjshmërisë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. Gjithashtu auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë. (sipas ISSAI 400, p 18)

Subjekti i audituar

Spitalit Rajonal “Teni Konomi” Korçë (SRK) ushtron veprimtarinë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Punës, të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 për “Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 8615, datë 01.06.2000 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me veprimtarinë e tij. Misioni i SRGJ është:

-Të japë ndihmë mjekësore të specializuar (terciar) për gjithë Qarkun e Korçë, të shërbejë me profesionalizëm duke respektuar rregullat e deontologjisë dhe të etikës mjekësore si dhe duke ruajtur sekretin profesional dhe informacionin e pacientëve;

-Të respektojë dinjitetin dhe personalitetin e të sëmurëve duke patur parasysh gjendjen psikologjike dhe dhimbjen fizike të tyre por edhe detyrimin që ka për t’i shërbyer të sëmurit;

Qëllimi i këtij auditimi nga ana e KLSH, është sigurimi se aktiviteti i SRK është kryer në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore nga të cilat rregullohet aktiviteti i tij, me fokus përdorimin me efikasitet të fondeve publike të alokuara për këtë qëllim.

Kriteret e vlerësimit

Qasja e punës audituese në Spitalit Rajonal “Teni Konomi” Korçë, u orientua bazuar në: -Nenet 162-163 të Kushtetutës së Shqipërisë ku përcaktohet se: Neni 162 : Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë ekonomik financiar . -Neni 163: Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon:

- a) veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërore;
- b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

c) veprimtarinë ekonomike të personave juridike, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti;

- **Ligjin nr. 154/2014, "Per organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"**, neni 3, pika 5, përcakton se: "*Auditim i përputhshmërisë*" nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, rregullorëve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, ndërsa neni 12 thekson se: "*Ne auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë:*

a) nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet parkatase ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik".

Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar; Ligji nr. 160/2014, datë 27.11.2014 "*Për buxhetin e vitit 2015*", i ndryshuar; Ligji nr. 147/2015, datë 17.12.2016 "*Për buxhetin e vitit 2016*", me ndryshime; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006; Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "*Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligji nr. 10383, datë 24.02.2011 "*Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", i ndryshuar; Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë*"; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*"; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 "*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*"; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, "*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*"; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*"; Ligji nr. 9106, datë 17.07.2003, "*Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë*"; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar; Ligji organik i buxhetit si dhe ligjet e buxhetit për vitin 2016 dhe 2017, udhëzimet e dala në zbatim të këtij ligji. Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Spitalit dhe akte të tjera të dala për funksionimin ligjor të veprimtarisë së tij; Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003 "*Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë*", Ligjit Nr. 10383, datë 24.02.2011 "*Për Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*", Ligjit Nr. 8615, datë 01.06.2000 "*Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë*", si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me veprimtarinë e tij, etj.

- **ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)**

- **ISSAI 400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë)**

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100 dhe 42001) e shpenzimeve: Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti – Spitali Rajonal "Teni Konomi" Korçë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime materiale në: 1. Në fushën e prokurimeve publike u konstatua dëm ekonomik në vlerën **15,858,865** lekë gjithsej, për të cilin kërkohet të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

ligjore arkëtimi i tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit. 2. Shpenzime pa efektivitet me vlerë **13,690,961** lekë në vendimet gjyqësore, llogaritje page etj.

Konkluzion: Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Spitali Rajonal “Teni Konomi” Korçë rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar dhe me siguri të arsyeshme.

1. ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.
2. ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare. 3. Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Spitali Rajonal “Teni Konomi” Korçë, është person juridik publik buxhetor i nivelit dytësor, me kapacitet 510 shtretër, i cili ju vjen në ndihmë të gjithë banorëve të qarkut Korçë, Ersekë dhe Devoll nëpërmjet shërbimeve të specializuara që ka.

Sipas rregullores së brendshme, shërbimi mjekësor në Spitalin Rajonal Korçë “Teni Konomi” ushtrohet në përputhje me:

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;

Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;

Ligji Nr. 8485 për “Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”;

Ligjit Nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore”, i ndryshuar;

Ligjit Nr. 8615, datë 01.06.2000 “Për Urdhrin e Mjekut”, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me veprimtarinë e saj.

Për periudhën 01.01.2017-31.12.2018, institucioni ka zbatuar dhe funksionon në bazë të rregullores së miratuar me nr. 4884, datë 31.12.2008.

Rëndësia e këtij auditimi për KLSH është i përcaktuar nga pikëpamja shoqërore pasi ka të bëjë me çështje shumë sensitive të shëndetit të popullsisë si dhe duke qenë se institucionet e shëndetësisë kanë probleme në drejtim të fondeve të akorduara të cilat nuk janë të mjaftueshme deri në plotësimin e nevojave të spitalit dhe kushteve totalisht optimale të trajtimit të të sëmurëve, auditimi me efektivitet dhe ekonomikitet i fondeve del shumë i rëndësishëm. Grupi i auditimit ka planifikuar auditimin e fondeve në masë të konsiderueshme duke audituar mbi 45% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës për auditimin e shtrirë në të dy vitet dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme.

Në SRK nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk është ushtruar auditim gjatë këtyre viteve, auditimi i fundit daton në vitin 2007, një periudhë shumë e largët për tu marrë në konsideratë.

Objekt i këtij auditimi është përputhshmëria e operacioneve financiare të SRK përgjatë periudhës së vitet 2017 dhe 2018 si dhe procedurave ligjore të kontraktimit të nevojave për mallra e shërbime.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim.

Gjithashtu theksojmë se ne kemi pasur kufizime në njohjen e preparateve dhe medikamenteve të duhura të planifikuara për përdorim spitalor referuar nevojave reale të spitalit sipas reparteve dhe protokolleve që përdoren në fushën e veprimit të kontrollit dhe shërbimit shëndetësor që mbulon ky Spital, duke i marrë në konsideratë llojet e tyre të blera dhe përdorura gjatë vitit 2017 dhe 2018.

Në përfundim të procesit të auditimit për secilin drejtim të Auditimit, rezultoi për sa më poshtë vijon:

Rezultatet e auditimit.

A. Në zbatim të pikës A të programit të auditimit “Mbi Kontrollin e Brendshëm”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Rregullore e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Dytësor 2007, ndryshuar me me nr. 4884/1, dt. 28.01.2008.
- 2) Rregullore e Brendshme e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2013.
- 3) Gjithashtu u hartuan pyetësorët përkatës në zbatim të drejtimit të auditimit për implemtimin dhe organizimin e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe i u dorëzuan drejtuesit Spitalit rajonal Korçë për të paraqitur informacion dhe dokumente në lidhje me zbatimin e këtij drejtimi.

Titulli i Gjetjes: Nga ana e drejtimit institucional të Spitalit Rajonal Korçë nuk është vënë në funksionim Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ky ligj nuk njihet nga strukturat drejtuese të institucionit e punonjësit e tij, nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Situata: Spitali Rajonal Korçë, nuk ka të përcaktuar misionin, strategjinë dhe objektivat, në hartimin e planeve konkrete të veprimit, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Në këtë institucion stafi drejtues nuk ka njohje të ligjit dhe koncepteve të tij. Nëpunësi autorizues është Drejtori i Spitalit, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e programit ekonomik. Nga drejtimi i institucionit nuk njihen komponentët e MFK me qëllim zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë për menaxhimin e riskut.

Nuk janë të Emëruar Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues sipas mënyrës dhe përcaktimeve të nenit 9 dhe 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiare dhe kontrollin”

Nuk është përgatitur “Deklarata e cilësisë” dhe Raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, e cili e ka afatin referuar nenit 18 të ligjit për MFK deri në fund të muajit Shkurt të vitit pasardhës, për vitet 2017 dhe 2018.

Nuk është përgatitur pyetsori i vetëvlerësimit për vitet 2017 dhe 2018 në funksion të realizimit të 5 fushave të kontrollit në të cilat funksionon Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.

Spitali Rajonal Korçë nuk ka të përcaktuar koordinatoren e riskut, njësia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut.

Kjo njësi publike nuk ka të miratuar, një plan afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit të të gjithë niveleve të njësisë publike dhe përgatitjen e gjurmëve të auditimit për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

procedurat specifike të njësisë, bazuar në kërkesat e Kreut III të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar.

Njësia nuk ka të përcaktuara procedura të brendshme të anti korrupsionit dhe të sinjalizimit të parregullsive referuar nenit 8, pika 8 /e dhe nenit 17 të Ligjit nr. 102 96, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar.

Nga njësia për vitet 2017 dhe 2018, nuk është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Spitali Rajonal Korçë për vitet 2017 dhe 2018 ka funksionuar nëpërmjet Rregullores së Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Dytësor 2007, ndryshuar me nr. 4884/1, datë 28.01.2008 dhe Rregullores së Brendshme të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2013.

Për periudhën objekt auditimi, njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

Nga njësia nuk është miratuar Grupi i menaxhimit strategjik (GMS), si dhe nuk është hartuar Gjurma e Auditit, e cila ka si qëllim për të ndihmuar menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin, si dhe të identifikojë boshllëqet, në zbatim të

Në kundërshtim me kompetencat për titullarin e njësisë, që në këtë rast është Këshilli Administrativ, të përcaktuara në nenet 12 dhe 14, të Ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe në mungesë të krijimit dhe funksionimit të Këshillit Administrativ, Rregullorja e Brendshme e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të institucionit përcakton se audit i brendshëm i shoqërisë është nën varësinë e Drejtorit të Spitalit.

Kriteri: Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”. Urdhërit të Ministrit të Financave 108, datë 17.11.2016, “Për miratimin e Manualit për MFK”.

Ndikimi/Efekti: Spitali Rajonal Korçë ka ushtruar aktivitetin e tij në mungesë të një sistemi politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe për të garantuar se menaxhimi financiar dhe kontrolli i njësisë është në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi.

Shkaku: Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e faktit se nuk është vënë në funksionim Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Drejtoria e Spitalit Rajonal Korçë të marrë masa menjëherë dhe në vazhdimësi për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues i ligjit të MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin e një plan-veprimi, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë menaxhimin e riskut. Në planet konkrete të veprimit të përcaktohen misioni, strategjia dhe objektivat, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi Znj. E. B. ish-Drejtores e Spitalit Rajonal Korçë për periudhën janar- shtator 2017 z. A. K., ish Drejtor i Spitalit Rajonal Korçë për periudhën shtator 2017 – mars 2018 dhe z. A. K. me detyrë Drejtor i Spitalit Rajonal Korçë për periudhën mars-dhjetor 2018, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të institucionit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3 datë 28/06/2019 dhe për këtë çështje subjekti i audituar me shkresën nr. 1141 prot., datë 05.07.2019 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht sqarohet se periudha e audituar ka qenë periudhë tranzitore për të tre drejtuesit e institucionit, dy prej të cilëve sot janë Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, kur dr. A. K. ka ushtruar këtë detyrë si drejtues i komanduar Brenda një periudhe të shkurtër pas komandimit, vetëm për efekt të mos bllokimit të institucionit në drejtim të ushtrimit të aktiviteteve ditore. Sa i përket implementimit dhe zbatimit të ligjit për MFK, në mungesë të përgjigjes së pyetësorit nga ish drejtuesit duhej të shprehej sektori ekonomik, por ata nguruan të shprehen, pa një komunikim me ish drejtuesit, i cili nuk u realizua dot.

Për problemet e ngritura në Akt Konstatimin nr. 3 sqarojmë se:

Pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalir Korçë me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë është ngritur një grup antikorrupsion i cili funksionon dhe në ç’do rast të referimit të rasteve korruptive, sinjalizon pranë Drejtorisë. Gjithashtu Drejtorja e Shërbimit Spitalir Korçë ka referuar pranë ILDKP emrat e sinjalizuesve sipas ligjit përkatës.

Drejtorja në fund të ç’do vit realizon performancën individuale të ç’do punonjësi e cila bëhet pjesë e dosjes personale të tij. Sipas varësisë kjo performancë vlerësohet nga titullari i sektorit përkatës, i cili vlerëson ç’do punonjës.

Në lidhje me informacionin dhe komunikimin, ka procedura të shkruara në lidhje me detyrat funksionale të secilit prej punonjësve të spitalit, qofshin këta punonjës administrate apo punonjës të stafit mjekësor, ka një procedurë të caktuar në lidhje me komunikimin zyrtar, i cili është duke zbatuar hierarkinë institucionale. Komunikimi i brendshëm bazohet në shkresat dhe informacionet si dhe komunikimet me email duke zbatuar afatet e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative. Analizimi i gabimeve bëhet nëpërmjet performancës vjetore e cila ka një sistem pikëzimi dhe përdoret si tregues i aftësive profesionale të punonjësve.

Drejtorja e Shërbimit Spitalor Korçë nuk funksionon si një Spital Rajonal dhe rrjedhimisht nuk ka Këshill Administrativ dhe gjithë njësitë e tjera në vartësi nga ky Këshill. Njësia e auditimit në bazë të strukturës analitike dhe rregullores së brendshme të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë është në varësi të Drejtorit dhe pjesë e Drejtorisë, pra është konform përcaktimeve që bën Ministria e Shëndetësisë.

Pas komeneteve të bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit sqaron se në mungesë të dokumentacionit bashkëngjitur, vërtetues të pretendimeve të subjektit të audituar, komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Sa i përket njësisë së auditimit të brendshëm, ajo në ç’do institucion përcaktohet konform Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe Vendimit nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ku specifikohen qartë numri i punonjësve që duhet të ketë kjo njësi dhe titullari përgjegjës për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në njësinë publike. Për sa më sipër, komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Në zbatim të pikës A të programit të auditimit, u shqyrtua informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me funksionimin e përgjithshëm të auditit të brendshëm të Spitalit Rajonal Korçë, nga ku rezultoi se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Titulli i Gjetjes: Struktura e Auditit të Brendshëm në Spitalin Rajonal Korçë përbëhet nga më pak se 3 (tre) punonjës dhe varësia e saj nga Drejtoria e Spitalit ka cënuar parimin e pavarësisë, misionin, funksionimin dhe të drejtat e auditit të brendshëm.

Situata: Për vitet 2017 dhe 2018, Siptali Roajnal Korçë ka funksionuar konform strukturës analitike e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me nr. prot., 1369, datë 10.03.2017. Kjo strukturë parashikon si pjesë të Drejtorisë së Spitalit një specialist të lartë auditi, ndërkohë që struktura nuk duhet të përbëhet nga jo më pak se tre punonjës. Bazuar në përcaktimet e Rregullores së Brendshme të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2013 të Spitalit Rajonal Korçë, Përgjegjësi i Auditit të Brendshëm mbikëqyret nga Drejtori i Spitalit, kjo është në kundërshtim me parimin e pavarësisë, misionin e auditit të brendshëm, parimet e përgjithshme të funksionimit, organizimin e shërbimit dhe të drejtat e auditit të brendshëm, të specifikuara në nenet 5, 7, 10 dhe 15 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si edhe në kundërshtim me nenin 12 pika a) të këtij ligji ku specifikohet se përgjegjës për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm janë titullarët e njësive publike. Në këtë rast titullari i njësië është organi vendimmarrës kolegjal, pra Këshilli i Administrimit. Në Spitalin Rajonal Korçë organet drejtuese Këshilli Administrativ dhe Komisioni Mjekësor nuk janë ngritur dhe për rrjedhojë nuk funksionojnë. Në këto kushte gjitha funksionet që duhet të kryheshin nga Këshilli Administrativ kryhen nga Drejtoria e Spitalit.

Kriteri: Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik“, Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe pikën 3 të vendimit nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Ndikimi/Efekti: Për pasojë auditit i brendshëm i Spitalit Rajonal Korçë nuk ka zbatuar detyrën në përmbushjen e rolit të auditimit të brendshëm që është t’i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë. Varësia e Auditit të Brendshëm nga Drejtoria e Spitalit ka cënuar parimin e pavarësisë, misionin e auditit të brendshëm, parimet e përgjithshme të funksionimit, organizimin e shërbimit dhe të drejtat e auditit të brendshëm.

Shkaku: Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos zbatimit të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik“, Ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Këshilli Administrativ i Spitalit Rajonal Korçë, në cilësinë e titullarit të institucionit, pas ngritjes dhe funksionimit të tij, të marrë masa për ngritjen e njësisë së auditit të brendshëm me jo më pak se tre punonjës dhe funksionimin e saj në përputhje me parimin e pavarësisë, misionit të auditit të brendshëm, parimet e përgjithshme të funksionimit, organizimin e shërbimit dhe të drejtat e auditit të brendshëm.

Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi Znj. E. B. ish-Drejtores e Spitalit Rajonal Korçë për periudhën janar- shtator 2017 z. A. K., ish Drejtor i Spitalit Rajonal Korçë për periudhën shtator 2017 – mars 2018 dhe z. A. K. me detyrë Drejtor i Spitalit Rajonal Korçë për periudhën mars-dhjetor 2018.

Titulli i Gjetjes: Njësia e Auditimit të brendshëm të Spitalit Rajonal Korçë nuk ka hartuar e miratuar një plan vjetor auditimi për vitin 2018. Për vitet 2017 dhe 2018 nga auditit i brendshëm i Spitalit Rajonal Korçë nuk janë hartuar Karta e Auditit të Brendshëm dhe Kodi i Etikës të auditit të brendshëm. Për periudhën prej dy vitesh objekt auditimi, auditit i brendshëm i Spitalit Rajonal



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Korçë ka zhvilluar gjithësej vetëm dy auditime, të cilët nuk janë formuluar sipas kërkesave të manualit të auditimit të brendshëm me të gjithë elementët përbërës të tij.

Situata: Nga vlerësimi i aktivitetit të auditit të brendshëm në Spitalin Rajonal Korçë, rezulton se është hartuar Plani Strategjik 2016-2020 për Auditin e Brendshëm, miratuar nga Drejtori i Spitalit Rajonal Korçë, me nr. 873 prot., datë 22.10.2016.

Për vitin 2017 është miratuar nga Drejtori i Spitalit, Plani Vjetor i Auditit të Brendshëm me nr. 291 prot., datë 06.02.2017. Njësia e auditit të brendshëm nuk ka zhvilluar asnjë auditim për këtë vit duke mos përmbushur detyrën në zbatim të planit vjetor të auditit të brendshëm.

Njësia e Auditimit të brendshëm të Spitalit Rajonal Korçë nuk ka hartuar e miratuar një plan vjetor auditimi për vitin 2018. Ajo ka hartuar një raport final auditimi me nr. 923 prot., datë 13.08.2018, për "Krijimin e të ardhurave dytësore nga shërbimet shëndetësore sipas tarifave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe në zbatim të sistemit të referimit". Ky raport është hartuar nga katër punonjës të Spitalit, ndonëse vetëm njëri prej tyre, z. T. Q. është i përcaktuar në strukturë si auditues i brendshëm i Spitalit Rajonal Korçë.

Raporti nuk është formuluar sipas kërkesave të manualit të auditimit të brendshëm me të gjithë elementët përbërës të tij.

Gjithëashtu mbi bazën e programit të auditit miratuar me shkresën nr. 634 prot., datë 28.05.2018, auditit i brendshëm i Spitalit Rajonal Korçë ka kryer një auditim mbi karburantin dhe lëndët djegëse. Projekt raporti i këtij auditimi është hartuar nga një grup prej katër vetësh, punonjës të spitalit, ku vetëm z. T. Q. është i përcaktuar në strukturë si auditues i brendshëm i Spitalit Rajonal Korçë. Ky Projekt Raport auditimi nuk është formuluar sipas kërkesave të manualit të auditimit të brendshëm me të gjithë elementët përbërës të tij dhe nuk është miratuar nga Drejtori i Spitalit Rajonal Korçë.

Për vitet 2017 dhe 2018 nga auditit i brendshëm i Spitalit Rajonal Korçë nuk janë hartuar Karta e Auditit të Brendshëm dhe Kodi i Etikës të auditit të brendshëm. Për periudhën prej dy vitesh objekt auditimi, auditit i brendshëm i Spitalit Rajonal Korçë ka zhvilluar gjithësej vetëm dy auditime, përkatësisht në qershor dhe në gusht 2018.

Kriteri: Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

Ndikimi/Efekti: Për pasojë struktura e auditit të brendshëm të Spitalit Rajonal Korçë nuk ka zbatuar detyrën në përmbushjen e rolit të auditimit të brendshëm që është t'i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë për vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontroleve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve, përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë me kuadrin rregullator, ruajtjen e aseteve, besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional, kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë, përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve, dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë përmes ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Shkaku: Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos zbatimit të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Njësia e Auditit të Brendshëm e Spitalit Rajonal Korçë, të marrë masa në vazhdimësi për përmbushjen e rolit të auditimit të brendshëm në dhënien e mbështetjes së titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve vjetore të auditimit, hartimin e Kartës së Auditit të Brendshëm dhe Kodit i Etikës. Formulimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

raporteve të auditit konform kërkesave të manualit të auditimit të brendshëm me të gjithë elementët përbërës të tij.

Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi Audituesi i Brendshëm z. T. Q. për mospërbushje të rolit të auditimit të brendshëm në dhënien e mbështetjes së titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë.

B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit dhe në Ligjin nr.130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të 2017” me ndryshimet e tij, Ligjin nr.109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”.

Titulli i Gjetjes: Monitorimi i menaxhimit të barnave të skaduara.

Situata: Nga proces verbali i mbajtur me datë 13.12.2017, nga komisioni i ngritur për inventarizimin e materialeve dhe medikamenteve në farmaci, rezultuan 6 medikamente të skaduara me vlerë 254,553 lekë.

Nga analiza e marrjes në dorëzim të medikamentit Interferon alfa 2 beta, 20 njësi me vlerë 235,820 lekë u konstatua se afati i skadimit të barnave për dy kontratat e lidhura, ishte më pak se 12 muaj.

Kriteri:

-Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshimet e tij.
-VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratim e rregullave të prokurimit publik” me ndryshimet e tij.
-Neni 4, kushtet e furnizimit të kontratës lidhur mes palëve data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë më e vogël se ½ kohës ndërmjet prodhimit dhe asaj të skadencës, por në çdo rast jo më e vogël se 12 muaj.

Ndikimi: Mos përmbushja e pikës sa më sipër ka sjell skadencën e medikamenteve. Ezauruar në rekomandimet e lëna nga auditimit i FSKDSH-së.

Shkaku: Papërgjeshmëria e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të medikamenteve.

Rëndësia: E Lartë

Titulli i Gjetjes: Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit në Spitalin Rajonal Korçë.

Situata: Për vitin 2017 nga Spitali Rajonal Korçë janë paraqitur pjesërisht raportet e monitorimit të zbatimit të buxheiti për performancën financiare në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Kriteri:

-Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshimet e tij.
-Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet e tij, neni 65 citohet : “Nëpunësi autorizues të njësisë qendrore i paraqesin, sa herë i kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxheiti për performancën financiare”.

Ndikimi: Mos raportimi në kohë mbi raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Shkaku: Mos respektimi i dispozitave ligjore.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandime: Në vazhdimësi Spitali Rajonal Korçë të paraqesi sa i herë i këkohet por jo më pak se tri herë në vit raportet e monitorimit të zbatimit për performancën financiare sipas dispozitave ligjore përkatëse.

Titulli i gjetjes: Situata Debitore



KONTROLI I LARTË I SHËTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

-Vlera e zërit kontabël debitorë të ndryshëm për tu paguar është 30,319,970 lekë në fund të vitit 2018. Nga analiza e kryer u konstatua se një pjesë e detyrimeve i takojnë furnizimeve me medikamente të lëvruara gjatë periudhës 2018, si dhe detyrime nga të krijuara në proceset gjyqësore me punonjës të larguar dhe ankimime nga ish pacientë. Nga departamenti i financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, janë dërguar situacionet në Degën e Thesarit, por likuidimi i tyre është vonuar. Më datë 16.01.2019, me shkresën nr. 96, institucioni i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Mos veprimet në kohën e duhur për pagesën e borxheve, sjellin kalimin e afateve ligjore për pagesën e tyre, duke sjellë risqe potenciale me dëme për Buxhetin e Shtetit.

Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal, të marrë masa për përcjelljen kërkesave për likuidime në kohë, duke respektuar afatet ligjore të pagesave sipas përcaktimeve të kontraktuara, si dhe planifikimi i shpenzimeve të tjera të buxhetit të kryhet me përgjegjësi, duke analizuar situatën reale të institucionit, për të evituar situatat debitorë në të ardhmen.

Nga auditimi rezultoi se:

Spitali Rajonal Korçë me shkresat dhe dokumentat përkatës mbi procedurën e planifikimit e pasqyrave dhe hartimit të buxhetit, si dhe me vendimet nga FSDKSH-ja dhe Ministria e Shëndetësisë janë miratuar fondet mbi buxhetet për periudhën objekt auditimi. Gjatë zbatimit të buxhetitve ka pasur shtesa dhe pakësime të cilat janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore. Në mënyrë më të detajuar janë evidentuar janë analizuar të ardhurat detyësore, mallra dhe shërbime të tjera, investimet, kontratat e palikujduara, proceset gjyqësore. Nuk janë respektuar afatet kohore për disa barna duke mos respektuar kushtet e kontrata për afatin e skadencës. Mos likuidimi i kontratave për vitin 2018 ka krijuar debitorë për vitin 2019 shumë e cila është likuiduar gjatë tre mujorshit të parë të vitit 2019. Mbi zbatimin dhe raportimin si dhe monitorimin e buxhetit janë zbatuar pjesërisht dispozitat ligjore për vitin 2017. Për 2017 ka një rrijtje të buxhetit në krahasim me vitin 2018.

Sistemi i programimit të projekt buxheteve për vitet 2017 dhe 2018.

Hartimi i projekt buxheteve në total sipas zërave të strukturës buxhetore janë hartuar në zbatim të kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Mbështetur në materialet e kërkuara nga grupi i auditimit dhe të vendosura në dispozicion nga ana e stafit si dhe referuar fushave të përcaktuara në auditim, gjendja rezultoi si më poshtë:

Projekt buxhetet për vitet 2017 dhe 2018 janë përgatitur, miratuar dhe detajuar në referencë të:

- Ligjit nr.130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, me ndryshimet e tij.
- Ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”.
- Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet e tij.
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet e tij.
- Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet e tij.
- Vendimet e Këshillit të Ministrave.
- Udhëzimet e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të dala nga Ministria e Ekonomisë dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Financave.

- Si dhe akte të tjera në zbatim të tyre.

Për miratimin e paketave të shërbimit shëndetësor që do të financohen nga (FSDKSH) në shërbimin spitalor.

Hartimi i projektbuxheteve:

Për vitin 2017 në mbështetje të Ligjit nr.130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, me ndryshimet e tij, Udhëzimin e Përhershëm të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së buxhetit” si dhe shkresën nr.3338 prot., datë 15.06.2016 të Ministrisë së Shëndetësisë për procedurat e hartimit të projekt buxhetit për vitin 2017-2019, janë dhe anekset dhe pasqyrat përkatëse deri tek formulari nr.2 “Formulari i propozimit të projektit të Investimeve (Formulari F2 Aneksi 5.A, Shtojca 2B)”.

Me shkresën nr.694/1 prot., datë 13.07.2016 mbi projekt buxhetin për vitin 2017 Spitali Rajonal Korçë është drejtuar Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), për çelje fondi sipas këksesës mbi analizën e pasqyrave:

- Pasqyra nr.7/1 “Parashikimi i të ardhurave të veta të secilit program të Ministrive të Linjës/Institucioneve Buxhetore”.
- Pasqyra nr.7/2 “Përmbledhëse e kërkesave buxhetore”.
- Pasqyra nr.7/3 “Përmbledhëse shpenzime për pagat”.
- Pasqyra nr.7/4 “Numri i punonjësve për vitin 2015, 2016 dhe parashikimi për vitin 2017-2019”.
- Pasqyra nr.7/5 “Parashikimi për mallra dhe shërbime për secilën Program të Ministrisë së Linjës (602)”.
- Pasqyra nr.7/9 “Parashikimi i shpenzimeve për Transfertat në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrisë së Linjës (606)”.
- Pasqyra nr.7/10 “Parashikimi Mujor i Fluksit të Parasë për Shpenzimet Buxhetore të secilit Program të Ministrisë së Linjës/Institucionet Buxhetore”.

-Vlera e parashikuar në projekt buxhetin për vitin 2017 nag Spitali Rajonal Korçë në shumën 634,353,000 lekë sipas zërave:

(600) Pagat;	350,592,000 lekë
(601) Shpenzime kontribute;	55,761,000 lekë
(602) Mallra dhe shërbime të tjera;	228,000,000 lekë
Arkëtimi dhe përdorimi i të ardhurave dytësore në vlerën;	21,195,350 lekë

Lidhur me miratimin e buxhetit vjetor:

Për vitin 2017 në zbatim të Ligjit nr.130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, me ndryshimet e tij, Ligjit nr.10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet e tij nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) në zbatim të VKM nr.18, datë 11.01.2017 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, me shkresën nr.13 prot., datë 13.01.2017 **është bërë miratimi i fondeve në shumën totale prej 565,800,000 lekë (financim nga buxheti)** sipas zërave: pagat 319,200,000 lekë, kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore 53,300,000 lekë, mallra dhe shërbime të tjera 193,300,000 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Gjatë vitit 2017 kanë ndodhur disa ndryshime në buxhetin e miratuar të pasqyruara në tabelën e më poshtme:

Viti 2017	600	601	602	Total
Buxheti 2017 miratuar me shkresën nr.13 prot., datë 13.01.2017	319,200,000	53,300,000	193,300,000	565,800,000
Shtesë me shkresën e FSDKSH nr.5755 prot., datë 15.11.2017	33,500,000	5,150,000	25,000,000	63,650,000
Zërat pas ndryshimeve	352,700,000	58,451,000	218,300,000	629,450,000

Ndryshimet e buxhetit viti 2017

Analiza e llogarisë 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”:

Për sa i përket shpenzimeve koherente për zërin (602) mallra e shërbime të tjera, sipas situacioneve të thesarit, janë planifikuar gjithsej 218,300,000 lekë dhe janë realizuar 216,880,000 lekë, zërat më kryesor:

1. “Materiale dhe shërbime zyre” përfshin të gjitha shpenzimet e kancelarisë, pastrimit, dokumentacioni etj, për të cilën janë planifikuar 15,582,002 lekë dhe janë realizuar 16,097,000 lekë.
2. “Materiale dhe Shërbime speciale” ka peshën më të madhe të shpenzimeve dhe janë “Medikamente” 59,937,793 lekë, “Materiale mjekimi” 22,782,978 lekë, “Kite e reagentë” 4,574,088 lekë, “Filma radiologji” 3,464,790 lekë, “Ushqime” 10,248,105 lekë, “Të tjera” 1,255,246 lekë, për të cilën janë planifikuar 102,263,000 lekë dhe janë realizuar 102,225,000 lekë.
3. “Shërbime nga të tretët” përfshin shpenzimet elektrike, ujë, ngrohje, posta, shërbime telefonike etj. Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në vlerën 69,389,000 lekë dhe janë realizuar 68,007,000 lekë.
4. “Shpenzime mirëmbajtje” përfshin shpenzimet e mirëmbajtjes së aparaturave mjekësore, ndërtimore, impjanistikës etj. Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në vlerën 10,518,000 lekë dhe janë realizuar 10,518,000 lekë.

Plani dhe realizimi për zërin (602) mallra dhe shërbime të tjera për vitin 2017

000/lekë

Emërtimi	Plan	Fakt
(6020) Materiale e shërbime të përgjithshme zyre	15,582	16,097
(6021) Materiale e shërbime speciale	102,263	102,225
(6022) Shërbime nga të tretët	69,389	68,007
(6023) Shpenzime transporti	13,460	13,460
(6024) Shpenzime udhëtimi	4,007	4,007
(6025) Mirëmbajtje e zakonshme	10,518	10,518
(6027) Shpenzime gjyqësore	-	-
(6029) Shpenzime të tjera operative	3,081	3,081
TOTALI (Llog 602)	218,300	216,880



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Situata në Spitalin Rajonal Korçë paraqitet për vitin 2017, për zërin mallra të tjera dhe shërbime në nivele më të larta se realizimi i pritshëm i vitit 2016, në konsumin faktik, në masën 11.5%, i cili është përbërë nga rritja për efekt të nivelit të inflacionit vjetor të indeksushëm 2% si dhe rritje paga të punonjësve në masën 10.3%, për zërat dhe shërbimet tradicionale, pasi bazë përlllogaritje për këtë projekt buxhet, ka qenë konsumi faktik në shumë zëra të shpenzimeve operative, si për barna e materiale të konsumit mjekësor, ushqimet, mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore, si dhe shërbime të tjera të cilat zënë një peshë të madhe. Në krahasim me vitet e kaluara sipas grupit të punës të hartimit të buxhetit, është gjykuar që rritja të jetë si për barna e materiale të konsumit mjekësor, mirëmbajtje aparaturash dhe pajisjesh mjekësore, kite reagente, si dhe shërbime mbështetëse etj, rreth 8 %.

Për vitin 2017 në Spitali Rajonal Korçë të ardhurat dytësore janë në shumën 21,195,350 lekë.

TË ARDHURA DYTËSORE VITI 2017													
PAVIONE	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI
URGJENCE	7,100	2,100	6,100	3,500	1,200	8,700	2,400	2,000	2,600	2,100	500	1,400	39,700
PTENT AR.	1,524,000	1,362,000	1,420,000	1,242,000	1,437,000	1,087,500	1,164,000	1,435,500	1,035,000	1,026,000	954,000	793,500	14,480,500
MATERNITET	9,900	17,000	23,300	16,400	21,400	29,000	16,300	24,400	15,400	22,000	21,500	13,900	230,500
SANATORIUM	20,800	11,600	18,000	7,600	12,800	11,000	10,100	4,000	8,700	7,500	11,200	10,200	133,500
LABORATORI	22,600	23,700	25,000	26,500	24,000	18,500	24,200	26,800	11,300	11,200	8,600	15,600	238,000
KARTOTEKE		3,000	3,000		3,000			2,800	3,200	3,000			18,000
BANKA E GJAK.			1,000		1,500	500	2,000	1,000	500				6,500
ECO, SCANER	157,600	138,050	172,900	133,500	133,350	133,250	146,000	147,700	124,950	102,700	132,000	7,600	1,529,600
GRAFI SKOPI	6,500	4,600	5,800	11,000	9,500	10,800	8,100	10,000	8,600	7,000	11,350	5,600	98,850
ONKOLOGJI	1,300	900	2,600	2,000	2,000	1,200	500	3,400	2,800	1,100	1,600	700	20,100
ORL- OKULIST	23,300	32,000	26,000	28,900	27,400	26,300	11,800	31,300	27,200	30,100	17,200	15,300	296,800
NEUROLOGJI	7,300	7,100	10,000	4,600	7,900	8,600	5,900	8,600	14,900	7,700	10,900	8,900	102,400
KIRUR- ORTOP	2,600	3,200	4,600	4,000	6,500	4,700	3,600	8,200	5,200	4,100	5,000	5,500	57,200
KML+ DIAGNOZE	346,300	305,600	271,800	244,700	240,200	209,300	220,500	204,200	513,200	329,900	239,400	211,700	3,336,800
EKG, FIBRO													
MAMO	8,800	8,900	11,900	10,800	6,600	15,000	7,400	5,400	4,700	2,400	3,300	2,400	87,600
PATHOLOGJI	37,100	44,400	47,600	60,200	52,800	41,200	40,500	45,400	35,000	42,700	39,900	32,500	519,300
TOTALI	2,175,200	1,964,150	2,049,600	1,795,700	1,987,150	1,605,550	1,663,300	1,960,700	1,813,250	1,599,500	1,456,450	1,124,800	21,195,350

Plani dhe realizimi për të ardhurat dytësore për vitin 2017

000/lekë

Emërtimi Buxhetit	Plan 2017	Realizimi 2017	% Realizimi
(600) Paga (të ardhura)	8,788	5,722	65.1%
(601) Sig. Shoq. dhe (të ardhura) shëndetësore	1,313	955	72.7%
(602) Të ardhura	34,681	17,808	51%
(231) Të ardhura	7,932	7,894	99.5%
Shuma të ardhura	52,714	32,379	61.4%

Për vitin 2017 të ardhurat dytësore janë në shumën 21,195,350 lekë, si dhe të ardhura dytësore të mbartura nga viti 2016 në shumën mbartura 31,518,556 ku në total në vlerën 52,714,000 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHËTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Investimet:

Në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë me nr. 3338, datë 15.06.2016 mbi procedurat e hartimit të buxhetit 2017-2019 për pasqyrat dhe analizën e Investimeve Spitali Rajonal Korçë ka bërë kërkesë për çelje fondi. Në zbatim të Ligjit nr.130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017", me ndryshimet e tij, të Udhëzimit të Përherëshëm nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" si dhe në shkresën e Ministrisë së Financave me nr.17911/221, datë 25.01.2017 është bërë miratimi i fondit për shpenzimet kapitale për investimet në shumën 30,630,000 lekë për:

(Rikonstruksion i një godine katër kate dhe një shtesë anësore për zhvendosjen e Maternitetit brenda korpusit të spitalit Korçë, supervizion dhe kolaudimi për rikonstruksionin e një godine katër kate dhe shtesë anësore për zhvendosjen e Maternitetit brenda korpusit të spitalit Korçë, pagesë për përgatitjen të dokumnetacionit për lejen zhvillimore të ndërtimit për Maternitetin Korçë, pagesë e lejes zhvillimore për rikonstruksione/ndërtimore). Fondi për investime është çelur sipas zërave:

(231) Investimet, Rikonstruksion i një godine	26,000,000 lekë
(231) Investimet, Supervizion, kolaudim	330,000 lekë
(231) Investimet, Pagesë për përgatitjen e dok	400,000 lekë
(231) Investimet, Pagesë e lejes zhvillimore.....	3,900,000 lekë

Në zbatim të Ligjit nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017" me ndryshimet e tij, Udhëzimin e Përherëshëm nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" si dhe në shkresën e Ministrisë së Financave me nr. 3487/1, datë 17.03.2017 është bërë miratim fondi shtesë në shumën 1,118,000 lekë për (Pagesën e lejes zhvillimore për rikonstruksion/ndërtimore). Në mbështetje të Aktit Normativ nr. 3, datë 06.11.2017 mbi shpenzimet për investimet me shkresën nr. 4727/3, datë 17.11.2017 janë bërë pakësime në shumën 1,200,000 lekë (Pagesë e lejes zhvillimore për rikonstruksione/ndërtimore), fond i cili nuk është shpenzuar. Miratimi i fondit shtesë për investimet bazohet mbi kërkesat fillestare që ka bërë Spitali Rajonal Korçë drejt Ministrisë së Shëndetësisë.

Në mënyrë të përmbledhur fondet për vitin 2017 për investimet janë realizuar si më poshtë:

000/lekë

Emërtimi i projektiti	Plani 2017	Fakti 2017	% Realizimi
1.Pagesa për përgatitjen dok. Për lejen e zhvillimore ndërtimi godina Materniteti	400	390	97.5%
2.Rikonstruksioni godina Maternitet	26,000	25,960	99.8%
3.Supervizon e Kolaudim	330	101	30.6%
4. Pagesa për lejen zhvillimore për rikonstruksion godine	3,818	3,810	99.8%
Investimet Shuma Buxhet	30,548	3,0261	99%
Invenstime nga të ardhurat(Pajisje aparatura)	7,932	7,894	99.5%
Investimet gjithësej	38,480	3,8155	99.1%

Mbi raportimin dhe zbatimin e Investimeve në Ministrinë e Shëndetësisë Spitali Rajonal Korçë ka paraqitur shkresat si më poshtë:

-Shkresa nr.575 prot., datë 05.04.2017.

-Shkresa nr.1075 prot., datë 08.08.2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Në mbështetje të shkresës nr.1754 prot., datë 28.03.2017 “Mbi raportimin e realizimit të Investimeve Publike në Shëndetësi”, Spitali Rajonal Korçë me shkresën nr. 28 prot., datë 09.01.2018 ka paraqitur zbatimin dhe realizimin e Investimeve Publike drejt Ministrisë së Shëndetësisë.

Zbatimi vjetor i buxhetit sipas rakordimeve me thesarin:

Në mënyrë të përmbledhur fondet për vitin 2017 janë realizuar si më poshtë:

000/lekë

Emërtimi Buxhetit	Realizimi 2016	Buxhet 2017	Realizimi 2017	% Realizimi
(600) Paga (buxhet)	316,475	351,788	348,489	99%
(601) Sig. sho dhe (buxhet) shendetësore	51,747	58,450	57,746	98.8%
(606) (Përdorim f.veçant për ndihma, sëmundje)	753	912	912	100%
(602) Buxhet	217,596	218,300	216,880	99.3%
(231) Buxhet		30,548	30,261	99%
Shuma buxhet	586,571	659,998	654,288	99.1%
(600) Paga (të ardhura)	2,466	8,788	5,722	65.1%
(601) Sig. Shoq. dhe (të ardhura) shendetësore	412	1,313	955	72.7%
(602) Të ardhura	4,570	34,681	17,808	51%
(231) Të ardhura	438	7,932	7,894	99.5%
Shuma të ardhura	7,886	52,714	32,379	61.4%
Shuma gjithsej	594,457	712,712	686,667	96.3%

Tabela e hartuar nga grupi i auditimit referuar të dhënave të marra nga thesari dhe situacionet e hartuara nga institucioni. Në mënyrë të detajuar zbatimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2017. Me shkresën nr.45 prot., datë 11.01.2018 drejtuar FSKDSH-së (Drejtoria Ekonomike Tiranë) për realizimin e buxhetit për vitin 2017. Në zbatim të fondeve të buxhetit për vitin 2016 rezultojnë të mos ketë detyrime si rezultat i shlyerjes së likujdime të kontratave, por ka mbetur një diferencë në shumën 8,025,000 lekë në zërat paga dhe kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore si pasojë, shumë e cila nuk është e përdorur, pasi struktura e miratuar për këtë vit buxhetorë paraqitet në 576 punonjës, ndërsa realizimi paraqitet 558 punonjës pra me një diferencë prej 18 punonjësish kryesisht (mjek specialistë). Mbi zbatimin të buxhetit Spitali Rajonal Korçë ka bërë raportime të përmuajshme në mënyrë elektronike drejt Degës së Thesarit Korçë. Si rezultat i shlyerjes së likujdimeve për vitin 2017, nuk janë krijuar debitorë për vitin 2018. Mbi shtesat dhe pakësimet në zbatimin e buxhetit për vitin 2017 janë bërë me dokumentet dhe shkresat përkatëse.

Për vitin 2018 në mbështetje të Ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, Udhëzimin e Përhershëm të Ministrisë së Financave nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së buxhetit” si dhe shkresën nr.2855 prot., datë 07.06.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë për procedurat e hartimit të projekt buxhetit për vitin 2018-2020, janë dhe anekset dhe pasqyrat përkatëse deri tek formulari nr.2 “Formulari i propozimit të projektit të investimeve (Formulari F2 Aneksi 5.A, Shtojca 2B).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Me shkresën nr.941/1 prot., datë 10.07.2017 mbi projekt buxhetin për vitin 2017 Spitali Rajonal Korçë është drejtuar Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), për çelje fondi sipas këksesës mbi pasqyrat.

Vlera e parashikuar në projekt buxhetin për vitin 2018 nga Spitali Rajonal Korçë në shumën 729,043,000 lekë të ndara në këto zëra:

(600) Shpenzime personeli;	419,834,000 lekë
(601) Shpenzime kontribute;	66,774,000 lekë
(602) Mallra e shërbime të tjera;	242,435,000 lekë
Arkëtimi dhe përdorimi i të ardhurave dytësore në vlerën;	21,909,520 lekë

Lidhur me miratimin e buxhetit vjetor:

Në zbatim të Ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, VKM nr.17, datë 12.01.2018 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, për vitin 2018”, si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë, nr.901 prot., datë 02.01.2018 “Mbi detajimin e numrit të punonjësve të spitaleve për vitin 2018” për shërbimin spitalor **është bërë miratimi i fondeve në shumën totale prej 614,250,000 lekë (financim nga buxheti)** sipas zërave: pagat 368,300,000 lekë, kontribute sigurime shëndetësore dhe shoqërore 60,950,000 lekë, mallra dhe shërbime 185,000,000 lekë.

Gjatë vitit 2018 kanë ndodhur disa ndryshime në buxhetin e miratuar të pasqyruara në tabelën e më poshtme:

Viti 2018	600	601	602	Total
Buxheti 2018 miratuar me shkresën nr.1955/1 prot., datë 01.02.2018	368,300,000	60,950,000	185,000,000	614,250,000
Shtese me shkresën nga FSDKSH nr.20407/2 prot., datë 22.11.2018			5,000,000	5,000,000
Zërat pas ndryshimeve	368,300,000	60,950,000	190,000,000	61,925,000
Pakësim me shkresën nga (MF) nr.20407/2 prot., datë 22.11.2018	- 6,500,000	- 650,000		7,150,000
Zërat pas ndryshimeve	361,800,000	60,300,000	190,000,000	612,100,000

Ndryshimet e buxhetit viti 2018

Analiza e llogarisë 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”:

Për sa i përket shpenzimeve koherente për zërin (602) mallra e shërbime të tjera, sipas situacioneve të thesarit, janë planifikuar gjithsej 190,000,000 lekë dhe janë realizuar 189,999,000 lekë, zërat më kryesor:

1. “Materiale dhe shërbime zyre” përfshin të gjitha shpenzimet e kancelarisë, pastrimit, dokumentacioni etj, për të cilën janë planifikuar 16,097,000 lekë dhe janë realizuar 16,097,000 lekë.
2. “Materiale dhe Shërbime speciale” ka peshën më të madhe të shpenzimeve dhe janë “Medikamente” 43,624,000 lekë, “Materiale mjekimi” 15,063,117 lekë, “Kite e reagentë”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

4,652,520 lekë, “Filma radiologji” 4,086,215 lekë, “Ushqime” 6,276,468 lekë, “Të tjera” 304,680 lekë, për të cilën janë planifikuar 74,008,000 lekë dhe janë realizuar 74,007,000 lekë.

3. “Shërbime nga të tretët” përfshin shpenzimet elektrike, ujë, ngrohje, posta, shërbime telefonike etj. Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në vlerën 73,605,000 lekë dhe janë realizuar 73,605,000 lekë.
4. “Shpenzime mirëmbajtje” përfshin shpenzimet e mirëmbajtjes së aparaturave mjekësore, ndërtimore, impjanistikës etj. Për këtë zë janë planifikuar shpenzime në vlerën 10,146,000 lekë dhe janë realizuar 10,146,000 lekë.

Plani dhe realizimi i zërit mallra dhe shërbime për vitin 2018

000/lekë

Emërtimi	Plan	Fakt
(6020) Materiale e shërbime të përgjithshme zyre	16,097	16,097
(6021) Materiale e shërbime speciale	74,008	74,007
(6022) Shërbime nga të tretët	73,605	73,605
(6023) Shpenzime transporti	13,193	13,193
(6024) Shpenzime udhëtimi	2,911	2,911
(6025) Mirëmbajtje e zakonshme	10,146	10,146
(6027) Shpenzime gjyqësore		
(6029) Shpenzime të tjera operative	40	40
TOTALI (Llog 602)	190,000	189,999

Situata në Spitalin Rajonal Korçë paraqitet për vitin 2018, për zërin mallra dhe shërbime në nivele më të larta se realizimi i pritshëm për vitin 2017, në konsumin faktik, në masën 17%, i cili është përbërë nga rritja për efekt të nivelit të inflacionit vjetor të indeksushëm 2%, për zërat dhe shërbimet tradicionale, pasi bazë përlogaritje për këtë projektbudget, ka qenë konsumi faktik në shumë zëra të shpenzimeve operative, si për barna e materiale të konsumit mjekësor, ushqimet, mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore, si dhe shërbime të tjera të cilat zënë një peshë të madhe. Në krahasim me vitet e kaluara sipas grupit të punës: *është menduar që rritja të jetë si për barna e materiale të konsumit mjekësor, mirëmbajtje aparaturash dhe pajisjesh mjekësore, kite reagente, si dhe shërbime mbështetëse, etj rreth 11 %.*

Për vitin 2018 në Spitali Rajonal Korçë të ardhurat dytësore janë në shumën 21,909,520 lekë

TË ARDHURA DYTËSORE VITI 2018													
PAVIONE	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI
URGJENCE	5,800	2,000	14,300	2,700	4,900	4,300	4,500	5,300	4,100	5,000	5,400	2,300	60,600
PATENTE AR.	1,461,000	1,417,500	1,200,000	1,257,000	1,496,300	1,429,000	1,905,000	1,954,500	1,428,000	1,839,000	1,086,400	1,048,000	1,7521,700
MATERNITET	19,200	10,300	12,500	3,500	12,700	13,000	8,400	13,800	22,500	22,500	18,100	13,900	170,400
SANATORIUM	15,900	17,800	19,300	5,300	10,700	12,100	9,200	26,400	19,500	12,800	6,600	11,500	167,100
LABORATORI	18,300	17,900	14,500	14,200	17,000	14,400	7,500	12,900	10,900	24,200	29,300	27,300	208,400
KARTOTEKE,	3,000		3,000	3,000			220		6,000	3,000			18,220
BANKA E GJAK.			500	1,500	2,500	2,500		500	3,200	4,000			14,700



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

ECO, SCANER	7,200	9,600	13,600	20,600	14,100	14,000	7,000	13,800	14,500	19,900	12,600	12,000	158,900
GRAFI SKOPI	6,800	13,600	9,600	11,000	6,900	4,300	6,100	2,900	11,500	9,100	5,800	10,700	98,300
ONKOLOGJI	1,300	1,600	2,800	2,500	1,500	2,800	1,200	600		1,200	3,700	700	19,900
ORL- OKULIST	21,300	19,900	14,700	10,300	8,300	19,200	6,900	63,500	14,400	19,500	6,300	9,300	213,600
NEUROLOGJI	9,500	5,800	7,500	7,700	12,500	5,900	3,800	6,200	9,400	6,700	4,600	2,500	82,100
KIRUR- ORTOP	6,000	6,400	3,600	3,000	9,800	6,100	5,200	7,300	5,800	12,500	6,100	3,800	75,600
KML+ DIAGNOZE	349,000	297,100	250,300	226,900	275,800	187,200	173,600	150,100	195,500	171,500	178,600	155,800	2,611,400
EKG,FIBRO MAMO	4,000	5,300	3,700	3,700	6,700	4,500	5,700	5,400	5,900	17,100	3,200	10,900	76,100
PATHOLOGJI	50,600	45,900	39,800	34,400	35,800	35,600	28,000	30,300	31,800	35,100	23,100	22,100	412,500
TOTALI	1,978,900	1,870,700	1,609,700	1,607,300	1,915,500	1,754,900	2,172,320	2,293,500	1,783,000	2,203,100	1,389,800	1,330,800	21,909,520

Plani dhe realizimi për të ardhurat dytësore për vitin 2018

000/lekë

Emërtimi Buxhetit	Plan 2018	Realizimi 2018	% Realizimi
(600) Paga (të ardhura)	8,544	325	0.4%
(601) Sig. Shoq. dhe (të ardhura) shëndetësore	358	54	15%
(602) Të ardhura	22,282	13,022	58.4%
(231) Të ardhura	11,060	2,761	25%
Shuma të ardhura	42,244	16,162	38.2%

Për vitin 2018 të ardhurat dytësore janë në shumën 21,909,520 lekë, si dhe të ardhura dytësore të mbartura nga viti 2017 në shumën mbartura 20,334,458 ku në total në vlerën 42,243,978 lekë.

Investimet:

Në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë me nr.2855, datë 07.06.2017 mbi procedurat e hartimit të buxhetit 2018-2020 për pasqyrat dhe analizën e investimeve Spitali Rajonal Korçë me shkresën nr.932 prot., datë 04.07.2017 ka bërë kërkesë për çelje fondi. Në zbatim të Ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018", të udhëzimit të Përherëshëm nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 19.01.2018, si dhe shkresën e Ministrisë së Fncave dhe të Ekonomisë me nr.19433/202 datë 09.02.2018, me shkresën 201/3 prot., datë 15.02.2018 është bërë miratimi i fondit për shpenzimet kapitale për investimet në shumën 177,390,937 lekë për:

(Rikonstruksion i një godine katër kate dhe shtesa anësore për zhvendosjen e Maternitetit brenda korpusit të spitalit Korçë, Supervizion për rikonstruksionin e një godine katër kate dhe shtesë anësore për zhvendosjen e Maternitetit brenda korpusit të spitalit Korçë, kolaudim për rikonstruksionin e një godine katër kate dhe shtesa anësore për zhvendosjen e Maternitetit brenda korpusit të spitalit Korçë, Furnizim vendosje pajisje mjekësore dhe hotelerie për godinën e Maternitetit të spitalit Korçë). Fondi për investime është çelur sipas zërave:

(231) Investimet, Rikonstruksion i një godine	96,865,000 lekë
(231) Investimet, Supervizion për rikonstruksion	375,000 lekë
(231) Investimet, Kolaudim për rikonstruksion	150,000 lekë
(231) Investimet, Furnizim vendosje pajisje.....;	80,000,000 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 2, datë 19.12.2018 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.109/2017, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë me nr.6928/1, datë 21.12.2018 si dhe shkresës nr. 22452/104 prot., datë 31.12.2018 janë bërë pakësimet sipas fondeve të çelura në shumën totale në zërin investimet në shumën 26,000,000 lekë, (furnizim vendosje pajisje mjekësore dhe hotelerisë për godinën e spitalit Korçë) shumë e cila rezulton të mos jetë e përdorur.

Në mënyrë të përmbledhur fondet për vitin 2018 për investimet janë realizuar si më poshtë:

000/lekë

Emërtimi i projektit	Plani 2018	Fakti 2018	% Realizimi
1.Rikonstruksion i një godine katër kate dhe shtesa anësore e zhvendosjes së Maternitetit	96,865	96,854	99.9%
2.Supervizion për rikonstruksion	376	376	100%
3.Kolaudimi	150	133	88.6 %
4. Furnizim vendosje pajisje mjekësore dhe hotelerie për godinën e maternitetit	54,000	53,915	99.8%
Investimet Shuma Buxhet	151,391	151,278	99.9%
Invenstime nga të ardhurat(Pajisje aparatura)	3,264	2,761	84.6%
Investimet gjithësej	154,655	154,039	99.6%

Mbi raportimin dhe zbatimin e Investimeve në Ministrinë e Shëndetësisë Spitali Rajonal Korçë ka paraqitur shkresat si më poshtë:

- Shkresa nr.120 prot., datë 22.01.2018
- Shkresa nr. 804 prot., datë 05.07.2018
- Shkresa nr. 914 prot., datë 07.08.2018

Mbi raportimin e realizimit të Investimeve Publike në Shëndetësi, Spitali Rajonal Korçë ka paraqitur zbatimin dhe realizimin e Investimeve Publike drejt Ministrisë së Shëndetësisë.

Zbatimi vjetor i buxhetit sipas rakordimeve me thesarin:

Në mënyrë të përmbledhur fondet për vitin 2018, realizimi vijon si më poshtë:

000/lekë

Emërtimi Buxhetit	Realizimi 2017	Buxhet 2018	Realizimi 2018	% Realizimi
(600) Paga (buxhet)	348,489	360,852	358,309	99.3%
(601) Sig. sho dhe (buxhet) shendetësore	57,746	60,300	59,396	98.5%
(606) (Përdorim f.veçant për ndihma, sëmundje)	912	948	948	100%
(602) Buxhet	216,880	190,000	189,999	100%
(231) Buxhet	30,261	151,391	151,278	99.9%
Shuma buxhet	654,288	763,491	759,930	99.5%
(600) Paga (të ardhura)	5,722	8,544	325	0.4%



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

(601) Sig. Shoq. dhe (të ardhura) shëndetësore	955	358	54	15%
(602) Të ardhura	17,808	22,282	13,022	58.4%
(231) Të ardhura	7,894	11,060	2,761	25%
Shuma të ardhura	32,379	42,244	16,162	38.2%
<i>Shuma gjithsej</i>	686,667	805,735	776,092	96.3%

Tabela e hartuar nga grupi i auditimit referuar të dhënave të marra nga thesari dhe situacionet e hartuara nga institucioni. Në mënyrë të detajuar realizimin e shpenzimeve korrente me fondet e buxhetit për vitin 2018.

Me shkresën nr. 95 prot., datë 16.01.2019 drejtuar FSKDSH-së (Drejtoria Ekonomike Tiranë) për realizimin e buxhetit për vitin 2018. Mbi raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi Spitali Rajonal Korçë nuk ka zbatuar dispozitat ligjore në kundërshtim me neni 65, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet e tij, në të citohet: “Nëpunësi autorizues të njëjësive qendrore i paraqesin, sa herë i kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxheiti për performancën financiare”. Mbi zbatimit të buxhetit Spitali Rajonal Korçë ka bërë raportime të përmuajshme në mënyrë elektronike drejt Degës së Thesarit Korçë. Për vitin 2018 ka pasur pakësime në buxhetit sipas zërvave në shumën : pagat 6,500,000 lekë, kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore 650,000 lekë. Kjo situatë si pasojë pasi struktura e miratuar për këtë vit buxhetorë paraqitet në numrin e punonjësve 565, ndërsa realizimi paraqitet 553 punonjës pra një diferencë prej 12 punonjësish kryeshit (Mjek specialist).

Për vitin 2017 fondi i miratuar në shumën 659,998,000 lekë, për 2018 në shumën 763,490,937 lekë. Në periudhën 2018, rezulton një rritje fondi në vlerë 103,492,937 lekë më tepër se në vitin 2018.

Si rezultat mos shlyerjes së likujdimeve për kontratat për vitin 2018, Spitali Rajonal Korçë janë krijuar debitorë në vlerën në shumën 30,319,970 lekë, vlerë e likujduar në gjatë tre mujorit të parë të vitit 2019.

Me shkresën nr.96 prot., datë 16.01.2019 mbi zbatimin e buxhetit si dhe shlyerjen e detyrimeve për vitin 2018, në mbështetje të VKM nr.50, datë 05.02.2014 “Mbi parandalimin e shlyerjen e detyrimeve të Prapambetura” si dhe shtojcën nr.3, të “Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e Detyrimeve të prapambetura” Spitali Rajonal Korçë ka bërë kërkesë drejt Ministrisë së Shëndetësisë për aprovim fondi në shumën 31,119,290 lekë për shlyerjen e likujdime të kontratave për vitin 2018, detyrim i trashëguar për vitin 2019.

(6020) Materiale dhe shërbime zyre dhe të përgjithshme;	8,753,000 lekë
(6021) Materiale dhe shërbime speciale;	16,710,000 lekë
(6029) Shpenzime të tjera operative (Proces Gjyqësor);	<u>5,560,000 lekë</u>
Shuma:	31,023,000 lekë

Lista e kontratave, proceset gjyqësore të pa likujduara për vitin 2018

Kodi	Subjekti	Emërtimi	Shuma e faturës	Periudha
1013019	I. SHPK	Lëndë djegëse	8,752,800	Shtator -Dhjetor
1013019	T.	Medikamente	1,358,264	Shtator -Dhjetor
1013019	M. F.	Medikamente	1,921,305	Shtator -Dhjetor
1013019	F.	Medikamente	229,955	Shtator -Dhjetor



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

1013019	E.	Medikamente	101,675	Shtator -Dhjetor
1013019	L.	Medikamente	195,682	Shtator -Dhjetor
1013019	I.	Medikamente	304,500	Shtator -Dhjetor
1013019	A.	Medikamente	1,800,280	Shtator -Dhjetor
1013019	CFO P.	Medikamente	894,625	Shtator -Dhjetor
1013019	M.	Medikamente	685,434	Shtator -Dhjetor
1013019	A. F.	Medikamente	1,228,490	Shtator -Dhjetor
1013019	E. F.	Medikamente	722,825	Shtator -Dhjetor
1013019	R. F.	Medikamente	43,250	Shtator -Dhjetor
1013019	I.	Medikamente	39,585	Shtator -Dhjetor
1013019	E. MM4	Materiale mjekimi	1,028,526	Shtator -Dhjetor
1013019	OES D. MM4	Materiale mjekimi	1,556,562	Shtator -Dhjetor
1013019	M.	Materiale mjekimi	944,190	Shtator -Dhjetor
1013019	B.	Materiale mjekimi	825,342	Shtator -Dhjetor
1013019	S. m.	Filma scaneri	552,780	Shtator -Dhjetor
1013019	E.	Ushqime (Koloniale Zarzavate)	640,908	Shtator -Dhjetor
1013019	G.	Ushqime (Mish)	774,066	Shtator -Dhjetor
1013019	F. B.	Ushqime (Qumësht)	133,560	Shtator -Dhjetor
1013019	E. K.	Të ndryshme	25,300	Shtator -Dhjetor
1013019	PR. Gjq. “Me.” Përmb. V. Z.	Proces Gjyqësor M. me përmb. V. Z.	4,501,403	Shtator -Dhjetor
1013019	PR. Gjq. “R. B.” Përmb. A. S.	Proces Gjyqësor R. B. me përmb. A. S.	404,400	Shtator -Dhjetor
1013019	PR. Gjq. “B.I.” Përmb. S. Ç.	Proces Gjyqësor B. I. me përmb. S. Ç.	454,263	Shtator -Dhjetor
1013019	PR. Gjq. “V. D.” Përmb. B. S.	Proces Gjyqësor V. D. me përmb. B. S.	200,000	Shtator -Dhjetor
	SHUMA		30,319,970	

Proceset gjyqësore për vitet 2017/2018:

1. Procesi gjyqësor me subjektin “M.”, fituar nga ky subjekt, likujduar në Zyrën e përmb. V. Z.”. Tender medikamentesh fituar nga subjekti “M.”, kontrata e lidhur në tetor të vitit 2011, Dega e Thesarit Korçë nuk pranoi Depozitim Kontrate, kontrata u zbatua nga ana e subjektit kurse Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë nuk ka bërë likujdim, pasi nuk e pranoi Dega e Thesarit pasi kishte kaluar afati për depozitim. Me Vendimin e Gjykatës Administrative Shkalla e Parë nr.400, datë 22.04.2016 dhe vendimin e Apelit nr.2545, datë 22.06.2018 subjekti “M.” fiton gjyqin me Spitalin Rajona Korçë në shumën 4,501,403 lekë ku spitali ka bërë likujdim në mars të vitit 2019.
2. Procesi gjyqësor me mjekun anatomopatholog z. R. B., i cili ka punuar në Shërbimin e Anatomopathologjisë për një periudhë 6 mujore, për 3 orë në ditë duke mbuluar shërbimin dhe analizat. Spitali Rajonal Korçë kishte një akt marrëveshje e cila nuk u likujdua, por në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

mungesë fondesh. Në mbështetje të Vendimit të Gjykatës Administrative Shkalla e Parë nr.89, datë 17.02.2015 dhe Vendimit të Apelit nr.2017, datë 22.02.2018 Spitali Rajonal Korçë nëpërmjet Zyrës së përmarrimit “A. S.” në shumën 404,400 lekë kreu likuidimin në mars të vitit 2019.

3. Procesi gjyqësor me mjekun anatomopatholog z. R. B., renimator pranë këtij spitali, për një periudhë kohore relativisht të gjatë ka punuar i vetëm për të mbajtur, Reanimacionin dhe Maternitetin në spital. Nëpërmjet gjykatës ka kërkuar likuidim për orët shtesë të punës të cilat u argumentuan me ekspert nga gjykate ku fitoi gjyqin sipas, Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nr. 269, datë 02.03.2018 dhe Vendimit të Apelit nr. 304, datë 18.07.2019 për shumën 454,263 lekë të likuiduar në Zyrën e përmarrimit S. Ç. në mars të vitit 2019.
4. Procesi gjyqësor për punonjësin znj. V. D. me profesion juriste në Spitalin Rajonal Korçë. Larguar nga puna pas një periudhe 6 mujore. Me Vendimin e Gjykatës Administrative Shkalla e Parë nr. 354, datë 06.07.2015 dhe Vendimin e Apelit nr. 3621, datë 16.10.2018 fitoi gjyqin ndaj Spitali Rajonal Korçë në shumën 200,000 lekë e cila u likuidua nga Spitali Korçë në mars të vitit 2019.
5. Proçes gjyqësor likuidimin e përfituesit z. J. F., sipas detyrimit financiar që rrjedh nga ekzekutimi i Vendimit nr.591, datë 21.10.2010, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë i lënë në fuqi nga Vendimi nr. 690, datë 21.02.2017 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe Drejtoria e Shërbimit Spitalor detyrohet ta ekzekutojë sipas buxhetit të akorduar për këtë institucion 3,048,007 lekë.

Konsumi i mallrave “Barna dhe materiale mjekësore”:

SHPENZIME VITI 2017				
NR.	EMËRTIMI	OPERATORI EKONOMIK	SHPENZIM	PLAN
1.	BLERJE KITE DHE REAGENT		4,574,328	4,574,328
	KONTRATA 2	G.	4,574,328	
2.	BLERJE MATERIALE MJEKIMI		22,816,388	22,816,388
	KONTRATA 2	E.	5,095,636	
	KONTRATA 3	O. D.	5,946,750	
	KONTRATA 4	M.	6,659,482	
	KONTRATA 5	B.	5,114,520	
	FILMA E SOLUCIONE		3,464,790	3,464,790
3.	FILMA SOLUCIONE	S. M. (P.)	1,744,590	
	FILMA SOLUCIONE	A. PH.	1,720,200	
4.	BLERJE MEDIKAMENTE MJEKËSORE		59,900,119	59,900,119
	KONTRATA	I.	5,159,610	
	KONTRATA	F.	5,072,600	
	KONTRATA	A. F.(K.)	7,813,941	
	KONTRATA	I.	94,800	
	KONTRATA	M. F.	4,932,423	
	KONTRATA	M.	7,622,128	
	KONTRATA	T.	5,636,431	
	KONTRATA	E. F.	4,392,012	
	KONTRATA	A.	4,313,491	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

KONTRATA	F. F.	803,090
KONTRATA	V. F.	198,020
KONTRATA	F. O. (N2) (KP1)	646,811
KONTRATA	R. F.	1,961,060
KONTRATA	I. F.	2,073,246
KONTRATA	L.	617,696
KONTRATA	E.	336,000
KONTRATA	C. P.	1,633,510
KONTRATA	A. N. F.	57,400
KONTRATA	S. G. (N3)	188,338
OKSIGJEN MJEKËSOR	M. A.	6,347,512

SHPENZIME VITI 2018				
Nr.	EMËRIMI	OPERATORI EKONOMIK	REALIZIM	PLAN
1.	BLERJE KITE DHE REAGENT		4,652,520	4,652,520
	KONTRATA 2	G.	4,652,520	
2.	BLERJE MATERIALE MJEKIMI		15,063,350	15,063,350
	KONTRATA 2	E.	5,213,861	
	KONTRATA 3	O. D.	3,445,569	
	KONTRATA 4	M.	3,012,870	
	KONTRATA 5	B.	3,391,050	
	KONTRATA 6	F. F. (S.)	0	
3.	FILMA E SOLUCIONE		4,086,216	4,086,216
	KONTRATA	S. M. (P.)	2,484,420	
	KONTRATA	A. P.	1,601,796	
4.	BLERJE MEDIKAMENTE MJEKËSORE		43,624,365	43,624,365
	KONTRATA	I.	3,444,590	
	KONTRATA	F.	1,884,170	
	KONTRATA	A. F.	4,007,718	
	KONTRATA	I.	37,200	
	KONTRATA	M.F.	6,382,314	
	KONTRATA	M.	3,209,774	
	KONTRATA	T.	3,802,116	
	KONTRATA	E. F.	2,006,099	
	KONTRATA	A.	6,599,453	
	KONTRATA	F. F.	38,450	
	KONTRATA	F. O.	2,590	
	KONTRATA	R. F.	778,722	
	KONTRATA	I. F.	271,530	
	KONTRATA	L.	136,530	
	KONTRATA	E.	661,310	
	KONTRATA	C. P.	2,570,410	
	KONTRATA	A. N. F.	60,950	
	KONTRATA	F. N. A.	159,764	
	KONTRATA	F. N. A.	4,890	
	OKSIGJEN MJEKËSOR	M. A. G. G.T	7,565,785	

Barnat e skaduara në fund të periudhës 2017:

Nga proces verbali i mbajtur me datë 13.12.2017, nga komisioni i ngritur për inventarizimin e materialeve dhe medikamenteve në farmaci, rezultuan 6 medikamente të skaduara me vlerë 254,553 lekë.

Nga analiza e marrjes në dorëzim të medikamentit Interferon alfa 2 beta, 20 njësi me vlerë 235,820 lekë u konstatua se afati i skadimit të barnave për dy kontratat e lidhura, ishte më pak se 12 muaj.

Më datë 29.03.2016, me nr. 345 prot, AK i përfaqësuar nga z. P. P., ka lidhur kontratën me OE "M." SH.P.K., me vlerë 320,360 lekë pa TVSH, duke kontraktuar dhe për sasinë 10 njësi Interferon alfa 2 beta, me vlerë 117,910 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Në kushtet e furnizimit të kontratës është parashikuar se data e skandencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë më e vogël se $\frac{1}{2}$ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës por në çdo rast jo më e vogël se 12 muaj. Afati i zbatimit të kontratës është deri më datë 15.04.2017.

Më datë 25.04.2016, me nr. 438 prot., AK i përfaqësuar nga z. P. P., ka lidhur një kontratë tjetër me vlerë 117,910 lekë pa TVSH, me objekt “Blerje medikamente për nevojat spitalore”, për sasinë 10 njësi Interferon alfa 2 beta.

Më datë 17.05.2016, komisioni i farmacisë së Spitalit Rajonal Korçë i përbërë nga z. S. V., znj. Zh. B., z. A. N., z. Z. N., z. K. N., ka pranuar sasinë e 10 njësive me afat skadimi 02/2017, në kundërshtim me afatin jo më pak se 12 muaj.

Më datë 27.06.2016, komisioni i farmacisë së Spitalit Rajonal Korçë i përbërë nga znj. R. P., znj. Zh. B., znj. A. N., znj. Z. N., z. K. N., ka pranuar sasinë e 10 njësive me afat skadimi 04/2017, në kundërshtim me afatin jo më pak se 12 muaj.

Për sa më sipër për dëmin ekonomik në vlerën 235,820 lekë, mbajnë përgjegjësi komisionet e marrjes në dorëzim të barnave si dhe drejtori z. P. P. i cili ka lidhur kontratën e dytë për Interferon në kushtet kur nuk ishte ekzekutuar kontrata e parë, dhe për më tepër i kishte kaluar afati i dorëzimit.

Barnat e skaduara në fund të periudhës 2018

Nga proces verbali i mbajtur me datë 20.12.2017, nga komisioni i ngritur për inventarizimin e materialeve dhe medikamenteve në farmaci, rezultoi 1 medikament i skaduara me vlerë 9,500 lekë.

Observacioni:

Nga observacioni i subjektit konstatohet se kjo shumë është rekomanduar nga auditimi FSDKSH-së datë 16.01.2019. nr. 93 dhe në zbatim të saj ka dalë dhe urdhri për shlyerjen e tyre nga personat e sipër përmendur.

Audituesi:

Në relacionin e bërë nga subjekti mbi shlyerjen e dëmit, nuk është qartë mënyra e shpërndarjes së detyrimit të krijuar aq më tepër për personat e sektorit të farmacisë të cilët janë dhe përgjegjësit kryesorë, pasi janë ato që mbajnë përsipër përgjegjësinë e llojit të medikamentit në përbërje dhe afat skandecë nisur dhe nga profesioni i tyre.

Për sa i përket nxjerrjes së urdhërit për likuidim dhe fillimi i shlyerjes së detyrimit të krijuar ky observacioni merret në konsideratë.

C. Në zbatim të pikës C të programit të auditimit, mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” u konstatua si më poshtë.

1. Zbatim i kontratës së furnizimit me mallara: **Loti 1 “Furnizim vendosje pajisje mjekësore dhe pajisje mobilimi spitalor” për Spitalit Korçë.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Në lidhje me kontratën e furnizimit nr. 955 prot., datë 17.08.2018 midis operatorit ekonomik “O. D.” përfaqësuar nga znj. O. J. dhe Spitalit Rajonal Korçë përfaqësuar nga titullari z. A. K. në zbatim të procedurës së prokurimit nr. REF-Nr 376 datë 08.05.2018 zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë për furnizim vendosje të pajisjeve mjeksore nga verifikimi i zbatimit të kontratës u konstatua se: Kontrata midis palëve e lidhur më 17.08.2018 me vlerë 5,582,450 lekë pa TVSH ose 6,698,940 lekë me TVSH është nënshkruar me një afat realizimi kontrate prej 45 ditësh duke filluar më 03.09.2018 dhe afat përfundimi 18.10.2018.

Më 15.10.2018 me shkresën nr. 66 prot., Pranuar në protokollin e SRK me nr. 1630 prot., datë 16.10.2018 operatori ekonomik “O. D.” paraqet kërkesën për shtyerje afati kontrate deri më 15.12.2018 pra edhe 58 ditë të tjera përtej afatit të iniciuar në procedure e prokurimit nga Ministria e Shëndetësisë si dhe përtej cdo afati të pranueshëm llogjik nisur dhe nga kërkesa prej 12 ditë më tepër se kontrata fillestare.

Operatori ekonomik “O. D.” e paraqet këtë kërkesë me justifikimet si më poshtë: *...në Kinë ka patur një taffun/stuhi , në periudhën nga 4 shatori deri më 16 shator 2018. Kjo force madhore është bërë shkak për mbylljen e portit të Shangait, duke bllokuar dhe spostuar nisjen e çdo llojë mjete lundrimi gjatë këtyre ditëve...nga data 1 deri më 7 tetor 2018, e gjithë Kina ka qenë pushim për shkak festive zyrtare...*

-Nisur nga sa më sipër titullari i institucionit z. A. K. ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1654 prot., datë 22.10.2018 ku shprehet: *Drejtoria e Shërbimit Spitalorë Korçë, në konsultë edhe me specialistët përkatës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirqënies Sociale, merr parasysh kërkesën tuaj për shkaqet e referuara të vonës në realizimin e kontratës së furnizimit të pajisjeve për Maternitetin e ri. Si dhe afati maksimal do të jetë 06.12.2018.*


Në reference të sa më sipër titullari i institucionit si dhe operatori ekonomik kanë nënshkruar amendimin e kontratës me nr. 1742 prot., datë 08.11.2018, pra kontrata është hartuar dhe nënshkruar 21 ditë pas përfundimit të kontratës fillestare, juridikisht kjo kontratë quhet e përfunduar në afat.

Gjithashtu titullari i autoritetit kontraktorë i lidh një kontratë operatorit ekonomik me 94 ditë afat nga 45 që kishte pra edhe 49 ditë të tjera nga afati maksimal i kontratës fillestare, edhe nëse plotësohen kushtet për zgjatjen e afati ky afat nuk mund të tejkaloj afatin e kontratës bazë. Gjithashtu nga ana e drejtorisë së shërbimit spitalorë Korçë nuk janë analizuar shkaqet e pretenduara nga operatori “O. D.” pasi për sa i përket pretendimit kryesorë motit të keq, ky pretendim nuk qëndron dhe është lehtësiht i verifikueshëm në Web paget e ndryshme të motit për këtë qytet “Shangain” ku moti për datat e pretenduara nga operatori ekonomik është mëse i mirë. Gjithashtu operatori ekonomik e ka lidhur kontratën më 17.08.2018 pra ka patur më shumë se kohë të mjaftueshme për bërjen e porosis dhe nisjen e saj nga Shangai për në Shqipëri, për këtë “O. D.” mund të paraqiste kontratën e porosisë me firmën prodhuese si dhe faturën e pagimit të principalit të mallit siç operohet mbi të cilën, dhe SRK të mbështetej për pranimin e kërkesës dhe justifikimin e afatit të kërkuar si rrjedhojë e motit. Më poshtë po paraqesim motin në këtë qytet që nga operatori ekonomik pretendohet me stuhi.




KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

September 2018 Weather in Shanghai — Graph



September 2018 Weather in Shanghai — Graph



Siç duket dhe në grafikët e paraqitur moti në këtë qyrtet është mëse i mirë, për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron si dhe shtimi i afati nuk justifikohet aq më tepër që nuk është paraqitur asnjë dokument vërtetues e dëshmuar për bërjen e porosisë.

Për sa i përket pretendimit që më 1-7 tetor janë festa kombëtare në Kinë, ky pretendim qëndron por jemi rreth 43 ditë nga nëshkrimi i kontratës, praktikisht porosia duhet të jetë dhënë që në momentin e nëshkrimit të saj duke qënë se transporti zgjat mesatarisht 30 ditë, por kjo porosi nuk ka qënë dhënë akoma.

Nga furnizimi përtej afateve të parashikuara në kontratë nr. 955 prot., datë 17.08.2018 dhe në shkelje të nenit nr. 3 afati i kontratës i cili është 45 ditë me afat përfundimi 18.10.2018 si dhe në mos llogaritjen e penaliteve në respektim të nenit 5 “kushtet e kontratës” ku citohet: *...Në rast se kontraktuesi vonon furnizimin sipas kërkesave të institucionit atëhere detyrohet të paguaj penaltet në masën, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës së mbetur ...operatorit ekonomik “O. D.” i lind detyrimi të shlyej penaltet në vlerën 1,451,235 lekë.*

-Furnizimi i parë i operatorit ekonomik vjen me faturën tatimore të shitjes nr. 225934401 datë 17.10.2018 për artikujt e më poshtëm:

Kodi	Emërtimi	Prodhues/Model	Sasia	Cmimi	Vlera pa tvsh	Tvsh	Vlera me Tvsh
SKH103	Dollap Pacienti	Saikang/ SKH103	25	19,000	475,000	95,000	570,000
SKS105	Komedinë Pacienti	Saikang/ SKS105	45	6,000	270,000	54,000	324,000
	total				745,000	149,000	894,000



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Këto produkte operatori ekonomik "O. D." i ka furnizuar brenda afati të kontratës fillestare, gjithashtu nga procesverbali i dorzimit datë 05.12.2018 nënshkruar nga: për spitalin Korçë, znj. E. K., z. Gj. N., z. A. P. si dhe znj. E. M. ndërsa për "O. D." nga ing. A. P. dhe inf. A. V. ku për zërin **dollap pacienti** dhe **Komedinë Pacienti** deklarohet se: prodhuesi është kompania Kineze "S." modelet janë SKH103 (dollar) dhe SKS105 (Komodinë).

Nga verifikimi i kësaj kompanie në web page dhe modeleve të deklaruara rezultoi se kjo kompani nuk disponon asnjë model nga këto që operatori ekonomik pretendon se i ka importuar nga Kina dhe nga kjo Kompani duke mos disponuar asnjë dokumnet vërtetues dhe dëshmuues për importin e këtyre produkteve nga Kina. Bashkangjitur keni dhe verifikimet në web pagin e kompanisë së deklaruar duke vënë në dyshim vërtetësinë e ofrimit të produkteve nga kjo kompani dhe mundësinë e prodhimit të tyre në Shqipëri.

<http://www.sk-med.com/search.asp?page=1&search=SKS>

<http://www.sk-med.com/search.asp?page=4&search=SKH>

Ofrimi i produkte pa asnjë origjinë dëshmuuese e vërtetuese për origjinalitetin e tyre, mungesa e tyre në katalogun e produkte të kompanisë prodhuese "S." Kinë dhe mos identifikimi të asnjë të dhëne për origjinalitetin e tyre nga ky prodhues, nisur dhe nga fakti se janë për përdorim spitalore dhe ofrimi i produkteve pa asnjë garaci në cilësinë e tyre **përbën dëm e konomik për buxhetin e shtit në vlerën 894,000 lekë** dhe duhen zëvendësuar me produktet e kërkuara dhe deklaruara.

-Furnizimi i i dytë i operatorit ekonomik vjen me faturën tatimore të shitjes nr. 225934967 datë 05.12.2018 për artikujt e më poshtëm:

Kodi	Emërtimi	Prodhues/Model	Sasia	Cmimi	Vlera pa tvsh	Tvsh	Vlera me Tvsh
XM001	Barrelë Spitalore	Xuhua / XHZ-1	2	65,450	130,900	26,180	157,080
XM002	Krevat Neonatal	Xuhua / XHE20B	10	19,651	196,510	39,302	235,812
XM003	Shtrat Pacienti	Xuhua / XHS-1	45	75,180	3,383,100	676,620	4,059,720
XM004	Shtrat reanimacioni	Xuhua / XHD-2	3	158,950	476,850	95,370	572,220
XM005	Shtrat vizitash mjek	Xuhua / XHJ-2	8	12,160	97,280	19,456	116,736
XM006	Shtrat ekaminimi	Xuhua / XHFJ-3	3	44,020	132,060	26,412	158,472
	total				4,416,700	883,340	5,300,040

Këto produkte operatori ekonomik "O. D." i ka furnizuar përtej afati të kontratës fillestare, procesverbali i dorzimit datë 05.12.2018 nënshkruar nga: për spitalin Korçë, znj. E. K., z. Gj. N., z. A. P. si dhe znj. E. M. ndërsa për "O. D." nga ing. A. P. dhe inf. A. V.

Për sa i përket zërit 5 të faturës Shtrat vizitash mjeksore me kod XM005 me kompani prodhuese "Xh." (kinë) me kod produkti XHFJ-2 nga verifikimi në web pagin dhe krahasimi me produktin e furnizuar, produkti nuk ka asnjë ngjashmëri me produktin e furnizuar, bashkangjitur linku i kompanisë prodhuese të deklaruar nga operatori ekonomik "O. D." në procesverbalin e datës 05.12.2018, si dhe fotot krahasuese të produktit.

http://en.xuhuamedical.com/products_search_result/keyword=XHE20B&method=submit&searchType=1.html



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.



XHE20B Hospital infant bed



Ofrimi i produkte pa asnjë origjinë dëshmuere e vërtetuese për originalitetin e tyre, mungesa e tyre në katalogun e produkte të kompanisë prodhuese "X." Kinë dhe mos identifikimi të asnjë të dhëne për originalitetin e tyre nga ky prodhues, nisur dhe nga fakti se janë për përdorim spitalore dhe ofrimi i produkteve pa asnjë garaci në cilësinë e tyre **përbën dëm e konomik për buxhetin e shtit në vlerën 235,812 lekë** dhe duhen zëvendësuar me produktet e kërkuara dhe deklaruar.

Për sa i përket zërit 2 të faturës Krevat neonat me kod XM002 me kompani prodhuese "X." (kinë) me kod produkti XHE20B nga verifikimi në web pagën dhe krahasimi me produktin e furnizuar, produkti nuk ka asnjë ngjashmëri me produktin e furnizuar, bashkangjitur linku i kompanisë prodhuese të deklaruar nga operatori ekonomik "O. D." si dhe fotot krahasuese të produktit.

http://en.xuhuamedical.com/products_search_result/keyword=XHE20B&method=submit&searchType=1.html



XHFJ-2Multi-function delivery couch



Ofrimi i produkte pa asnjë origjinë dëshmuere e vërtetuese për originalitetin e tyre, mungesa e tyre në katalogun e produkte të kompanisë prodhuese "X." Kinë dhe mos identifikimi të asnjë të dhëne për originalitetin e tyre nga ky prodhues, nisur dhe nga fakti se janë për përdorim spitalore dhe ofrimi i produkteve pa asnjë garaci në cilësinë e tyre **përbën dëm e konomik për buxhetin e shtit në vlerën 116,736 lekë** dhe duhen zëvendësuar me produktet e kërkuara dhe deklaruar.

-Furnizimi i i tretë i operatorit ekonomik vjen me faturën tatimore të shitjes nr. 225934968 datë 05.12.2018 për artikujt e më poshtëm:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Kodi	Emërtimi	Prodhues/Model	Sasia	Cmimi	Vlera pa tvsh	Tvsh	Vlera me Tvsh
XM007	Shtrat lindjesh elektrik	Xuhua / XHFJ-1	1	140,250	140,250	28,050	168,300
	total				140,250	28,050	168,300

Këto produkte operatori ekonomik “O. D.” i ka furnizuar përtej afati të kontratës fillestare, procesverballi i dorzimit datë 05.12.2018 nënshkruar nga: për spitalin Korçë, znj. E. K., z. Gj. N., z. A. P. si dhe znj. E. M. ndërsa për “O. D.” nga ing. A. P. dhe inf. A. V.

Nga verifikimi fizik i këtij produkti rezultoi se:

Shtrati nuk ishte konform specifikimeve teknike të parashikuara në kontratë ku cilësohej: *Me tre motorë për rregullimin elektrik të lartësisë, shpinës dhe pozicioneve Tredelburg/Reversë Tredelburg.*

Ky krevat dispononte vetëm 2 motorë levizjeje edhe pse lëvizjet e shtratit u kryenin nga këto të dy, kjo rëndonte peshën e secilit elektromotor.

Amortizatorë goditjesh gjatë lëvizjes.

Ky shtrat nuk dispononte amortizator për zbutjen e goditjeve gjatë lëvizjes e për rrjedhojë nuk plotëson specifikimet teknike.

Pesha mbajtëse 200 kg +/- 10%

Nuk u verifikua asnjë dokument për garancin e peshmbajtjes dhe mirfunksionimit me peshën e përcaktuar të levizjeve elektrike të shtratit.

Bacinelë inoksi me fiksues përkatës

Në shtrat nuk u verifikua asnjë element inoksi dhe ato të disponuara dhe pretenduar në një afat as 6 muaj përdorim ishin korrosionuar, që tregon elementin hekur në të dhe jo INOKS.

Gjithashtu nga verifikimi në web-pagen e kompanisë prodhuese produkti me kod XHFJ-1 i deklaruar Shtrat lindjesh elektrik sipas procesverballit të dorzimit, nuk korespondon në asnjë element me shtratin e furnizuar nga operatori në SRK.

http://en.xuhuamedical.com/products_search_result/keyword=XHFJ-1&method=submit&searchType=1.html



XHFJ-1 Multi-function delivery couch



-Nisur nga mangësitë e sipërcituara produkti është pranuar në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, nenin 77 mbikqyrja e kontratës si dhe me nenin 6. Specifikimet teknike të kontratës së nënshkruar mes palëve e për rrjedhojë duhe të zëvendësohet nga operatori ekonomik “O. D.”, vlera prej **168,300 lekë përbë dëm ekonomik** deri në zëvendësimin e shtratit sipas specifikimeve të prokuruar.

-Furnizimi i i tretë i operatorit ekonomik vjen me faturën tatimore të shitjes nr. 225934983 datë 06.12.2018 me datë të korigjuar 5.12.2018 për artikujt e më poshtëm:

Kodi	Emërtimi	Prodhues/Model	Sasia	Cmimi	Vlera pa tvsh	Tvsh	Vlera me Tvsh
------	----------	----------------	-------	-------	---------------	------	---------------



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

XM007	Shtrat lindjeje elektri	Xuhua / XHFJ-1	2	140,250	280,500	56,100	336,600
	total				280,500	56,100	336,600

Këto produkte operatori ekonomik "O. D." i ka furnizuar përtej afati të kontratës fillestare, procesverbalit i dorzimit datë 05.12.2018 nënshkruar nga: për spitalin Korçë, znj. E. K., z. Gj. N., z. A. P. si dhe znj. E. M. ndërsa për "O. D." nga ing. A. P. dhe inf. A. V.

Nga verifikimi fizik i këtij produkti rezultoi se:

Shtrati nuk ishte konform specifikimeve teknike të parashikuara në kontratë ku cilësohej: *Me tre motorë për rregullimin elektrik të lartësisë, shpinës dhe pozicioneve Tredelburg/Reversë Tredelburg.*

Ky krevat dispononte vetëm 2 motorë levixjeje edhe pse lëvizjet e shtratit u kryenin nga këto të dy, kjo rëndonte peshën e secilit elektromotor.

Amortizatorë goditjesh gjatë lëvizjes.

Ky shtrat nuk dispononte amortizator për zbutjen e goditjeve gjatë lëvizjes e për rrjedhojë nuk plotëson specifikimet teknike.

Pesha mbajtëse 200 kg +/- 10%

Nuk u verifikua asnjë dokument për garancin e peshmbajtjes dhe mirfunksionimit me peshën e përcaktuar të levizjeve elektrike të shtratit.

Bacinelë inoksi me fiksues përkatës

Në shtrat nuk u verifikua asnjë element inoksi dhe ato të disponuara dhe pretenduar në një afat as 6 muaj përdorim ishin kororozionuar, që tregon elementin hekur në të dhe jo INOKS.

Gjithashtu nga verifikimi në web pagën e kompanisë prodhuese produkti me kod XHFJ-1 i deklaruar Shtrat lindjeje elektrik sipas procesverbalit të dorzimit, nuk korespondon në asnjë element me shtratin e furnizuar nga operatori në SRK.

http://en.xuhuamedical.com/products_search_result/keyword=XHFJ-1&method=submit&searchType=1.html

-Nisur nga mangësitë e sipërcituara produkti është pranuar në kundërshtim vkm 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, nenin 77 mbikqyrja e kontratës si dhe me nenin 6. Specifikimet teknike të kontratës së nënshkruar mes palëve e për rrjedhojë duhe të zëvendësohet nga operatori ekonomik "O. D.", vlera prej **336,600 lekë përbë dëm ekonomik** deri në zëvendësimin e shtratit sipas specifikimeve të prokuruar.

-Gjithashtu për sa më sipër audituesit e KLSH verifikuan dhe dokumentacionin e dorëzuar për kualifikim nga operatorët ekonomik (katalogun e produkteve) nga ku u konstatua se operatori ekonomik "O. D." ka ngarkuar në sistmin SPA për kualifikim kataloge produktesh të ndryshuara nga ato të kompanisë prodhuese, në to dyshohet se fotot e ilustruese për të identifikuar produktin janë montuar duke zëvendësuar produktet origjinale të kompanisë prodhuese që vetë operatori ekonomik deklaroi në procedurën e prokurimit, veprime këto që ngarkojnë me përgjegjësi operatorin ekonomik "O. D." veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar neni **Neni 47 ku citohet: Autoriteti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme¹, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës. Autoriteti kontraktor për çdo skualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji.**

-Në përgjigje të observacion nr. 1141 prot datë 05.07.2019 ju bëjmë me dije se nuk merret në konsideratë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Së pari grupi i auditimit ka analizuar kërkesën e operatorit ekonomik dhe në atë kërkesë nuk cilësohen asnjëherë këto pretendime që ju shfaqni në observacion; ...Kordinimi i punës ndërtimore me punimet e instalimit të pajisjeve mjeksore.

Së dytë: vërtet DST e parashikon këtë zgjatje afati por nëse e lexojmë të dyja palët njësoj: Ak mund të pranojë zgjatje afati edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik...Këtu kemi vetëm interesin privat.

Së treti: Opearatori ekonomik "O. D." ka çënuar legjitimitetin e kontratë duke ofruar prodkute në shkëlje të cka është kualifikuar dhe shpallur fitues, Ju me të drejtë thoni që është detyrë e KVO pranë Ministrisë për identifikimine modifikimit të dokumentacionit, Por është detyrë dhe e Jona për identifikimine dhe nxjerrij para përgjegjësis OE, ndërsa nga ana Juaj veprohet ndryshe për produktin krevat Neonatal që ndryshe është ne dokumentacionin ofertues e ndryshe është pranuar nga Ju, nuk shpreheni fare, ndërsa për tjetërat që janë lehtësiht të verifikueshme pretendoni se OE i ka furnizuar sipas dokumentacionit.

-Sa më sipër observacioni nuk merret në konsiderat, përse i takon njoftimit të fituesit observacioni pranohet.

2. Zbatimi i kontratës së furnizimit me mallara: Loti 2 "Furnizim vendosje pajisje salle operatore" për Spitalit Korçë.

- Në lidhje me kontratën e furnizimit nr. 1569/1 prot., datë 02.10.2018 midis operatorëve ekonomik "B. A." përfaqësuar nga z. A. K. dhe "M." SHPK përfaqësuar nga z. S. L. me Spitalit Rajonal Korçë përfaqësuar nga titullari z. A. K. në zbatim të procedurës së prokurimit nr. REF-Nr 376 datë 08.05.2018 zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë për "Furnizim vendosje të pajisjeve mjeksore dhe hotelerie për godinën e maternitetit të Spitalit Korçë dhe kirurgjinë e re dhe patologjinë e Spitalit Sarandë" nga verifikimi i zbatimit të kontratës u konstatua se: Kontrata midis palëve nr. 1569/1 e lidhur më 02.10.2018 me vlerë 14,259,600 lekë pa TVSH ose 17,111,520 lekë me TVSH, është nënshkruar me një afat realizimi kontrate prej 45 ditësh duke filluar nga data e nënshkrimit dhe afat përfundimi 16.11.2018.

Më 13.11.2018 me shkresën Pranuar në protokollin e SRK me nr. 1770 prot., datë 14.11.2018 operatori ekonomik "M." paraqet kërkesën për shtyerje afati kontrate me 14-21 ditë përtej afatit të iniciuar në procedure e prokurimit nga Ministria e Shëndetësisë.

Operatori ekonomik "M." SHPK dhe "B. A." e paraqesin këtë kërkesë me arsyet e mëposhtme:

-Një pjesë e pajisjeve (rreth 20% e zërave të kontratës) kanë origjinë Republikën Popullore të Kinës. Në këtë vend prodhues gjatë datave 1-7 Tetor ka qene periudhë pushimi kombëtar dhe për këtë arsye është shtyrë prodhimi dhe dorëzimi i pajisjeve të porositura.

-Një pjesë e rëndësishme e zërave të kontratës janë pajisje mjeksore të prodhuara në vende jo Evrop (SH B A, Kinë) me distancë ndërkontinentale Rrjedhimisht, organizimi i transportit nga këto vende ka rezultuar problematik jo vetëm për distancën e konsiderueshme, por edhe për vete vëllimin, dimensionet dhe llojin e mallit. Në veçanti prania e baterive me Litium i kategorizon disa nga pajisjet me rrezik për transport transporte të kombinuara tokësore ajror standard dhe për këtë arsye jemi detyruar të organizojme trasporte të kombinuara tokësore, detare dhe ajrore speciale duke u penalizuar në terma kohore.

-Periudha e 3-mujorit të fundit të vitit është tepër e ngarkuar me porosi tek firmat prodhuese, Rrjedhimisht, në fazën e prodhimit krijohen lista pritjeje të porosive të cilat zgjasin deri në 50 ditë. Kjo problematike është bërë me probabile për vete numrin e madh të firmave prodhuese të kontratës.

-Në kontrate përfshihen pajisje mjeksore për të Cilat nevojiten instalime mekanike dhe elektrike



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

madhore. Realizimi i instalimeve në kohët e përcaktuara në kontratë kërkon koordinim midis punimeve ndërtimore dhe punimeve të lidhura me instalimin e pajisjeve mjekësore, gjë e cila shkakton vonesa të caktuara.

...Për rrjedhojë kërkojmë që afati përfundimtarë për realizimin e kontratës në fjalë të shtuhet me të paktën 14-21 ditë...

-Nisur nga sa më sipër titullari i institucionit z. A. K. ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1799 prot., datë 22.11.2018 ku shprehet: *Drejtoria e Shërbimit Spitalorë Korçë, në konsultë edhe me specialistët përkatës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirqënies Sociale, merr parasysh kërkesën tuaj për shkaqet e referuara të vonesës në realizimin e kontratës së furnizimit të pajisjeve për Maternitetin e ri. Si dhe afati maksimal do të jetë 03.12.2018.*

Në reference të sa më sipër titullari i institucionit si dhe operatori ekonomik kanë nëshkruar amendimin e kontratës me nr. 1805 prot., datë 23.11.2018, me një afat kohorë zbatimit deri më 03.12.2018.

Për sa i përket pretendimit që më 1-7 tetor janë festa kombëtare në Kinë, ky pretendim qëndron por njoftimi i fituesit në sistmine elektronik sipas shkresës 3052/48 prot., të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është hedhur më 24.09.2018 pa nga ana e operatorit ekonomik fitues ka patur 6 ditë kohë për të bërë porosinë në kompanitë Kineze që fillojnë pushimet më 01.10.2018 me gjithëse në këto kompani operatorët fitues kanë produkte të cilat nuk është e nevojshme për porosi të veçantë për prodhimin e tyre por thjesht kryerja e porosisë së blerjes.

Për sa i përket pretendimeve të tjera ato nuk qëndrojnë pasi nisur nga fakti që njoftimi i fituesit është bërë më 24.09.2018 ndërsa lidhja dhe fillimi i afatit të kontratës më 02.10.2018 praktikisht këto operatorë kanë patur në dispozicion edhe 8 ditë të tjera bashke me 45 ditët e kontratës plot 53 ditë për bërjen e porosive në kompanitë prodhuese dhe furnizimin e tyre në SRK.

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës u konstatua se furnizimet për pjesë më të madhe të mallrave e paisjeve biomjeksore janë furnizuar sipas datave të më poshtme:

-Urdhër shpenzimi nr. 575 datë 14.12.2018 me vlerë 7,497,240 lekë.

Fatura nr. 12146 datë 05.11.2018 me vlerë 5,840,600 pa tvsh ose 7,008,720 Lekë me Tvsh.

Urdher shpenzim	Fatura	Paisja	Origjina	Vlera
575 dt. 14.12.2018	12146dt. 05.11.2018	Karrel Instrumentash	Itali	92,100
		Makinë Anestezie (set)	SHBA/Kinë	5,300,000
		Modul Sedatimi	SHBA/Kinë	375,000
		Tavolinë Mayo	Itali/Turqi	73,500
Total				5,840,600 pa TVSH

-Fatura nr. 12189 datë 03.12.2018 me vlerë 407,100 pa TVSH ose 488,520 Lekë me TVSH për pajisjen Llambë baktericide me origjinë Itali, furnizuar me 17 ditë vonesë nga kontrata bazë nisur dhe nga fakti se në faturën nr. 12146 të datës 05.11.2018 kemi produkte të furnizuara nga Kina që do të thotë se arsyet e përmendura më lartë për shtesë afati në kontratë nuk qëndrojnë aq më tepër që kjo aparaturë është me origjinë Italiane arsye e vonesës së saj nuk justifikohet.

Nga furnizimi me vonesë në mosrespektim të kontratës nr. 1569/1 datë 02.10.2018 neni 2 i saj, Afati i lëvrimit ku nëpikën 2.4 citohet: *Nëse furnizuesi vonon lëvrimin e mallit në depon e blerësit, përtej afateve kohore të përcaktuara në kontratë, do ti paguaj blerësit penalitet prej 4/1000 të vlerës së mallit të pa lëvruar për çdo ditë vonesë, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.* Nga llogaritja e ditë vonesave për furnizimi nga operatori ekonomik atij i lind detyrimi ndaj SRK në vlerën $3,564,900(25\% \text{ i kontratës}) \times 4/1000 \times 17 \text{ ditë vonesë} = 242,413 \text{ lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik, dhe duhet pagaur nga operatori ekonomik "M."}$



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Për sa i përket produkteve të furnizuara në faturë nr. 332 datë 15.11.2018 për zërin 27 të kontratës **Paisje foto terapie** sasi 2 copë me vlerë 570,000 lekë u konstatua se në katalogun e ofruar nga kjo kompani për kualifikim ofrohet një pajisje foto terapie e kompanisë “G. H.” së bashku me të dhënat teknike në katalog. Në specifikimet teknike të kontratës dhe DST për këtë pajisje cilësohet se ... *konsum i ulët energjie...* në katalogun e ofruar nga operatori fitues kjo pajisje shfaqet me një konsum energjie prej 20W dhe po në këtë katalog cilësohet se është paisja që konsumon më pak energji elektrike se 80% e paisjeve të tjera të ngjashme dhe kjo mëse e vërtet pas paisja e furnizuar është me një konsum energjie 50w ose 2.5 herë më të lartë, gjithashtu intervali i fuqisë duhet të jetë ndërmjet 25/45µw/cm²/nm element që në katalogun në web page nuk e gjejmë fare, nisur dhe nga fakti se ky operator futet në procedurë për të ofruar këtë pajisje sic edhe tregohet në katalog ose të ngjashme me të njëjtat karakteristika jo me karakteristika të ndryshme, për rrjedhojë furnizimi me këtë paisje ndryshe nga katalogu dhe të dhënat teknike të ofruara si dhe pranimi nga SRK **përbën dëm ekonomik në vlerën 570,000 lekë deri në momentin e zëvendësimit.**

-Në përgjigje të observacion nr. 1141 prot., datë 05.07.2019 ju bëjmë me dije se nuk merret në konsideratë:

Së pari grupi i auditimit ka analizuar kërkesën e operatorit ekonomik dhe në atë kërkesë nuk cilësohen asnjëherë këto pretendime që ju shfani në observacion; ...Kordinimi i punës ndërtimore me punimet e instalimit të pajisjeve mjeksore.

*Së dytë: vërtet DST e parashikon këtë zgjatje afati por nëse e lexojmë të dyja palët njësoj: Ak mund të pranojë zgjatje afati edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik... **Këtu kemi vetëm interesin privat.***

Së treti: produkti në fjalë i furnizuar me vonesë është me origjinë Italiane, si rrjedhojë nuk justifikohet në asnjë rast vonesa dhe pretendimet e Juaja.

Së katërti: Nga DST kërkohet që Paisja Fototerapie të ketë konsum të ulët energjie; Ku ju ofrohen dy opsione është e drejtë e autoritetit kontraktorë të refuzojë një product nëse produkti tjetër o ofruar (Varjanti tjetër) është më i mirë; por nga ana juaj nuk është bërë kjo pjesë por keni pranuar çdo product që këto Operatorë kanë sjellë kjo e provuar dhe nëkontratën e LOTIT 1.

-Sa më sipër observacioni nuk merret në konsiderat, përse i takon njoftimit të fituesit observacioni pranohet.

3. Zbatimi i kontratës së furnizimit me mallara: Loti 3 “Furnizim vendosje pajisje biomjeksore dhe pediatrike” për Spitalit Korçë.

Në lidhje me kontratën e furnizimit nr. 1570/1 prot., datë 02.10.2018 midis operatorëve ekonomik “B. A.” përfaqësuar nga z. A. K. dhe “M.” SHPK përfaqësuar nga z. S. L. me Spitalit Rajonal Korçë përfaqësuar nga titullari z. A. K. në zbatim të procedurës së prokurimit nr. REF-Nr 376 datë 08.05.2018 zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë për furnizim vendosje të pajisjeve mjeksore dhe hotelerie për godinën e maternitetit të Spitalit Korçë dhe kirurgjinë e re dhe patologjinë e Spitalit Sarandë” nga verifikimi i zbatimit të kontratës u konstatua se: Kontrata midis palëve nr. 1570/1 e lidhur më 02.10.2018 me vlerë 25,087,510 lekë pa TVSH ose 30,105,012 lekë me TVSH, është nënshkruar me një afat realizimi kontrate prej 45 ditësh duke filluar nga data e nënshkrimit dhe afat përfundimi 16.11.2018.

Më 13.11.2018 me shkresën Pranuar në protokollin e SRK me nr. 1770/1 prot., datë 14.11.2018 operatori ekonomik “B.” paraqet kërkesën për shtyerje afati kontrate me 10-14 ditë përtej afatit të iniciuar në procedure e prokurimit nga Ministria e Shëndetësisë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Operatori ekonomik "B. A." dhe "M." SHPK e paraqet këtë kërkesë me arsyet e mëposhtme:

-Një pjesë e pajisjeve mjekësore të përfshira në kontratë kanë nevojë për instalime mekanike dhe elektrike madhore. Përfundimi i instalimeve në kohët përcaktuara në kontratë ka nevojë për koordinim kohor midis punimeve ndërtimore dhe punimeve të lidhura me instalimin e pajisjeve mjekësore, gjë e cila shpesh nuk është e mundur pa kosto kohore.

- Një pjesë e pajisjeve (rreth 30% e zërave të kontratës) kanë origjinë Republikën Popullore të Kinës. Në këtë vend prodhues gjatë datave 1-7 Tetor ka qene ditë pushimi kombëtare dhe për këtë arsye është shtyrë prodhimi dhe dorëzimi i pajisjeve të porositura me rreth 10 ditë pune.

-Më shumë se 50% e zërave të kontratës janë pajisje mjekësore të prodhuara në Evropiane (SH B A, Zelande e Re, Kinë, Indi) ende jo me distancë ndërkontinentale. Rrjedhimisht transportit nga këto vende ka rezultuar problematik jo vetëm për distancën e organizimi konsiderueshme por edhe për dimensionet dhe llojin e mallit.

-Periudha e 3-mujorit të fundit të vitit është tepër e ngarkuar me porosi tek firmat prodhuese të cilat funksionojnë kapacitet të plotë në këtë periudhë për të kompensuar periudhën e pushimeve të fundvitit Rrjedhimisht, ne fazen e prodhimit krijohen lista pritje te porosive të cilat zgjasin minimalisht 45-60 ditë.

-Nisur nga sa më sipër titullari i institucionit z. A. K. ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1800 prot., datë 22.11.2018 ku shprehet: *Drejtoria e Shërbimit Spitalorë Korçë, në konsultë edhe me specialistët përkatës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirqënies Sociale, merr parasysh kërkesën tuaj për shkaqet e referuara të vonës në realizimin e kontratës së furnizimit të pajisjeve për Maternitetin e ri. Si dhe afati maksimal do të jetë 03.12.2018.*

Ndryshe nga kërkesa e operatorëve ekonomik me 10-14 ditë afat titullari i institucionit i miraton një shtesë afati në kontratë me 18, pra edhe 4 ditë më tepër nga kërkesa e operatorëve ekonomik , duke përkrahur nevojat e operatorëve e jo të institucionit.

Në reference të sa më sipër titullari i institucionit si dhe operatori ekonomik kanë nëshkruar amendimin e kontratës me nr. 1804 prot., datë 23.11.2018 me një afat kohorë zbatimit deri më 03.12.2018.

Për sa i përket pretendimit që më 1-7 tetor janë festa kombëtare në Kinë, ky pretendim qëndron por njoftimi i fituesit në sistmine elektronik sipas shkresës 3052/50 prot., të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është hedhur më 24.09.2018 pa nga ana e operatorit ekonomik fitues ka patur 6 ditë kohë për të bërë porosinë në kompanitë Kineze që fillojnë pushimet më 01.10.2018 me gjithëse në këto kompani operatorët fitues kanë produkte të cilat nuk është e nevojshme për porosi të veçantë për prodhimin e tyre por thjesht kryerja e prorisë së blerjes.

Për sa i përket pretendimeve të tjera ato nuk qëndrojnë pasi nisur nga fakti që njoftimi i fituesit është bërë më 24.09.2018 ndërsa lidhja dhe fillimi i afatit të kontratës më 02.10.2018 praktikisht këto operatorë kanë patur në dispozicion edhe 8 ditë të tjera bashke me 45 ditët e kontratës plot 53 ditë për bërjen e porosive në kompanitë prodhuese dhe furnizimin e tyre në SRK.

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës u konstatua se furnizmet për pjesë më të madhe të mallrave e pajisjeve biomjeksore janë furnizuar sipas datave të më poshtme:

-Urdhër shpenzimi nr. 576 datë 14.12.2018 me vlerë 13,406,952 lekë.

Fatura nr. B-61 datë 05.11.2018 me vlerë 2,110,960 pa TVSH ose 2,533,152 Lekë me TVSH.

Urdher shpenzim	Fatura	Paisja	Origjina	Vlera
576 dt. 14.12.2018	B-61 dt. 05.11.2018	Aparat Kolposkopie	Kinë	624,000
		Peshore dixhitale bebe	Itali	140,400
		Kardiototografi	Gjermani	630,000
		FRH Per rrahje zemre	UK	243,000
		Ambu për neonatal	Itali	39,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

		Laringoskop adult	Turqi	34,360
		Laringoskop Pediatrik	Turqi	34,200
		Pompë Infuzioni	Poloni	366,000
Total				2,110,960 pa TVSH

Fatura nr. 332 datë 15.11.2018 me vlerë 6,149,300 pa tvsh ose 7,379,160 Lekë me Tvsh.

Urdher shpenzim	fatura	Paisja	Origjina	vlera
576 dt. 14.12.2018	332 dt. 15.11.2018	Aspirator për neonatal	Itali	93,600
		Puls Oksimetër për Fëmij	Kinë	156,000
		Puls Oksimetër për adult	Kinë	156,000
		Pajisje fototerapie	Ger, Tur, USA, Indi	570,000
		Ventilator Pacienti	Kinë, zeland e re	5,130,000
		Nebulizator	Itali	43,700
Total				6,149,300 pa TVSH

Fatura nr. 0886 datë 14.11.2018 me vlerë 1,726,000 pa tvsh ose 2,071,200 Lekë me Tvsh.

Urdher shpenzim	fatura	Paisja	Origjina	vlera
576 dt. 14.12.2018	0886 dt. 14.11.2018	Panel reanimacioni adult	Greqi	228,000
		Panel për reanimacion neonat	Greqi	228,000
		Sistem mjeksorë me krahë	Greqi	1,090,000
		Sistem Mjeksorë mural	Greqi	180,000
Total				1,726,000 pa TVSH

-Fatura nr. 76 datë 22.11.2018 me vlerë 585,000 pa tvsh ose 702,000 Lekë me Tvsh, për pajisjen Aparaturë CPA për neonat me lagështues me origjinë Gjermani+Zeland e Re, furnizuar me 6 ditë vonesë nga kontrata bazë nisur dhe nga fakti se në faturën nr. B-61 të datës 05.11.2018 dhe faturës nr. 332 datë 15.11.2018 kemi produkte të furnizuara nga Kina që do të thotë se arsyet e përmendura më lartë për shtesë afati në kontratë nuk qëndrojnë aq më tepër që kjo aparaturë është me origjinë Gjermane + Zeland e Re dhe importi vjen nga Gjermani arsye e vonesës së saj nuk justifikohet. Nga furnizimi me vonesë në mosrespektim të kontratës nr. 1570/1 datë 02.10.2018 neni 2 i saj, Afati i lëvrimit ku në pikën 2.4 citohet: *Nëse furnizuesi vonon lëvrimin e mallit në depon e blerësit , përtej afateve kohore të përcaktuara në kontratë, do ti paguaj blerësit penaltitet prej 4/1000 të vlerës së mallit të pa lëvruar për çdo ditë vonesë, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.* Nga llogaritja e ditë vonesave për furnizimi nga operatori ekonomik atij i lind detyrimi ndaj SRK në vlerën $6,271,877(25\% \text{ i kontratës}) \times 4/1000 \times 6 \text{ ditë vonesë} = 150,525 \text{ lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik, dhe duhet pagaur nga operatori ekonomik "B."}$

-Fatura nr. B-63 datë 26.11.2018 me vlerë 601,200 pa tvsh ose 721,440 Lekë me TVSH, për pajisjen Shiringë elektrike me origjinë Kinë, furnizuar me 10 ditë vonesë nga kontrata bazë nisur dhe nga fakti se në faturën nr. B-61 të datës 05.11.2018 dhe faturës nr. 332 datë 15.11.2018 kemi produkte të furnizuara nga Kina që do të thotë se arsyet e përmendura më lartë për shtesë afati në kontratë nuk qëndrojnë aq më tepër që kjo nuk është një aparaturë që kërkon prosi të veçantë për prodhim por është lehtësisht e furnizueshme për kompanitë prodhuese arsye e vonesës së saj nuk justifikohet.

Nga furnizimi me vonesë në mosrespektim të kontratës nr. 1570/1 datë 02.10.2018 neni 2 i saj, Afati i lëvrimit ku në pikën 2.4 citohet: *Nëse furnizuesi vonon lëvrimin e mallit në depon e blerësit , përtej afateve kohore të përcaktuara në kontratë, do ti paguaj blerësit penaltitet prej 4/1000 të vlerës së mallit të pa lëvruar për çdo ditë vonesë, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

vlerës së kontratës. Nga llogaritja e ditë vonesave për furnizimi nga operatori ekonomik atij i lind detyrimi ndaj SRK në vlerën 6,271,877 (25% i kontratës) x 4/1000 x 10 ditë vonesë = **250,875 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik, dhe duhet pagaur nga operatori ekonomik “B.”**

-Fatura nr. 12147 datë 30.11.2018 me vlerë 10,693,600 pa TVSH ose 12,832,320 Lekë me TVSH, për produktet Sistem Histeroskopie me origjinë Gjermani me vlerë 3,160,000 lekë, dhe Inkubator për neonat me servo kontroll me origjin Gjermane me vlerë 796,000 lekë furnizuar me 14 ditë vonesë nga kontrata bazë nisur dhe nga fakti se në faturën nr. B-61të datës 05.11.2018 dhe faturës nr. 332 datë 15.11.2018 kemi produkte të furnizuara nga Kina që do të thotë se arsyet e përmendura më lartë për shtesë afati në kontratë nuk qëndrojnë aq më tepër që kjo është me origjine Gjermane e për rrjedhojë arsye e vonesës së saj nuk justifikohet.

Nga furnizimi me vonesë në mosrespektim të kontratës nr. 1570/1 datë 02.10.2018 neni 2 i saj, Afati i lëvrimit ku në pikën 2.4 citohet: *Nëse furnizuesi vonon lëvrimin e mallit në depon e blerësit, përtej afateve kohore të përcaktuara në kontratë, do ti paguaj blerësit penalitet prej 4/1000 të vlerës së mallit të pa lëvruar për çdo ditë vonesë, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.* Nga llogaritja e ditë vonesave për furnizimi nga operatori ekonomik atij i lind detyrimi ndaj SRK në vlerën 6,271,877 (25% i kontratës) x 4/1000 x 14 ditë vonesë = **351,225 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik, dhe duhet pagaur nga operatori ekonomik “M.”**

-Në përgjigje të observacion nr. 1141 prot., datë 05.07.2019 ju bëjmë me dije se nuk merret në konsideratë:

Së pari grupi i auditimit ka analizuar kërkesën e operatorit ekonomik dhe në atë kërkesë nuk cilësohen asnjëherë këto pretendime që ju shfani në observacion; ...Kordinimi i punës ndërtimore me punimet e instalimit të pajisjeve mjeksore.

*Së dytë: vërtet DST e parashikon këtë zgjatje afati por nëse e lexojmë të dyja palët njësoj: Ak mund të pranojë zgjatje afati edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik...**Këtu kemi vetëm interesin privat.***

Së treti: Zgjatja e afatit të furnizimit cënon kushtet e kontratës dhe operatorëve të tjerë pjesmarrës dhe jo pjesmarrës, pasi shumë kush mund të mos jetë future në procedurë vetëm nga afati I zbatimit. Mbi të gjitha ku disa nga produktet janë furnizuar dhe të tjerë jo, me pot ë njëjtin vend orgjine kjo është element mëse bindës për mos justifikimin e vonesës.

Sa më sipër observacioni nuk merret në konsiderat, përsa i takon njoftimit të fituesit observacioni pranohet.

4. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Riparim, mirmbajtje të automjeteve për nevojat spitalore, të spitalit Korçë”.

Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

Dokumentacioni në faqen elektronike të APP- **REF-533-03-27-2017**

-Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Riparim, mirmbajtje të automjeteve për nevojat spitalore, të spitalit Korçë”, për vitin 2017 me të dhënat si më poshtë, rezultoi se:

Të dhëna për tenderin	Njësia e Prokurimi	Kom. i Vler. të Ofertave
a	b	c
-Urdhër Prokurimi nr. 58 prot., dt 27.03.2017.	Emër Mbiemër	Emër Mbiemër
-Fondi limit pa TVSH 2,185,170 lekë	B. H.	A. L. Kryetar
-Fondi limit me TVSH 2,622,204 lekë	Gj. G.	A. D. Anëtare
	E. R.	E. M. Anëtare



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

-Proc. e Prok. (Kërkesë për propozim) -Data e zhvillimit të tenderit 07.04.2017, ora 12.00 Subjekti fitues "S. .i" -Data e lidhjes së kontratës 25.04.2017 -Vlera e kontrat.pa tvsh 2,054,600 lekë -Vlera e kontrat.me tvsh 2,465,520 lekë -Diferenca nga fondi limit 130,570 lekë, 6 %.	Urdhri nr. 533 prot., datë 27.03.2017	Urdhri nr. 534prot., datë 27.03.2017
---	--	---

Me shkresën nr. 457 datë 09.03.2017 të titullarit të autoritetit kontraktorë znj. E. B. është ngritur grupi i punës për përcaktimin e fondit limit që do të prokurohet për mirmbajtjen e automjeteve të spitalit Korçë, për vitin 2017 me përbërje: z. E. R., znj. K. B. dhe znj. M. L.

Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit ka hartuar procesverbalin për përcaktimin e fondit limit me vlerë 2,185,170 lekë pa TVSH ose 2,622,204 lekë me TVSH referuar ofertave të marra nga operatorë "A. Z.", "B." SH.A. dhe "K." SH.A.

Me urdhërin e prokurimit nr. 58, datë 27.03.2017, nga titullari i AK-së është urdhëruar të kryhet prokurimi me vlerën 2,185,170 lekë pa TVSH, për procedurën e prokurimit me objekt "Riparim, mirmbajtje të automjeteve për nevojat spitalore, të spitalit Korçë", me burim financimi FSDKSH, është përcaktuar se lloji i procedurës të jetë "Kërkesë për propozim, dhe ngarkohen për zbatimin e urdhërit Njësia e prokurimit e përbërë prej z. B. H., z. Gj. G. dhe z. E. R.

Nga kjo procedurë prokurimi rezulton se titullari i AK-së, nuk ka kërkesë nga sektori përkatës për fillimin e saj, nuk ka argumentuar arësyen e nevojës për kryerjen e prokurimit, nuk ka argumentuar zgjedhjen e llojit të procedurës, pra nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për këtë dosje, si dhe nga inventari i saj, nuk rezulton të ketë asnjë dokument për nisjen e saj, çka tregon se kjo procedurë ka nisur me urdhërin e prokurimit të hartuar nga ish-drejtori i SRK, duke mos argumentuar lindjen e nevojës për prokurim (kërkesa nga sektori përkatës), në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, kreu II, neni 12.

Veprimi i cili ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK-së, z. E. B.

-Me shkresën nr. 534 prot., datë 27.03.2017 titullari i autoritetit kontraktorë ka ngritur komisjoni e vlerësimit të ofertave të përbërë nga z. A. L. Kryetar, znj. A. D. dhe znj. E. M. Anëtare.

-Më datë 27.03.2017 në të njëjtën datë që janë krijuar NJP mban procesverbalin për hartimin e specifikimeve teknike të kësaj procedure.

Preventivi i punimeve për shërbimet e automjeteve është hartuar nga z. E. R. me detyrë përgjegjësi i sektorit teknik.

Referuar sistemit të APP-së rezulton se u është dërguar ftesë të paktën 5 operatorëve si më poshtë:

1. "G. M." me nipt K83927001K dhe objekt: Servis makinash dhe montim dhe servis impiantesh gazi.
2. "P." me nipt K33920024I me objekt "Kryerja e punimeve bujqesore, riparim makinerish bujqesore, blerje-shitje, import-eksport, tregetim te makinerive, paisjeve dhe pjeseve te nderrimit" me status Shoqeri ne Likuidim e Siper.
3. "S. P." me nipt K33925036K me obeitk: "Shitje shumice e pakice pjesë këbimi për automjete dhe servis makinash, Montim impiante gazi.
4. "E. B." me nipt K33825023W dhe objekt: Tregti me pakice pjese kembimi automjetesh.
5. "P. N." për të cilin nuk rezulton asnjë e dhënë në regjistrin e QKB-së.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

6. "Z." me nipt K41416009T i cili rezulton me status në faqen zyrtare të QKB, për tu paraqitur për përditësimin e të dhënave.

Nga sa më sipër rezulton se NJP u ka dërguar ftesë për pjesëmarrje operatorëve të cilët nuk kanë në fushën e veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, ose operatorë që janë në proces likuidimi, çka tregon se nuk janë njoftuar të paktën 5 operatorë për pjesëmarrje, pra nga AK nuk argumentohet dhe dokumentohet përzgjedhja e këtyre operatorëve të cilëve u është dërguar ftesa, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, kreu IV, neni 39.

Me datë 07.04.2017, është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave nga ku rezultoi se ka marrë pjesë 3 operator dhe konkretisht subjektet:

- "K." SH.A, me ofertë 2,035,900 lekë
- "S. P." SHPK, me ofertë 2,054,600 lekë
- "B.M." person fizik, me ofertë 1,794,900 lekë

Më datë 12.05.2015 është mbajtur procesverbali i klasifikimit përfundimtar për përcaktimin e OE fitues "S. P." SHPK, me ofertë 2,054,600 lekë i cili plotëson kërkesat e AK-së, ndërsa dy operatorët e tjerë nuk kualifikohen pasi nuk disponojnë pikë servisi në pronësi apo qera pranë qytetit të Korçës.

Më datë 20.04.2017 është hartuar raporti përmbledhës nga KVO, si dhe nënshkruar nga njësia e prokurimit i cili nuk është miratuar nga titullari i AK-së, në të cilin është shpallur fitues OE "S. P." SHPK, me ofertë 2,054,600 lekë pa TVSH.

Me shkresën datë 20.04.2017, është plotësuar Formulari i njoftimit të fituesit, i cili është dërguar për botim në faqen e APP-së nga titullari i AK.

-Me nr. 669, datë 25.04.2017, është hartuar dhe lidhur kontrata e shërbimit midis titullarit të SRK znj. E. B. dhe përfaqësuesit të OE fitues "S. P.", me vlerë 2,054,600 lekë pa TVSH, me datë fillimi 25.04.2017 dhe afat deri në 31.12.2017.

-Formulari i sigurimit të ofertës është paguar në shoqërinë "A.", me nr. 46455133, me datë 24.04.2017, në shumën prej 246,552 lekë.

Në lidhje me zbatimin e Kontratës.

Spitali rajonal Korçë disponon 12 autoambulanca nga të cilat 2 nuk janë në gjëndje punë, 1 në gjëndje jo të mirë pasi është e vitit 1993 dhe 9 në gjëndje pune.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës për mirmabjete e mjeteve u konstatua se: Nga titullari i institucionit nuk është ngritur komision për zbatimin dhe mbikqyrjen e kontratës në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi ish titullarin e AK-së, znj. E. B.

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit për shërbimet e kryera si dhe i zërave të punime për të cilat çdo automjet është paraqitur në servis mesatarisht çdo 4 muaj rezultoi se disa zëra punimesh janë përsëritur dhe dubluar për një kohë shumë të shkurtër për të cilat nuk justifikohet shpenzimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Ndërkohë që pjesët e ndërruara nuk janë bërë në asnjë rast hyrje në magazinën rikupero. Më poshtë jepen të dhënat sipas shpenzimeve të kryera, për disa pjesët të cilat nuk justifikohet shpenzimi pasi janë të dubluara në urdhër shërbime të mëparshme për të njëjtin mjet.

Urdher shpenzimi			Automjeti tip	Targa	Pjeset e pa ndërruara ose dubluara me riparimin e mëparshme	Vlera me tvsh
Nr	Date	Vlera				
236	16.05.2017	584,040	Benz Mercedes	KO 5493B	Gomina Stabilizatori II (riparuar më 3.2.2017 fat.509)	2400
			Benz Mercedes	KO 4281B	Gomina Stabilizatori II (riparuar më 3.2.2017 fat.509)	2400
			Toyota	KO8018A	Ferrotë para(riparuar më 27.1.2017 fat.495)	4200
					Ferrotë mbrapa(riparuar më 27.1.2017 fat.495)	6600
			Total			15,600
286	15.06.2017	294,360	Benz Mercedes	KO 4281B	Ferrotë para(riparuar më 31.1.2017 fat.501)	4200
			volkswagen	AA512AR	Ferrotë para(riparuar më 27.1.2017 fat.494)	4800
					Ferrotë mbrapa(riparuar më 27.1.2017 fat.494)	4800
			volkswagen	AA528AR	Ferrotë mbrapa(riparuar më 27.1.2017 fat.494)	4800
			Total			18,600
338	20.07.2017	473,040	Benz Mercedes	KO 4281B	Kokë muzo(riparuar më 09.5.2017 fat.628)	3600
					Kokë zbare(riparuar më 09.5.2017 fat.628)	6000
					Pasqyra freni para (riparuar më 31.1.2017 fat.501)	4800
			Fiat Dukat	KO 6789A	Ferrotë para(riparuar më 27.1.2017 fat.494)	3600
					Ferrotë mbrapa(riparuar më 27.1.2017 fat.494)	3600
			Benz Mercedes	KO 5493B	Trasmision (riparuar më 03.2.2017 fat.509)	42000
			Mitsubishi	KO6787A	Ferrotë para(riparuar më 10.5.2017 fat.632)	3600
					Kokë muzo(riparuar më 10.5.2017 fat.632)	8400
			Total			75,600
404	06.09.2017	218,160	Benz Mercedes	KO 4281B	Heqje Vendorsje kande(nderuar me 03.07.2017 fat. 670)	4800
			Total			4800
442	12.10.2017	294,000	volkswagen	AA512AR	Set rrip faze(riparuar më 07.8.2017 fat.704)	18,000
			Benz Mercedes	KO 4282B	Amortizator para(riparuar më 03.6.2017 fat.652)	24,000
					Set freksioni(riparuar më 28.4.2017 fat.615)	42,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

			Toyota	KO8018A	Amortizator mbrapa (riparuar më 10.5.17 fat 631)	19,200
	Total					103,200
519	05.12.2017	303,600	Mitsubishi	KO6787A	Gomina Balestre (riparuar më 05.7.2017 fat.674)	7200
			volkswagen	AA512AR	Kushinet rripi (riparuar më 07.8.2017 fat.704 set faze)	3600
					Ferota para(riparuar më 03.6.2017 fat.651)	4800
					Ferota mbrapa(riparuar më 03.6.2017 fat.651)	4800
			Benz Mercedes	KO 5493B	Ferota para(riparuar më 11.5.2017 fat.633)	4200
					Ferota mbrapa(riparuar më 11.5.2017 fat.633)	3600
					Kryq trasmissioni (riparuar më 04.7.2017 fat.673)	3600
					Balestra (makina është me amortizator ndërruar me faturën 633 dt. 11.5.2017	19,200
	Total					51,000
589	21.12.2017	298,320	Volksawagen	AA528AR	Rrip dinamo (riparuar më 05.6.2017 fat.654)	2400
			Toyota	KO8018A	Kryq trasmissioni (riparuar më 07.8.17 fat 706)	8,400
			Mitsubishi	KO6787A	Feroda para (riparuar më 06.11.2017 fat.812)	3600
			Benz Mercedes	KO 4282B	Feroda freni prapa(riparuar më 02.10.2017 fat.767)	3,600
			Benz Mercedes	KO 4282B	Çelës dritash(riparuar më 28.04.2017 fat.615)	13,200
			Benz Mercedes	KO 5493B	Çelës dritash(riparuar më 04.07.2017 fat.673)	13,200
			Benz Mercedes	KO 5493B	Fije freni dore(riparuar më 06.11.2017 fat.809)	9,600
			Benz Mercedes	KO 5493B	Denfer(riparuar më 06.11.2017 fat.809)	12,240
	Total					66,240
	Viti 2017					335,040

Referuar tabelës mësipër vlera për pjesët të cilat shpenzimet janë dubluar në shumën 335,040 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Nga auditimi i kontratës me objekt: “Shtesë kontrate për “Riparim, mirmbajtje të automjeteve për nevojat spitalore, të spitalit Korçë””, datë lidhjes së kontratës 22.01.2018 nr. 123 prot., është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

konstatuar se, vlera e kontratës prej **493,104 lekë përbën shpenzime të pa justifikuara**. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i nënshkrimit të njëkontrate shtesë nëmasën 20% tëkontratës fillestare duke mos justifikuar dhe argumentuar arsyen e saj nisur dhe nga fakti mos qënies në kushtet e emergjencës pasi riparimi i mjeteve të SRK është kryer nëmuajt nëtor dhjetor 2017, pra rreth 1 muaj përpara lidhjes së kësaj kontrate shtesë, Ak nuk ka respektuar nenin Kreun IX neni 76 Kohëzgjatja e kontratës të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

5-Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt ”Riparim, mirmbajtje të automjeteve për nevojat spitalore, të spitalit Korçë”, për vitin 2018 me të dhënat si më poshtë, rezultoi se;

Të dhëna për tenderin	Njësia e Prokurimi	Kom. i Vler. të Ofertave
a	b	c
-Urdhër Prokurimi nr. 407 prot., dt. 30.03.2018. -Fondi limit pa TVSH 2,333,300 lekë (7% me shumë se viti 2017) -Fondi limit me TVSH 2,799,960 lekë -Proc. e Prok. (Kërkesë për propozim) -Data e zhvillimit të tenderit 07.04.2017, ora 12.00 Subjekti fitues “S. P.” -Data e lidhjes së kontratës 02.05.2018 -Vlera e kontrat.pa tvsh 1,969,500 lekë -Vlera e kontrat.me tvsh 2,363,400 lekë -Diferenca nga fondi limit 363,800 lekë, 16 %.	Emër Mbiemër B. H. Gj. G. E. R. Urdhri nr. 407 prot., datë 30.03.2018	Emër Mbiemër A. L. Kryetar A.D. Anëtare E. M. Anëtare Urdhri nr. 408prot., datë 30.03.2018

Me shkresën nr. 19.03.2018 Përgjegjësi i sektorit teknik ka paraqitur kërkesë për mbulimin e nevojave për mirmbajtjen e automjeteve të SRK.

Me shkresën nr. 388, datë 26.03.2018 të titullarit të autoritetit kontraktorë z. A. K. është ngritur grupi i punës për përcaktimin e fondit limit që do të prokurohet për mirmbajtjen e automjeteve të spitalit Korçë, për vitin 2018 me përpërje: z. E. R., znj. Zh. T. dhe znj. L. P.

Grupi i puëns për përllogaritjen e fondit limit ka hartuar procesverbalin për përcaktimin e fondit limit me vlerë 2,333,300 lekë pa TVSH ose 2,799,960 lekë me TVSH referuar ofertave të marra nga operatorë “S. P.”, “B.” SHA dhe “K.” SHA.

Me urdhërin e prokurimit nr. 14, datë 30.03.2018, nga titullari i AK-së z. A. K. është urdhëruar të kryhet prokurimi me vlerën 2,333,300 lekë pa TVSH, për procedurën e prokurimit me objekt “Riparim, mirmbajtje të automjeteve për nevojat spitalore, të spitalit Korçë”, me burim financimi nga buxheti i shtetit, është përcaktuar se lloji i procedurës të jetë “Kërkesë për propozim” marrëveshje kuadër dhe ngarkohen për zbatimin e urdhërit Njësia e prokurimit e përbërë prej z. B. H., z. Gj. G. dhe z. E. R.

-Me shkresën nr. 408 prot., datë 30.03.2018 titullari i autoritetit kontraktorë ka ngritur komisjoni e vlerësimit të ofertave të përbërë nga z. A. L. Kryetar, znj. A. D. dhe znj. E. M. Anëtare.

-Me datë 30.03.2017 në të njëjtën datë që janë krijuar NJP mban procesverbalin për hartimin e specifikimeve teknike të kësaj procedure.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Preventivi i punimeve për shërbimet e automjeteve është hartuar nga Edmond Remçka me detyrë përgjegjësi i sektorit teknik.

Referuar sistemit të APP-së rezulton se u është dërguar ftesë të paktën 5 operatorëve si më poshtë;

1. "K."
2. "G. M."
3. "P."
4. "B. M."
5. "S. P."
6. "P. N."
7. "Z."

Me datë 16.04.2018, është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave nga ku rezultoi se ka marrë pjesë 4 operator dhe konkretisht subjektet:

- "K." SHA, me ofertë 2,085,400 lekë
- "S. P." SHPK, me ofertë 1,969,600 lekë
- "B. M." person fizik., me ofertë 2,015,400 lekë
- "M. Sh." dhe "N. Sh." 2,143,600 lekë

Me datë 12.05.2015 është mbajtur procesverbali i klasifikimit përfundimtar për përcaktimin e OE fitues "S.P." SHPK, me ofertë 1,969,500 lekë me ofertë më të ulët.

Me shkresën nr. 486, datë 26.04.2018, është plotësuar Formulari i njoftimit të fituesit, i cili është dërguar për botim në faqen e APP-së nga titullari i AK.

-Me nr. 506, datë 02.05.2018, është hartuar dhe lidhur kontrata e shërbimit midis titullarit të SRK z. A. K. dhe përfaqësuesit të OE fitues "S.P.", me vlerë 1,969,500 lekë pa TVSH, ose 2,363,400 me TVSH me datë fillimi 02.05.2018 dhe afat deri në 02.05.2019.

-Formulari i sigurimit të ofertës është paguar në shoqërinë "A.", me nr. 46455164, me datë 01.05.2018, në shumën prej 236,340 lekë.

Në lidhje me zbatimin e Kontratës.

Spitali rajonal Korçë disponon 12 autoambulanca nga të cilat 2 nuk janë në gjëndje punë, 1 në gjëndje jo të mirë pasi është e vitit 1993 dhe 9 në gjëndje pune.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës për mirmabjete e mjeteve u konstatua se: Nga titullari i institucionit nuk është ngritur komision për zbatimin dhe mbikqyrjen e kontratës në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77. Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi ish titullarin e AK-së, znj. E. B.

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit për shërbimet e kryera si dhe i zërave të punime për të cilat çdo automjet është paraqitur në servis mesatarisht çdo 4 muaj rezultoi se disa zëra punimesh janë përsëritur dhe dubluar për një kohë shumë të shkurtër për të cilat nuk justifikohet shpenzimi.

Ndërkohë që pjesët e ndërruara nuk janë bërë në asnjë rast hyrje në magazinën rikupero. Më poshtë jepen të dhënat sipas shpenzimeve të kryera, për disa pjesët të cilat nuk justifikohet shpenzimi pasi janë të dubluara në shërbimet të mëparshme për të njëjtin mjet.

Urdher shpenzimi			Automjeti tip	Targa	Pjesët e pa ndërruara ose dubluara me riparimin e mëparshëm	Vlera me TVSH
Nr	Datë	Vlera				



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

247	06.06.2018	509,160	Benz Mercedes	KO 5493B	Pompë nafte (riparuar më 4.7.2017 fat.673)	18,000
					Celës dritash (riparuar më 12.12.2017 fat. 853)	13,200
					Pompë uji (riparuar më 6.11.2017 fat. 809)	21,600
				AA512AR	Ferrota para (riparuar më 04.11.2017 fat.808)	4800
	Total					57,600
409	13.08.2018	417,000	Benz Mercedes	KO 4281B	Pinjon Mototrrino (riparuar më 30.01.2017 fat.841)	4200
	Total					4,200
517	25.10.2018	349,800	Benz Mercedes	KO 4282B	Ferrota Para(riparuar më 05.5.2018 fat.142)	3,600
					Ferrota Prapa(riparuar më 05.5.2018 fat.142)	3,600
			Benz Mercedes	KO 5493B	Pompë nafte (riparuar më 04.7.2017 fat.673)	18,000
	Total					25,200
594	21.12.2018	400,080	Fiat Dukat	KO 6789A	Makina nuk funksionon verifikuar në garzhdin e mjetit.	24,360
	Total					24,360
	Viti 2018					111,360

Referuar tabelës mësipërme vlera për pjesët të cilat shpenzimet janë dubluar në shumën 111,360 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

-Referuar faturës nr. 329, datë 01.08.2018 pjesë të cilat duhet të ishin në magazinën rikupero po të cilat nuk u gjenden është në shumën 226,800 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. **Shuma 226,800 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit deri në dokumentimin e shërbimit, dhe bërjen hyrje në magazinën rikupero.**

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK-së, si dhe personat përgjegjës z. A. M., z. L. H., z. S. Dh. si përdërues të mjetit dhe personat përgjegjës si dhe z. E. R. në cilësinë e përgjegjës i sektorit teknik.

-Në përgjigje të observacionit dërguar me shkresën nr. 1141prot., datë 05.07.2019 nga SRK për aktkostatimin nr.9 ju bëjmë me dije se nuk keni paraqitur prova apo dokumentacion të ri justifikues e për rrjedhojë ky observacion nuk merret në konsiderat.

6. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbim i rojeve private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dhe dy ndërtesa me kamera” zhvilluar në vitin 2017.

2. Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

3. Dokumentacioni në faqen elektronike të APP-REF-65339-01-18-2017

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :

1.Urdhër Prokurimi nr.150 prot., datë 13.02.2017, Titullari i AK. Znj. E. B.	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Me Urdhër nr.150., datë 17.01.2017 Z. B.H.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.151 prot., datë 17.01.2017 Z. A. L. Kryetar
---	--	--



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E Hapur"	Z. Gj. G. Z. E. R.	Znj. A. D. Znj. E. M.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 15,768,893.44 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 15,762,181.12	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 6,712.32 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 13.02.2017 Ora 10.⁰⁰	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 5 O.E. c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK-nuk ka	12. Përgjigje Ankesës - nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP - nuk ka

Referuar dokumentacionit të administruar dhe të vënë në dispozicion nga AK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, konstatohet si më poshtë vijon:

• **Lidhur me përcaktimin e vendrojeve përlllogaritjen dhe miratimin e vlerës së fondit limit:**

-Skema e vendrojeve në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Korçë, për vitin 2017 është formuluar më datë 09.01.2018, nga z. E. R. me detyrë Kryetar i Degës Teknike.

Objektet e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë, që kërkohen të ruhen nga (SH.R.S.F) janë të vendosura në pasqyrën përmbledhëse të objekteve të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë që përfshihen kryesisht godina spitalore, zyra, ambiente shërbimi, lavanteri, magazina, parking, territori brenda murit rrethues, etj, me 6 (gjashtë) vëndroje për 24 (njëzet e katër) orë, me 5 roje për vëndroje me tre turne dhe një vënd-roje me një turn me dy roje dhe dy ndërresa me kamera.

1. Një vëndroje te porta hyrëse e Spitalit, me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje.
2. Një vëndroje te porta dalëse e Spitalit, me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje.
3. Një vëndroje tek Urgjenca e Spitalit, me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje.
4. Një vëndroje tek Pediatria e Spitalit, me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje, që do të mbulojë me shërbim të pandërprerë pas mbylljes së orarit të vizitorëve edhe ambientet e ORL – Okulistikës, magazinat përballë saj, magazinën e oksigjenit dhe shesh parkimet e helikopterit dhe automjeteve para dhe pas godinës së Peditrisë.
5. Një vëndroje në sportelin mbrapa Urgjencës (sheshi i Gështenjës), me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje, që do të mbulojë me shërbim të pandërprerë pas mbylljes së sportelit edhe magazinat dhe kaldajën përballë saj. Godinën e Farmacisë Qëndrore, territorin që përfshin Morgun, garazhet, Senatoriumin, oficinën, lavanderinë, kalajdajën qëndrore dhe shesh parkimet e automjetet tek ish Garderoba.
6. Një vëndroje te Godina e Manternitetit të Spitalit, me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje.
7. Një vëndroje në Poliklika Qëndrore e Spitalit, me shërbim me një turn me dy roje, dhe dy turne me kamera dhe sinjal alarmi.

-Titullari i AK znj. E. B., me nr.90 prot., datë 11.01.2017 ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit

-Grupi i Punës për Përlllogaritjen e Fondit limit: z. Gj. G. Kryetar i Degës së Planifikimit, znj. M. G. specialiste planifikimi e znj. M. L. specialiste planifikimi, ka nënshkruar. Grupi punës, brenda datës 20.01.2017, të shprehet për fondin që do të duhet të planifikohen nga ana e Spitalit Rajonal Korçë, gjatë vitit 2017, për shërbimin e ruajtjes së objekteve.

-Përlllogaritja fondit limit për prokurimim me objekt: "Shërbim i rojeve private të Spitalit Korçë, me 6 vënd-roje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dhe dy ndërtesa me kamera" për vitin 2017.

Nr	Emërtimi	Vlera Lek për një roje/muaj
----	----------	-----------------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

1	Paga minimale	33,000
2	Shtesa për turne II, III, festa zyrtare dhe pushime vjetore	6,370.35
	Shuma I	39,370.35
3	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 16.7% punëdhënësi	6,574.84
4	Shpenzime për veshmbathje	1,199
5	Shpenzime armatimi	154
6	Shpenzime ndërlidhje	100
	Shuma II	8,027.84
	Shuma III = I + II	47,398.19
7	Fitimi 4 %	1,895.92
	Totali pa TVSH (I + II + III)	49,294.11

Përlllogaritja e detajuar e zërave të tabelës është si më poshtë:

a- Paga bazë e vendosur me VKM nr. 581, datë 17.07.2013 është 22,000 lekë.

b- Paga bazë për punonjësit e SHPSF-së referuar Ligjit nr. 75/2014, "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", neni 18 pika g Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me VKM është 33,000 lekë.

c- Shtesat për turne II, III festa zyrtare dhe pushime vjetore paraqiten si më poshtë:

• Punonjësit që punojnë natën, në ditën e pushimit javor e të festave zyrtare, Brenda kohëzgjatjes normale ditore të punës përfiton një shtesë page në masën.

- 20% për çdo orë e shërbimit të kryer nga ora 19⁰⁰-22⁰⁰

- 50% për çdo orë e shërbimit të kryer nga ora 22⁰⁰-06⁰⁰

-25% për punën e kryer në ditët e festave zyrtare dhe të pushtimit javor.

-75 % për çdo orë e shërbimit të kryer natën në ditët e festave zyrtare dhe të pushtimit javor.

- Një muaj ka mesatarisht 30.41 ditë (365 ditë/12muaj).
- Një punonjës me Kod Pune punon 174 orë/pune muaj.
- Mbi këtë bazë një orë pune është **206.89 lekë** (36,000lekë/174 orë).
- Ditë pushimi dhe të djela për këtë vit janë 104 ditë.
- Festat zyrtare për këtë vit janë 13 ditë, nga të cilat katër festa janë ditë të shtuna dhe të diela (01-02 Janar-Festa e Vitit të Ri, 14 Mars- Dita e Verës, 22 Mars-Sulltan Novruz, 16 Prill-Pashka Katolike -Pashka Ortodokse, 1 Maj- Dita e Punëtorëve, 15 Qeshor-Barjam i Madh, 21 Gusht-Kurban Barjam, 19 Tetor-Lumturimi i Nënë Terezës, 28-29 Nëntor- Festa Kombëtare e Çlirimit dhe Pavarësisë, 8 Dhjetor Dita e Rinisë, 25 Dhjetor-Krishtlindja).
- Pushimet vjetore për punonjësit llogariten 28 ditë kalendarike nga të cilat 8 ditë janë të shtuna dhe të diela.
- Ditë pushimi në total llogariten 138 ditë. (105+13 festa zyrtare +20 ditë pushime vjetore)
- Ditë punë vjetore 227 ditë (365-138)
- Numri i punonjësve për një vendpune është 5 referuar shkresës së Ministrisë të Shëndetësisë nr, 625/1, datë 12.02.2010.

Përlllogaritja për shërbimin natën në ditët e pushimit:

• **Ditore**

-Turni i II nga ora 19⁰⁰ - 22.⁰⁰ = 3 orë

-Turni i III nga ora 22⁰⁰ - 06⁰⁰ =8 orë

• **Mujore**

-Turni i II në 30.41 ditë x 3 orë= 91.23 orë

-Turni i III 30.41 ditë x 8 orë = 243.28 orë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

- **Për një punonjës/muaj**
 - Turni i II 91.23 orë : 5 roje = 18,246 orë
 - Turni i III 243.28 orë : 5 roje = 48,656 roje
- **Përlllogaritja e përfitimit për festat zyrtare të shtunave dhe të dielave;**
 - Ditë 115 (105+10) x 8 orë = 920 orë/vit
 - 920 orë/12 muaj = 76.66 orë/muaj
 - 76.66 orë/muaj / 5 roje = 15,33 orë/roje
- **Përlllogaritja për përfitimit në turnet II dhe të II për festat zyrtare**
 - 13 ditë/12 muaj = 1.08 ditë/muaj
 - 1.08 ditë/muaj : 5 roje = 0,216 ditë/roje në muaj
 - Turni i II në 0,216 ditë x 3 orë = 0.648 orë/muaj (nga ora 19⁰⁰ - 22⁰⁰)
 - Turni i III në 0,216 ditë x 8 orë = 1.728 orë/muaj (nga ora 22⁰⁰ - 06⁰⁰)
- **Përlllogaritja në vlerë**

Përlllogaritja për shërbimin natën dhe ditët e pushimit:

- Turni i II 18.246 orë x (227.58-189.65) = 943.68 lekë
- Turni i III në 48,656 orë x (284.47-189.65) = 4,613.56 lekë

• **Përlllogaritja për festat zyrtare, të shtuna dhe të diela.**

- Turni I-rë (25%) 15.33 orë x (237.58 - 189.65) = 726.79 lekë
- Turni i II-të dhe i III-të (75 %) 0,648 orë + 1,728 orë x (331.88 - 189.65) = 337.93 lekë

Totali i përfitimit për festat zyrtare, të shtunat dhe të dielat.

(692.07 + 4,613.56 + 726.79 + 337.93) = 6,370.35 lekë.

• **Shpenzime për veshmbathje**

Kostume (Xhaketa, pantallona, kapelë) 1 palë x 18,000 lekë : 3 vjet: 12 muaj = 500 lekë.
Këmishë 2 copë x 1,200 lekë/vit : 12 muaj = 200 lekë
Këpucë 1 palë x 2,500 lekë/vit : 12 muaj = 208 lekë
Pulover 1 copë x 2,500 lekë/vit : 12 muaj = 208 lekë
Kollare 1 copë x 1,000 lekë/vit : 12 muaj = 83 lekë.

Totali për veshje për 1 roje/muaj = 1,199 Lekë

• **Shpenzime për armatim:**

Tarifë vjetore për amartim 6,000 lekë: 12 muaj = 500 lekë/muaj.
Tarifë vjetore për municion 1,500 lekë : 12 muaj = 125 lekë/muaj
Tarifë vjetore për riparim arme 1,250 lekë : 12 muaj = 104 lekë/muaj
Tarifë vjetore për lejembajteje arme 500 lekë : 12 muaj = 41 lekë/muaj

• **Shuma pa TVSH 770 lekë : 5 roje = 154 lekë/muaj**

-Vlera mujore e përlllogaritur për një roje në muaj është **49,294.11 lekë**

- -Vlera ditore është **1,620.11 lekë**
- -Ditë pune të tenderuara **304 ditë.**
- -Numri total i rojeve që nevojitet për të të përmbushur shërbimin është 32 roje.
- -Vlera monetare pa TVSH që duhet tenderuar është **15,768,893.44 lekë**
- -TVSH 20 % **3,153,778.68 lekë**
- Vlera monetare me TVSH që duhet tenderuar është **18,892,672.12 lekë**

-Përlllogaritja e fondit limit është bërë për periudhën kohore nga data 03.03.2017 deri më datë 31.12.2012, pasi është njohur me skemën e vendrojeve të paraqitur nga Sektori Teknik.

- Përlllogaritja e pagesës dhe numrit të rojeve për vendroje në Poliklika Qëndrore e Spitalit, me shërbim me një turn me dy roje.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Përlllogaritja e numrit të rojeve për vendroje duhej përlllogaritur:

- Për pesë vendroje me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje.

5 vendroje me shërbim 24 orë me tre turne x 4.98 roje/vendroje = **24.90 roje gjithsej për 5 vendroje.**

- Për një vëndroje me një turn me 2 roje te Poliklika Qëndrore e Spitalit (nuk duhet të përfshihen në përlllogaritjen e pagës mujore e shtuna e të diela si dhe turnet e II dhe të II).

Për 2 (dy) rojet që punojë vetëm turni i parë nga e Hëna në të Premten, nuk duhet të marrin orë nate dhe ditë të shtuna e të diela.

Llogaritja e detajuar paraqitet në tabelë.

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje/muaj
1	Shpenzime për page bazë	33,000
2	Shtesë mbi pagë për turnin II	0
3	Shtesë mbi pagë për turnin III	0
4	Shtesa mbi page per festat zyrtare dhe pushimet vjetore	926.65
	SHUMA I	33,926.65
5	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%	5,666.75
6	Shpenzime armatimi	154
	Shpenzime ndërlihdje	100
	SHUMA II	39,846.40
	Fitimi %	1,593.86
		41,493.86

Përlllogaritja e detajuar e zërave të tabelës është si më poshtë:

- **Përlllogaritja e përfitimit për festat zyrtare dhe ditë pushimi;**

(9 Ditë/vit + 20 ditë/vit) x 8 orë/vit = 232 orë/vit x (237.58 lekë/orë - 189.65 lekë/orë) = 11,119.76 lekë/vit ; 12 muaj = **926.65 lekë/muaj (për 9 ditë festat zyrtare dhe 20 ditë pushimet vjetore).**

Në përlllogaritjen e fondit limit paga e rojeve vendroje në Poliklika Qëndrore e Spitalit, me shërbim me një turn me dy roje paga mesatare mujore duhej 41,493.86 lekë dhe jo 49,294.11 lekë. *Pra paga mujore është përlllogaritur 7,800.25 lekë pa tvsh më tepër.*

(7,800.25 lekë/muaj x 10 muaj = **78,002.50 lekë në 10 muaj**); Kujtojë që janë dy roje

61,423.92 lekë x 2 roje = **122,847.84 lekë pa TVSH më tepër është përlllogaritur Fondi Limit më tepër për 2 rojet 8 orarshe.**

- Përlllogaritja e pagesës dhe numrit të rojeve për vendroje në Poliklika Qëndrore e Spitalit, me shërbim 24 orë dhe me një turn për dy roje.

Gjatë vitit kalendarik nga data 03.03.2017 deri më 31.12.2017 (304 ditë).

Ditë pushimi në total llogariten 138 ditë. (104+14 festa zyrtare +20 ditë pushime vjetore)

Ditë punë vjetore 227 ditë (365-138)

Duke konsideruar që dy rojet punojnë edhe në ditët e festave: nga 14 festa zyrtare 4 janë të shtuna e të diela kështu që duhen marrë në konsideratë vetëm 10 ditë festa zyrtare. (kjo duhet parë nëse poliklinika ruhet në ditë festash)

227 ditë pune në vit + 10 ditë festa (pasi 4 festa bien të shtuna e të diela) + 20 ditë leje e zakonshme (pasi 8 ditë nga leja bien të shtuna e të diela) = janë gjithsej 257 ditë pune në vit së bashku me festa dhe lejen e zakonshme.

Këtyre i shtojmë ditët që do të jenë të dubluara, kur roja duhet të jetë i zvendësuar për arsye të lejes apo festave 29 ditë (9 ditë festa e 20 ditë leje).

Janë për tu mbuluar me shërbimin e rojeve 257 ditë + 29 ditë = 286 ditë

286 ditë x 8 orë = 2,288 orë shërbimi në vit : 12 muaj = 190.67 orë/muaj : 174 orë shërbimi roje/muaj= 1.1 roje për vendroje (1.096 roje për vendroje).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Në këtë rast: 2 roje për vendrojen e Poliklinikës duheshin llogaritur 2.2 roje për vendroje në përlllogaritjen e fondit limit.

Gjithsej duhen për mbulimin e shërbimit: 27.10 roje (24.90 për 5 vendrojet 24 orëshe +2.2 për vendrojen 8 orës me dy roje).

Përlllogaritja e fondit limit: $[(24.90 \times 49,294.11) + (2.2 \times 41,493.86)] = [1,227,423.34 \text{ (rojet me 3 turne)} + 91,286.49 \text{ (rojet me 1 turn)}] = 1,318,709.83 \text{ lekë/muaj} : 30.41 \text{ ditë/muaj} = 43,364.35 \text{ lekë/ditë}$

Fondi limit për 304 ditë duhej përlllogaritur në vlerën 13,182,761.89 lekë pa TVSH (43,364.35 lekë/ditë x 304 ditë).

Fondi Limit është përlllogatitur 2,586,131.55 lekë pa TVSH më tepër (15,768,893.44 lekë-13,182,761.89 lekë).

Vlera 2,578.419.24 lekë pa TVSH (2,586,131.55 - 6,712.32 lekë që është diferenca midis F.L dhe ofertës fituese) ose 3,095,303.08 lekë me TVSH, është efekti financiar negative si rezultat i përlllogaritjes jo sakt të Fondit Limit nga

Grupi i Punës për Përlllogaritjen e Fondit limit: z. Gj. G. Kryetar i Degës së Planifikimit, znj. M. G. specialiste planifikimi e znj. M. L. specialiste planifikimi.

Autoriteti Kontraktor nuk ka përcaktuar numrin e rojeve në një vendroje, duke marrë në konsideratë koeficientin e zëvendësimit bazuar në të drejtat e punonjësve të shërbimit për leje të zakonshme, pushimet në fundjave si dhe të drejtën për pushim në rast feste zyrtare, me qëllim që tu krijohen lehtësi OE si në përgatitjen e ofertës së tyre por edhe më pas në realizimin e objektit të prokurimit dhe lehtësimin e punës së AK për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratës.

- Për pesë vendroje me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje.

5 vendroje me shërbim 24 orë me tre turne x 4.98 roje/vendroje = **24.90 roje gjithsej për 5 vendroje.**

- Për një vëndroje me një turn me 2 roje te Poliklika Qëndrore e Spitalit (nuk duhet të përfshihen në përlllogaritjen e pagës mujore e shtuna e të diela si dhe turnet e II dhe të II).

Për 2 (dy) rojet që punojë vetëm turni i parë nga e Hëna në të Premten, nuk duhet të marrin orë nate dhe ditë të shtuna e të diela.

• **Miratimi i DT.**

-Në dosjen e prokurimit gjendet procesverbali nr.1, datë 17.01.2017, i NJP për prokurimin e sipërcituar, ku është përlllogaritur Fondi Limit është përcaktuar në referim të provesverbalit të mbajtur nga komisioni i ngritur me urdhërin nr. 90, datë 10.01.2017. Afati i shërbimit do të jetë nga data 03.03.2017 deri më 31.12.2017 (304 ditë kalendarike), me Fond Limit **15,768,893.44** lekë pa TVSH.

-Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur më datë 18.01.2018, për miratimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimet teknike për prokurimin që do të zhvillohet më date 13.02.2017.

Përmbajtja e procesverbalit nuk përmbush (përshkrues) asnjë nga kushtet e paracaktuara në LPP dhe neni 11 pika 3/c, neni 23 pika 1 dhe neni 61, paragrafi i parë i VKM nr. 914, datë 29.11.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në të cilët përcaktohet që:

Neni 14-3/c Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve.

c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Neni 23-1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm etë hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.*

Neni 61-1. *Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit.*

2. Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon.

Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Dokumentet e tenderit nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato.

Lidhur me këtë pikë, mbajnë përgjegjësi ligjore të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, konkretisht z. B. H., z. Gj. G. e z. E. R.

Në dosje e prokurimit gjenden Formularet e Deklarimit të mos konfliktit të interes nënshkruar nga antarët e NJP e KVO në zbatim të nenit 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

• Urdhri i Prokurimit.

Titullari i autoritetit kontraktor znj. E. B., ka nxjerrë Urdhërin e Prokurimit nr. 46, e nr.150 prot., datë 17.01.2017 ku është përcaktuar : Fondi limit 15,768,893.44 (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre pikë dyzetë e katër) lekë pa TVSH, lloji i procedurës (e Hapur) e është ngarkuar Njësia e Prokurimit; z. Gj. G., z. E. R. e z. B. H. për zbatimin e këtij urdhëri.

-Me Urdhërin nr.151 prot., datë 17.01.2017, Titullari i AK znj. E. B., në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar si dhe në nenin 33, pika 2/a të Kreut IV të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është urdhëruar ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për prokurimin me objekt: "Shërbim i rojeve private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dhe dy ndërtesa me kamera", data e zhvillimit të prokurimit 13.02.2017, ora 10.⁰⁰,

• Procesi i vlerësimit të ofertave.

-Nga NJP është është formuluar/nënshkruar procesverbali i datë 17.01.2017 i hapjes së ofertave, ku përshkruhet: Oferta e hedhura në sistem dhe shqyrtimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik që kanë paraqitur interes.

Procedura e prokurimit: "E Hapur" Përshkrim i shkurtër i kontratës : "Shërbim i rojeve private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dhe dy ndërtesa me kamera": 4.813.311(katër milion e tetëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit. Kohëzgjatja e kontrates është: duke filluar nga data e lidhjes së kontratës 03.03.2017 deri me date 31.12.2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

-Nga NJP e KVO është është formuluar/nënshkrurat procesverbali i datë 13.02.2017 i hapjes së ofertave, ku përshkruhet: Oferta e hedhura në sistem dhe shqyrtimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik që kanë paraqitur interes.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Operatori Ekonomik "V.-S." SHPK, me Nipt K23711001K. Vlera ekonomike e ofertës është: 4.693.812,90 (katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dymbëdhjetë, e nëntë të dhjetat) lekë pa TVSH.

2.Operatori ekonomik "S.-K." SHPK, me Nipt L43907002H. Vlera ekonomike e ofertës është: 4.813.311 (katër milion e tetëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e njëmbëdhjetë), lekë pa TVSH.

3.Operatori ekonomik "N." SHPK, me Nipt K31422029Q. Vlera ekonomike e ofertës është: 4.693.809,75 (katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntë, e shtatëdhjetë e pesë të qintat) lekë pa TVSH.

4.Opertaori ekonomik "E.-S." SHPK, me Nipt K14610001D. Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik "S.-K." SHPK. Ka paraqitur vetëm Estraktin Historik.

- Operatori ekonomik "A. 2 S." SHPK.

1. Nuk ka bërë analizën e ofertës.

2. Mungon vërtetimi për pronësi ose kontratë qiraja për sallën operative, pika 3 e Kapacitetit Teknik.

3. Mungon vërtetimi për Mungon vërtetimi për numrin e armëve, është paraqitur vërtetim për disponimin e dy armëve me leje, kur në DT kërkohen 7 armë me leje.

- Operatori ekonomik "E.-S." SHPK.

Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, dhe nuk ka paraqitur kërkesat e DT, Shtojca 7.

1. Mungojnë pikat b/c/ç të Kriteve të veçanta.

2. Mungon xhirua vjetore e vitit 2016.

3. Mungon deklarata mbi gjendjen financiare.

4. Mungon vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve të energjisë elektrike, pika 2 e Kapacitetit ekonomik dhe financiar.

5. Mungon Pika A, pika b/1/2/4/5/9/11/12 e Kapacitetit Teknik.

- Operatori ekonomik "N." SHPK, pasi nuk ka paraqitur:

Nuk ka paraqitur:

1. Nuk ka plotësuar Pikën 6 të Kapacitetit Teknik. Ka në dispozicion 23 punonjës shërbimi kur në DT kërkohen 32, nuk kanë 3 punonjës të grupit të gatshëm dhe 4 punonjës të sallës operative.

2. Nuk plotëson Pikën 7 e Kapacitetit Teknik.

Ka në dispozicion 4 copë armë të Kategorisë B1, nga 7 copë armë të Kategorisë B1 të kërkuara.

Për arsyt se nuk plotësonin kriteret dhe kushtet kualifikuese të kërkuara në dokumentacionin e tenderit nga AK.

Duke iu refuzuar procedurës së lartpërmendur oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "V.-S." SHPK, në vlerën prej 4.693.812,9 (katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dymbëdhjetë, e nëntë të dhjetat) lekë pa TVSH është identifikuar si e ofertë e suksesshme, pasi ishte i vetmi operator ekonomik që kishte paraqitur të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar nga AK.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 16.02.2017 Buletini Nr. 9 datë 06 Mars 2017 Agjencia e Prokurimit Publik, faqet 136-137/513. Ankesa: nuk ka.

• **Raporti përmbledhës.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Relacioni Përmbledhës datë 27.02.2017, Nësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar Relacionin për procedurën e prokurimit të sipërcituar, dërguar znj. E. B., Titullari i Autoritetit Kontraktor, e cila miratuar e raportit përmbledhës me "Miratime procedurës së tenderit" nr. 399 prot., datë 27.02.2017.

Sipas relacionit përmbledhës drejtuar Titullarit të AK, mbi bazën e të cilit është bërë edhe miratimi i procedurës së prokurimit, fitues i prokurimit me objekt: *"Shërbim me roje private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dy ndëresa me kamera"* është operatori ekonomik "V. S." Shpk & ", me vlerë ekonomike të ofertës prej 15.762.181.12 lekë pa tvsh.

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë, për procedura e prokurimit: "Procedure e Hapur", me objekt: *"Shërbim me roje private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dy ndëresa me kamera"*. Fondi Limit: 15,768,893.44 lekë pa TVSH, ose 18,922,672.12 (tetëmbëdhjete milion e nëntëqind e njezetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy pikë dymbëdhjetë) lekë me TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit. Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 13.02.2017. Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE "V. S." SHPK. Me vlerë të ofertës 15,762,181.12 (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e një pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, ose 18,914,617.34 (tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tridhjetë e katër) lekë me TVSH.

2. OE "A. 2 S." SHPK. Me vlerë të ofertës 15,768,000 (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, ose 18,921,600 (tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e njëzetë e një mijë e gjashtëqind) lekë me TVSH.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, është informuar subjekti ekonomik "V. S." SHPK, përfaqësuar nga z. S. S., me NIPT: K23711001K se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 15,762,181.12 (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e një pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, ose 18,914,617.34 (tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tridhjetë e katër) lekë me TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 17.02.2017, botuar në Buletini e Agjencia e Prokurimit Publik, nr. 9 datë 06 Mars 2017, faqet 162-164/513.

Kontrata e shërbimit me objekt: *"Shërbim me roje private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dy ndëresa me kamera"* me nr. 352 prot., datë 08.03.2017" me nr. 436 prot., datë 03.03.2013 , e lidhur ndërmjet e lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Spitalor, përfaqësuar nga drejtori znj. E. B. dhe "V. S." SHPK, përfaqësuar nga z. S. S., me vlerë të kontratës 15,762,181.12 (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e një pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, ose 18,914,617.34 (tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tridhjetë e katër) lekë me TVSH.

Kontrata për kryerjen e shërbimit të mësipërm do të lidhet për një kohëzgjatje nga data 03.03.2017 deri më datë 31.12.2017.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

- Kontrata e sipërcituar nuk është formuluar sipas parakushteve të paracaktuara në nenin 18 "Kontrata ndërmjet palëve" të Ligjit nr. 75/2014, "Për Shërbimin privat të sigurisë fizike", që sanksionon që:

1. Palët lidhin kontratë, ndërmjet tyre, për kryerjen e shërbimit për ushtrimin e veprimtarisë private të sigurisë fizike, e cila duhet të përmbajë:

- ç) rregullat për regjimin e hyrjes dhe daljes, të ndriçimit, të rrethimit, të mjeteve vëzhguese e sinjalizuese;
- d) numrin e vendrojave dhe të punonjësve të shërbimit, sipas koeficientit të llogaritjes për 40 orë pune në javë për një punonjës shërbimi.

Për objekte të rëndësishme me vlera monetare, materiale e rrezikshmëri për sigurinë publike, përcaktimi i skemës së sigurisë së objektit bëhet me miratim të Policisë së Shtetit;

- dh) llojin e armatimit, të pajisjeve dhe të mjeteve të shërbimit;
- ë) detyrimet financiare midis tyre, në raste të shkaktimit të dëmit;
- f) detyrat dhe të drejtat e palëve, afatin e lidhjes së kontratës, si dhe mënyrat e zgjidhjes së saj.
- g) paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 për qind më e madhe se paga minimale e paracaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për parregullsinë e konstatuar më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Autoritetit kontraktor znj .E. B.

Zbatimi i Kontratës

Në dosjen e zbatimit të kontratës nuk ka asnjë procesverbal, për marrjen në dorëzim të objekteve të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë.

Nga **Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. E. B.** nuk është përcaktuar njësia përgjegjëse për mbikqyrjen e zbatimit të kontratës. Njësia përgjegjëse të kryejë lidhur me këtë kontratë, të gjitha veprimet e përcaktuara shprehimisht në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77.

1. "Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi"

2. Mospërbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja nëprokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç tënenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike Brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.

3. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. "Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes sëkontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi"

4. "Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin.

-Në përgjigje të observacionit dërguar me shkresën nr. 1141 datë 05.07.2019 nga SRK për aktkostatimin nr.15 ju bëjmë me dije se ky observacion nisur dhe nga shkresat e reja dërguar bashkangjitur me vërtetimet e lëshuara nga Drejtoria e përgjithshme e policisë së Shtetit për sa i përket stafit të licensuar merret në konsiderat.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

7. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: *“Shërbim me roje private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dy ndëresa me kamera”*, zhvilluar në vitin 2017.

2. Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

3. Dokumentacioni në faqen elektronike të APP- **REF-42405-01-26-2018**.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1. Urdhër Prokurimi nr. 2 e nr.158 prot., datë 26.01.2018, Titullar AK.z. A. K.	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Me Urdhër nr. Z. B. H.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.2/1, datë 30.12.2018 Z. A. L. Kryetar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E Hapur”	Z. Gj. G. Z. E. R.	Znj. E. M. Znj. A. D.
5. Fondi Limit (pa tvsh) 20,142,279.68 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 20,089,600 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 52,679.68 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 21.02.2018 26.02.2018 Ora 10.⁰⁰	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit 16,756,285.44 planifikuar për vitin 2018 3,362,280.96 planifikuar për vitin 2018	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në prokurim 1 O.E. c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-“D.- S.” SHPK	12. Përgjigje Ankesës –z. A. L., znj. A. D., znj. E. M.	13. Përgjigje - nr.2014, datë 05.02.2018

Referuar dokumentacionit të administruar dhe të vënë në dispozicion nga AK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, konstatohet si më poshtë vijon:

- **Lidhur me përcaktimin e vëndrojeve përlloraritjen dhe miratimin e vlerës së fondit limit:**

-Me kërkesën e datës 19.01.2018, z. E. R. me detyrë Përgjegjësi i Sektorit Teknik dhe z. Gj. G., me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimi drejtuar Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë: *“Për garantimin e shërbimit të ruajtjes së objekteve me roje private të armatosura, nisur nga fakti se shtesa e kontratës së realizuar për të garantuar këtë shërbim gjatë fillim vitit 2018, përfundon në datë 03.03.2019, si dhe nga fakti se procedura e prokurimit të këtij shërbimi kërkon një kohë të gjatë, lutemi filloni për prokurimin dhe sigurimin e këtij shërbimi për vitin 2018”*.

-Skema e vëndrojeve në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Korçë, për vitin 2018 është formuluar më datë 15.01.2018, nga z. E. R. me detyrë Kryetar i Degës Teknike.

Objektet e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë, që kërkohen të ruhen nga (SH.R.S.F) janë të vendosura në pasqyrën përmbledhëse të objekteve të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë që përfshihen kryesisht godina spitalore, zyra, ambiente shërbimi, lavanteri, magazina, parking, territori brenda murit rrethues, etj. me 6 (gjashtë) vëndroje për 24 (njëzet e katër) orë, me 5 roje për vëndroje me tre turne dhe një vënd-roje me një turn me dy roje dhe dy ndëresa me kamera.

1. Një vëndroje te porta hyrëse e Spitalit, me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje.

2. Një vëndroje te porta dalëse e Spitalit, me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje.

3. Një vëndroje tek Urgjenca e Spitalit, me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje.

4. Një vëndroje tek Pediatria e Spitali, me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje, që do të mbulojë me shërbim të pandërprerë pas mbylljes së orarit të vizitorëve edhe ambientet e ORL – Okulistikës, magazinat përballë saj, magazinën e oksigjenit dhe shesh parkimet e helikopterit dhe automjeteve para dhe pas godinës së Pediatrisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

5. Një vendroje në sportelin mbrapa Urgjencës (sheshi i Gështenjës), me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje, që do të mbulojë me shërbim të pandërprerë pas mbylljes së sportelit edhe magazinat dhe kaldajën përballë saj. Godinën e Farmacisë Qëndrore, territorin që përfshin Morgun, garazhet, Senatoriumin, ofiçinën, lavanderinë, kalajdajën qëndrore dhe shesh parkimet e automjetet tek ish Garderoba.

6. Një vendroje te Godina e Manternitetit të Spitalit, me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje.

7. Një vendroje në Poliklika Qëndrore e Spitalit, me shërbim me një turn me dy roje, dhe dy turne me kamera dhe sinjal alarmi.

• **Përlllogaritja e fondit limit**

-Titullari i AK z. A. K., me nr.133 prot., datë 22.01.2018 ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit

-Grupi i Punës për Përlllogaritjen e Fondit limit: z. Gj. G. Kryetar i Degës së Planifikimit, znj. Zh. T. specialiste planifikimi e znj. L. P. specialiste planifikimi, ka nënshkruar.

-Përlllogaritja e fondit limit për prokurimim me objekt: "*Shërbim i rojeve private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dhe dy ndërtesa me kamera*", është realizuar për 424 ditë kalendarike kur në DT është prokuruar për 1 vit kalendarik.

- -Vlera mujore e përlllogaritur për një roje në muaj është **52,380.91** lekë
- -Vlera ditore është **1,722.48** lekë
- -Ditë pune të tenderuara **424** ditë.
- -Numri total i rojeve që nevojitet për të të përmbushur shërbimin është 32 roje.
- -Vlera monetare pa TVSH që duhet tenderuar është **23,370,608.64** lekë
- -TVSH **4,674,121.72** lekë
- Vlera monetare me TVSH që duhet tenderuar është **28,044,730.36** lekë

-Përlllogaritja e fondit limit është bërë për periudhën kohore nga data 03.03.2018 deri më datë 28.02.2019, pasi është njohur me skemën e vendrojeve të paraqitur nga Sektori Teknik.

Nr	Emërtimi	Vlera Lek për një roje/muaj
1	Paga minimale	36,000
2	Shtesa për turne II, III, festa zyrtare dhe pushime vjetore	7,158.75
	Shuma I	43,158.75
3	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 16.7% punëdhënësi	7,207.51
	Shuma II	7,207.51
	Shuma III = I + II	50,366.26
4	Fitimi 4 %	2,014.65
	Totali I + II + III	52,380.91

Përlllogaritja e detajuar e zërave të tabelës është si më poshtë:

a- Paga bazë e vendosur me VKM nr.391, datë 03.05.2017 është 24,000 lekë.

b- Paga bazë për punonjësit e SHPSF-së referuar ligjit nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", neni 18 pika g Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me VKM" është 36,000 lekë.

c- Shtesat për turne II, III festa zyrtare dhe pushime vjetore paraqiten si më poshtë;

- Punonjësit që punojnë natën, në ditën e pushimit javor e të festave zyrtare, brenda kohëzgjatjes normale ditore të punës përfiton një shtesë page në masën.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

- 20% për çdo orë e shërbimit të kryer nga ora 19⁰⁰-22⁰⁰
- 50% për çdo orë e shërbimit të kryer nga ora 22⁰⁰-06⁰⁰
- 25% për punën e kryer në ditët e festave zyrtare dhe të pushtimit javor.
- 75 % për çdo orë e shërbimit të kryer natën në ditët e festave zyrtare dhe të pushtimit javor.
- Një muaj ka mesatarisht 30.41 ditë (365 ditë/12muaj).
- Një punonjës me Kod Pune punon 174 orë/pune muaj.
- Mbi këtë bazë një orë pune është 206.89 lekë (36,000lekë/174 orë).
- Ditë pushimi dhe të djela për këtë vit janë 104 ditë.
- Festat zyrtare për këtë vit janë 14 ditë, nga të cilat katër festa janë ditë të shtuna dhe të diela (01-02 Janar-Festa e Vitit të Ri, 14 Mars- Dita e Verës, 22 Mars-Sulltan Novruz, 01 Prill-Pashka Katolike dhe 08 Prill -Pashka Ortodokse, 1 Maj- Dita e Punëtorëve, 15 Qeshor-Barjam i Madh, 21 Gusht-Kurban Barjam, 19 Tetor-Lumturimi i Nënë Terezës, 28-29 Nëntor- Festa Kombëtare e Çlirimit dhe Pavarësisë, 8 Dhjetor Dita e Rinisë, 25 Dhjetor-Krishtlindja).
- Pushimet vjetore për punonjësit llogariten 28 ditë kalendrike nga të cilat 8 ditë janë të shtuna dhe të diela.
- Ditë pushimi në total llogariten 138 ditë. (104+14 festa zyrtare +20 ditë pushime vjetore)
- Ditë punë vjetore 227 ditë (365-138)
- Numri i punonjësve për një vendpune është 5 referuar shkresës së Ministrisë të Shëndetësisë nr, 625/1, datë 12.02.2010.
- Përlllogaritja e fondit limit është bërë për periudhën 01 Janar 2018 deri në Shkurt 2019, gjithsej 428 ditë.
- Përlllogaritja për shërbimin natën në ditët e pushimit:
 - Ditore
 - Turni i II nga ora 19⁰⁰ - 22.⁰⁰ = 3 orë
 - Turni i III nga ora 22⁰⁰ - 06⁰⁰ =8 orë
 - Mujore
 - Turni i II në 30.41 ditë x 3 orë= 91.23 orë
 - Turni i III 30.41 ditë x 8 orë = 243.28 orë
 - Për një punonjës/muaj
 - Turni i II 91.23 orë : 5 roje = 18,246 orë
 - Turni i III 243.28 orë : 5 roje = 48,656 roje
 - Përlllogaritja e përfitimit për festat zyrtare të shtunave dhe të dielave;
 - Ditë 115 (105+10) x 8 orë = 920 orë/vit
 - 920 orë/12 muaj = 76.66 orë/muaj
 - 76.66 orë/muaj / 5 roje = 15,33 orë/roje
 - Përlllogaritja për përfitimit në turnet II dhe të II për festat zyrtare
 - 14 ditë/12 muaj = 1.16 ditë/muaj
 - 1.16 ditë/muaj : 5 roje = 0,232 ditë/roje në muaj
 - Turni i II në 0,232 ditë x 3 orë = 0.696 orë/muaj (nga ora 19⁰⁰ - 22.⁰⁰)
 - Turni i III në 0,232 ditë x 8 orë = 1.856 orë/muaj (nga ora 22⁰⁰ - 06⁰⁰)
 - Përlllogaritja në vlerë
- Përlllogaritja për shërbimin natën dhe ditët e pushimit:
 - Turni i II 18.246 orë x (258.61-206.89) = 943.68 lekë
 - Turni i III në 48,656 orë x (310.33- 206.89)= 5,032.97 lekë
- Përlllogaritja për festat zyrtare, të shtuna dhe të diela.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

-Turni I-rë (25%) 15.2 orë x (258.61 – 206.89) = 786.14 lekë

-Turni i II-të dhe i III-të (75 %) 0,696 orë + 1,856 orë x (362.05 – 206.89) = 395.96 lekë

Totali i përfitimit për festat zyrtare, të shtunat dhe të dielat.

(943.68 + 5032.97 + 786.14 + 395.96) = 7158.75 lekë.

-Në dosjen e prokurimit gjendet procesverbal nr.1, datë 26.01.2018, i NJP për prokurimin e sipërcituar, ku është përllogaritur Fondi Limit për një roje në ditë 1,722.48 (njëmijë e shtatqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH, duke ju referuar çmimit të përllogaritur nga Komisioni i Përllogaritjes së Fondit Limit. Afati i shërbit do të jetë 12 muaj, me Fond Limit 20,118,566.40 lekë pa TVSH.

-Nga Njësia e Prokurimit është mbatur më datë 26.01.2018, për miratimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimet teknike për prokurimin që do të zhvillohet më date 21.02.2018.

i hartimit të Dokumentave të tenderit. Përmbajtja e procesverbalit nuk përmbush (përshkruet) asnjë nga kushtet e paracaktuara në LPP dhe neni 11 pika 3/c, neni 23 pika 1 dhe neni 61, paragrafi i parë i VKM nr. 914, datë 29.11.2014“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në të cilët përcaktohet që:

Neni 14-3/c Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve.

c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit

Neni 23-1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm etë hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Neni 61-1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit.

2. Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon.

Në çdo rast, **hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen** në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Dokumentet e tenderit nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato.

Lidhur me këtë pikë, mbajnë përgjegjësi ligjore të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, konkretisht z. B. H., z. Gj. G. e z. E. R.

Në dosje gjenden Formularet e Deklarimit të mos konfliktit të interesit nënshkruar nga antarët e NJP e KVO në zbatim të neni 56 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Përllogaritja e pagesës dhe numrit të rojeve për vendroje në Poliklika Qëndrore e Spitalit, me shërbim me një turn me dy roje.

Numrit i rojeve për vendroje duhej përllogaritur:

- Për pesë vendroje me shërbim 24 orë me tre turne me pesë roje.

5 vendroje me shërbim 24 orë me tre turne x 4.98 roje/vendroje = 24.90 roje gjithsej për 5 vendroje.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

- Për një vëndroje me një turn me 2 roje te Poliklika Qëndrore e Spitalit (nuk duhet të përfshihen në përllogaritjen e pagës mujore e shtuna e të diela si dhe turnet e II dhe të II).

Për 2 (dy) rojet që punojë vetëm turni i parë nga e Hëna në të Premten, nuk duhet të marrin orë nate dhe ditë të shtuna e të diela.

Llogaritja e detajuar paraqitet në tabelë.

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje/muaj
1	Shpenzime për page bazë	36,000
2	Shtesë mbi pagë për turnin II	0
3	Shtesë mbi pagë për turnin III	0
4	Shtesa mbi page per festat zyrtare dhe pushimet vjetore	1,034.92
	Shuma I	37, 034.92
5	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%	6,184.83
6	Fitimi 4 %	1728.79
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje në muaj	44,948.54

Përllogaritja e detajuar e zërave të tabelës është si më poshtë:

- Përllogaritja e përfitimit për festat zyrtare dhe pushimet vjetore;
-10 Ditë/ vit x 8 orë = 80 orë/vit : 12 muaj = 6.67 orë/muaj : 2.2 roje = 3.03 orë/roje
Turni I-rë (25%) 3.03 orë/roje x (258.61 – 206.89) = **156.71 lekë/muaj** për roje.
-20 ditë/vit pushime vjetore x 8 orë= 224 orë : 12 muaj = 18.67 orë/ muaj : 2.2 roje për vëndroje = 8.49 orë/muaj për roje. 8.49 orë/muaj x (310.33- 206.89) =**878.21 lekë/muaj**.
Shtesa e pagës për rojet me shërbim me një turn për ditët e festave dhe pushimet janë 1034.92 lekë/ muaj (156.71 lekë/muaj + 878.21 lekë/muaj).

Në përllogaritjen e fondit limit paga e rojeve vëndroje në Poliklika Qëndrore e Spitalit, me shërbim me një turn me dy roje paga mesatare mujore duhej 47,262.25 lekë dhe jo 52,380.91

Pra paga mujore është përllogaritur 11,766.16 lekë pa TVSH më tepër.

(11,766.16 lekë/muaj x 12 muaj = 141,193.92 lekë në vit); Kujtojmë që janë dy roje

141,193.92 lekë x 2.2 roje =310,626 .64 lekë pa TVSH më tepër është përllogaritur Fondi Limit më tepër për 2 roje në një vëndroje 8 orë për një vit.

- Përllogaritja e pagesës dhe numrit të rojeve për vëndroje në Poliklika Qëndrore e Spitalit, me shërbim me një turn me dy roje.

Gjatë vitit kalendarik:

Ditë pushimi në total llogariten 138 ditë. (104+14 festa zyrtare +20 ditë pushime vjetore)

Ditë punë vjetore 227 ditë (365-138)

Duke konsideruar që dy rojet punojnë edhe në ditët e festave: nga 14 festa zyrtare 4 janë të shtuna e të diela kështu që duhen marrë në konsideratë vetëm 10 ditë festa zyrtare. (kjo duhet parë nëse poliklinika ruhet në ditë festash)

227 ditë pune në vit + 10 ditë festa (pasi 4 festa bien të shtuna e të diela) + 20 ditë leje e zakonshme (pasi 8 ditë nga leja bien të shtuna e të diela)= janë gjithsej 257 ditë pune në vit së bashku me festa dhe lejen e zakonshme.

Këtyre i shtojmë ditët që do të jenë të dubluara, kur roja duhet të jetë i zvendësuar për arsye të lejes apo festave 30 ditë (10 ditë festa e 20 ditë leje).

Janë për tu mbuluar me shërbimit 257 ditë + 30 ditë = 287 ditë

287 ditë x 8 orë = 2,296 orë shërbimi në vit : 12 muaj = 191.33 orë/muaj : 174 orë shërbimi roje/muaj= 1.1 roje për vëndroje.

Në këtë rast: 2 roje për vëndrojen e Poliklinikës duheshin llogaritur 2.2 roje për vëndroje në përllogaritjen e fondit limit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Gjithsej duhej 27.10 roje (24.90 për 5 vendrojet 24 orëshe +2.2 për vendrojen 8 orës me dy roje). Përlllogaritja e fondit $[(24.90 \times 52,380.91) + (2.2 \times 44,948.54)] = [1,304,284.66 \text{ (roje me 3 turne)} + 98,886.79 \text{ (roje me 1 turn)}] = 1,403,171.45 \text{ lekë/muaj} : 30.41 \text{ ditë/muaj} = 46,141.78 \text{ lekë/ditë}$ Fondi limit për 365 ditë duhej përlllogaritur në vlerën 16,841,784.72 lekë pa TVSH (46,141.78 lekë/ditë x 365 ditë).

Fondi Limit është përlllogatitur 3,300,530.96 lekë pa TVSH më tepër (20,142,279.68 lekë - 16,841,784.72 lekë).

Vlera 3,247,851.28 lekë pa TVSH (3,300,530.96 - 52,679.68 lekë që është diferenca midis F.L dhe ofertës fituese), është efekti financiar si rezultat i përlllogaritjes gabim të Fondit Limit nga Grupi i Punës për Përlllogaritjen e Fondit limit: z. Gj. G., znj. Zh. T. e znj. L. P.

Autoriteti Kontraktor nuk ka përcaktuar numrin e rojeve në një vendroje, duke marrë në konsideratë koeficientin e zëvendësimit bazuar në të drejtat e punonjësve të shërbimit për leje të zakonshme, pushimet në fundjave si dhe të drejtën për pushim në rast feste zyrtare, me qëllim që tu krijohen lehtësi OE si në përgatitjen e ofertës së tyre por edhe më pas në realizimin e objektit të prokurimit dhe lehtësimin e punës së AK për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratës.

Njoftimi i kontratës është botuar në Buletini Nr. 5, datë 05 Shkurt 2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik, faqet 24-25/506.

Lloji i procedurës së prokurimit: "Procedure e Hapur" – prokurim me mjete elektronike shërbime. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër "Shërbim me roje private të Spitalit Korçë", me 6 vendroje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dy ndërës me kamera" – Marrëveshje Kuadër - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj.

Fondi Limit Fondi i Marrëveshjes Kuadër për 12 muaj- 20,118,566.40 (njëzetë e milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë katër) leke pa TVSH, ose 24,142,279.68 (njëzetë e katër milion e njëqind e dyzetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë me TVSH.

Fondi limit për një roje në ditë 1,722.48 (njëmijë e shtatëqind e njëzetë e dy pikë dyzetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 2,066.976 (dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë pikë nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin 12 muaj:

- **Urdhri i Prokurimit.**

Titullari i autoritetit kontraktor, ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr.2 e nr.158 prot., datë 26.01.2018 ku është përcaktuar : Fondi limit 20,118,566.40 lekë pa TVSH (ku shuma 16,756,285.44 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, planifikuar për vitin 2018. Lloji i procedurës (e Hapur) e është ngarkuar Njësia e Prokurimit për zbatimin e këtij urdhëri.

- **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.**

Me Urdhërin nr.159 prot., datë 26.01.2018, Titullari i AK z. A. K., në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar si dhe në nenin 33, pika 2/a të Kreut IV të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është urdhëruar ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për prokurimin me objekt: "Shërbim i rojeve private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dhe dy ndërës me kamera", data e zhvillimit të prokurimit 21.02.2018, ora 10.00, KVO^{ja} z. A. L. (Kryetar), znj. E. M. e znj. A. D.



KONTROLLI I LARTË I SHETITIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

- Njoftim paraprak i kontratës nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë është botuar në Buletini eAPP Nr. 4 datë 28 Janar 2019 Agjencia e Prokurimit Publik, Faqe 24-25/515.

-Lloji i procedurës: “Procedure e Hapur” – prokurim me mjete elektronike shërbime, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

-Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër “Shërbim me roje private të Spitalit Korçë”, me 6 vendroje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd-roje me një turn me 2 roje dhe dy ndëresa me kamera” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

-Fondi limit: **20,118,566.4** (njëzetë e milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë katër) lekë pa TVSH, ose 24,142,279.68 (njëzetë e katër milion e njëqind e dyzetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tetë) leke me TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

-Fondi limit per nje roje ne dite 1,722.48 (një mijë e shtatëqind e njëzetë e dy pikë dyzetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 2,066.976 (dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë pikë nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH.

- **Ankesa nga OE për DT**

-Më datë 01.02.2018 SHPSF “D. S.” SHPK kanë paraqitur ankesën për DT pranë AK.

Me urdhër nr.195, datë 01.02.2018 Titullari i AK ka pezulluar procedurën e prokurimit, ka ngarkuar; z. A. L., znj. A. D. e znj. E. M. Komisioni për shqyrtimit të ankesës.

Komisioni i ka dërguar Titullarit të Autoritetit Kontraktor rekomandimet në lidhje me ankesën e paraqitur SHPSF “D. S.” SHPK në lidhje me DT, më datë 05.02.2018.

Tek kapaciteti Teknik, gërma B

Pika 3. Operatori ekonomik të ketë Sallë Operative (qendra e kontrollit) në qytetin e Korçës, për vëzhgimin e kamerave dhe të sistemit të alarmit, kjo vërtetuar me vërtetim pronësie ose kontrate qeraje për Sallë Operative dhe pagesën e taksave pranë Bashkisë Korçë, për periudhën kohore Janar 2017 – Dhjetor 2017, bazuar në nenin 22 të Ligjit nr. 75/2014 për “Shërbimin privat të sigurisë fizike”. **Kjo të shoqërohet me aktin e miratimit të qendrës së kontrollit nga Policia e Shtetit në Qarkun Korçë.**

Pika 5. “Ofertuesi duhet të paraqesë **Licensën** (zëvendësuar me termin **Çertifikatën**) e Drejtuesit **Teknik** të shoqërisë, e cila duhet të jetë e kategorisë “a” ose “a+b” për ushtrimin e aktivitetit të Ruajtjes dhe sigurimit fizik i objekteve dhe pronave” konform Ligjit nr. 8770, datë 19.04.2001 nga Ministria e Brendshme (të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit) ose ekuivalentet “**Çertifikatë**” për drejtuesin teknik të shoqërisë sipas Ligjit nr.10081, datë 23.02.2009.

Pika 7. “Ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim performance lëshuar nga Drejtoria vendore e Policisë Korçë ku të konfirmohet numri i punonjësve të certifikuar jo më pak se 40 punonjës shërbimi, (numri i operatorëve të shërbimit, numri e punonjësve të shërbimit dhe për grupin e gatshëm), **si dhe vërtetim lëshuar nga Drejtoria vendore e Policisë Korçë** për numërin e armatimit në bazë të Ligjit nr. 72/2014, “Për përdorimin e armëve të zjarrit” numri i të cilave nuk duhet të jetë më pak se 7 (shtatë) copë të kategorisë B 1, për të përmbushur dhe realizuar objektin e kontratës.

Në DT Shtojca 1 AK për numrin e rojeve për vendrojet me me 3 turne (4.98 roje) në muaj, ndërkohë tek po kjo shtojcë shprehet: “Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet 5”.

Me shkresën nr. 2014, datë 05.02.2018 i është kthyer përgjigje SHPSF “D. S.” SHPK në lidhje me ankesën e depozituar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Me urdhërin nr. 203, datë 05.02.2018 është hequr pezullimi i procedurës së prokurimit e në zbatim të LPP e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, data e zhvillimit të prokurimit do të jetë 26.02.2018.

- **Procesi i vlerësimit të ofertave.**

-Nga NJ e KVO është formuluar/nënshkruar Procesverbali i datës 26.02.201 e procesverbali nr. 3 , datë 27.02.201i i hapjes së ofertave, ku përshkruhet: Oferta e hedhura në sistem dhe shqyrtimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik që kanë paraqitur interes.

Është paraqitur një operatorë ekonomikë:

1. Operatori ekonomikë “V. S.” SHPK, përfaqësuar nga z. S. S., me vlerë ekonomike të ofertës prej 20,089,600 lekë pa TVSH në Muaj.

KVO, ka identifikuar dokumentacionet kualifikuese, të paraqitura nga OE “V. S.” SHPK.

- **Raporti përmbledhës.**

Relacioni Përmbledhës është formuluar/nënshkruar më datë 07.03.2018, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe Njësia e Prokurimit.

Raportin Përmbledhës për procedurën e prokurimit të sipërcituar, dërguar z. A. K., Titullari i Autoritetit Kontraktor, i cili ka miratuar e Raportit Përmbledhës me Vendimin nr. 341 prot., datë 07.03.2018 “Miratim i Procedurës të Tenderit”.

Kontrata e shërbimit me objekt: “Shërbim me roje private të Spitalit Korçë, me 6 vend-roje me 24 orë, me 5 roje me tre turne dhe 1 vënd–roje me një turn me 2 roje dhe dy ndëresa me kamera” me nr. 352 prot., datë 08.03.2018, e lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Spitalor, përfaqësuar nga drejtori z. A. K. dhe “V. S.” SHPK, përfaqësuar nga z. S. S., me vlerë të kontratës për njësi për një roje në ditë 1,720 (njëmijë e shtatëqind e njëzetë) lekë pa TVSH, ose 2,064 (dy mijë e gjashtëdhjetë e katër) lekë me TVSH.

Kontrata për kryerjen e shërbimit të mësipërm do të lidhet për një kohëzgjatje nga data 08.03.2018 deri më 31.12.2018.

Kontrata e sipërcituar nuk është formuluar sipas parakushteve të paracaktuar në nenin 18 “Kontrata ndërmjet palëve” të të Ligjit nr. 75/2014, “Për Shërbimin privat të sigurisë fizike”, që sanksionon që:

1. *Palët lidhin kontratë, ndërmjet tyre, për kryerjen e shërbimit për ushtrimin e veprimtarisë private të sigurisë fizike, e cila duhet të përmbajë:*

ç) rregullat për regjimin e hyrjes dhe daljes, të ndriçimit, të rrethimit, të mjeteve vëzhguese e sinjalizuese;

d) numrin e vendrojave dhe të punonjësve të shërbimit, sipas koeficientit të llogaritjes për 40 orë pune në javë për një punonjës shërbimi.

Për objekte të rëndësishme me vlera monetare, materiale e rrezikshmëri për sigurinë publike, përcaktimi i skemës së sigurisë së objektit bëhet me miratim të Policisë së Shtetit;

dh) llojin e armatimit, të pajisjeve dhe të mjeteve të shërbimit;

ë) detyrimet financiare midis tyre, në raste të shkaktimit të dëmit;

f) detyrat dhe të drejtat e palëve, afatin e lidhjes së kontratës, si dhe mënyrat e zgjidhjes së saj.

g) paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 për qind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për parregullsinë e konstatuar më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A. K.

Zbatimi i Kontratës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Në dosjen e zbatimit të kontratës nuk ka asnjë procesverbal, për marrjen në dorëzim të objekteve të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë.

Nga **Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A. K. nuk** është përcaktuar njësi përgjegjëse për mbikqyrjen e zbatimit të kontratës. Njësi përgjegjëse të kryejë lidhur me këtë kontratë, të gjitha veprimet e përcaktuara shprehimisht në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77.

1. "Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi"

2. Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike Brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.

3. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. "*Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi"*

4. "Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin.

-Nga riaditimi i dokumentacionit të ardhur me observacion dhe email për listapagesa dhe nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe stafit të deguar në shërbim në vendroje sipas Listave emërore e punonjësve të spitalit Korçë për çdo muaj të dërguar nga operatori ekonomik "V. S." të dërguara nga subjekti me email u konstatua se operatori ekonomik është në kushtet e realizimit të evazionit fiskal pasi: në ofertën e dërguar dhe kontratën e lidhur operatori ekonomik harton ofertën në përputhje me kodin e punës ligjin për shërbimin e rojeve private si dhe duke I kalkuluar të gjitha kostot dhe vështirësin në këtë pozicion dhe duke nxjerr një kosto mujore pa fitimin për roje prej **50,146 lekë në muaj**, dhe sigurimet shoqërore e shëndetsore mbi këtë vlerë. Ndërkohë që në listapagesat ESig operatori ekonomik i paguan këto roje më pagën minimale të këtij pozicioni në **vlerën 36,000 lekë në muaj** e për rrjedhojë dhe sigurimet shoqërore e shëndetsore mbi këtë vlerë. Operatori ekonomik "V. S." ka përfutuar padrejtësisht 14,146 lekë në muaj nga secili punonjës shërbimi dhe në total **shumën e pagave bruto prej 5,432,064 lekë** për 32 punonjës për 12 muaj të papaguara ndaj punonjësve.

Për pasojë operatori ka shmangur detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për pagat e papaguara në shumën **1,515,264 lekë**, si dhe detyrimin për Tatimin mbi të ardhurat personale në shumën **705,792 lekë**, vlera të cilat përbëjnë shmangie të detyrimeve dhe **dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit**. Operatori ekonomik "V. S." ka përfutuar padrejtësisht 14,146 lekë në muaj nga secili punonjës shërbim në total **5,432,064 lekë**, vlerë e cila duhet ti shpërndahet punonjësve sipas muajve përkatës.

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës me nr. 341 prot., datë 07.03.2018, lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë "V. S.", SHPK, me objekt "Shërbim me roje private Spitali Korçë", me vlerë 1720 lekë/ditë për roje ose 20,089,600 lekë si vlerë totale e kontratës pa TVSH, me afat shërbimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

nga 01.03.2018 – 31.03.2019, u konstatua se: Nga verifikimi i librave të ndërrimit të turneve u konstatuan punonjës të cilët kanë kryer shërbim mbi 40 orë në javë apo 22 ditë punë në muaj, në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar si dhe ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ku cilëson kohëzgjatja maksimale e punës në muaj 174 orë. Konkretisht për vendrojen numër 1 të kësaj hyrjeje të spitalit kanë rezultuar punonjësit z. P. T. dhe z. A. K. me nga 24-25 ditë pune në muaj. Të verifikohen të gjitha librat e ndërrimit të turneve dhe të njoftohet Inspektoriati i Punës për marrjen e masave përkatëse.

-Në përgjigje të observacionit nr. 1380 prot., datë 22.08.2019 për sa i përket procedurës së prokurimit me shërbimin e rojeve provate ju bëjmë me dije se nuk merret në konsiderat, më sipër keni rikalukulimet dhe problematikën e zbuluar.

Nga auditimi i procedurave të furnizimeve me medikamente për vitet 2017-2018 u konstatua se:

8-Nga auditimi i procedurës së prokurimit ‘Blerje Medikamentesh për nevojat Spitalore, Spitali Korçë, e ndarë në lotë’ me nr. REF-Nr 286 prot., datë 06.02.2017 me operator fitues “F.” dhe vlerë kontrate 1,720,740 lekë nr. 382 prot., me afat zbatimi kontrate deri më 31.03.2017 u konstatua se:

Nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar afati i furnizimit me medikamente, furnizimi i fundut i tij ka ardhur më 20.04.2017 duke e tejkaluar afatin maksimal të lëvrimit me 20 ditë.

Nga ana e autoritetit kontraktorë nuk janë llogaritur penalitetet për këtë operatorë në vlerën **34,446 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

Si dhe nga auditimi i furnizimeve u konstatua se për disa artikujt nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar cilësia e medikamenteve sipas nenit 3 të kontratës sku citohet: *Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës por në çdo rast jo më e vogël se 12 muaj.*

Për disa artikuj afati i skadencës në ditën e furnizimit është më i vogël se 12 muaj, edhe pse medikamentet janë furnizuar në kundërshtim me kushtet e kontratës nga ana e autoritetit kontraktorë këto artikuj janë pranuar sipas tabelës së mëposhtme:

Medikamenti	Dt. Furnizimit	Dt. skadencës	Af. mujor	Vlera
Cefotaxime sodium 1gram	23.02.2017	04.01.2018	10	220,500
Ceftazidime pentahydrate 1gram	03.03.2017	01.02.2018	11	177,600

-Me urdhër shpenzimin nr.122 datë 13.03.2017 me vlerë 641,460 lekë për kontratën nr. 382 është likuaduar fatura nr. 5400 datë 03.03.2017 me vlerë 283,600 lekë, shoqëruar me flet hyrjen nr. 94 datë 03.03.2017 nënshkruar nga përgjegjësja e farmacisë znj. R. P. si dhe fatura nr. 5380 datë 23.02.2017 me vlerë 357,860 lekë, shoqëruar me flet hyrjen nr. 81 datë 23.02.2017 nënshkruar nga përgjegjësja e farmacisë znj. R. P.

Referuar procesverbalit të kolaudimit dhe marrjes në dorzim datë 23.02.2017 për faturën nr. 5380 datë 23.02.2017 të hartuar nga komisioni i përbëra nga znj. R. P., znj. A. N., znj. Z. N., z. K. N. dhe znj. E. D. u konstatua se është pranuar një artikuj barna Cefotaxime sodium 1gram me datë skadence Janar 2018, barna të cilat nuk duheshin pranuar nga komisioni i kolaudimit dhe marrjes dorzim duke respektuar një afat minimal skadence prej 12 muajsh pa llogaritur kushtet e ruajtjes së medikamenteve në farmacinë e spitalit që zvoglojnë jetgjatësinë e tyre.

Referuar procesverbalit të kolaudimit dhe marrjes në dorzim datë 03.03.2017 për faturën nr. 5400 datë 03.03.2017 të hartuar nga komisioni i përbëra nga znj. R. P., znj. A. N., znj. Z. N., z. K. N. dhe znj. E. D. u konstatua se është pranuar një artikuj barna Ceftazidime pentahydrate 1gram me datë skadence 1 shkurt 2018, barna të cilat nuk duheshin pranuar nga komisioni i kolaudimit dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

marrjes dorzim duke respektuar një afat minimal skadence prej 12 muajsh pa llogaritur kushtet e ruajtjes se medikamenteve në farmacinë e sptalit që zvoglojnë jetgjatësinë e tyre.

9-Nga auditimi i procedurës së prokurimit ‘B1 - Blerje barna sistemi anti-infektiv të përgjithshme për nevoja spitalore, ndarë në lotë’ me nr. REF-Nr 86 prot., datë 17.02.2017 me operator fitues “F.” dhe vlerë kontrate 1,197,900 lekë me afat zbatimi kontrate deri më 15.12.2017, u konstatua se:

Nga auditimit i furnizimeve u konstatua se për disa artikujt nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar cilësia e medikamenteve sipas nenit 4 të kontratës sku citohet: *Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës por në çdo rast **jo më e vogël se 12 muaj**, nga data e lëvrimit të mallit.*

Për disa artikuj afati i skadencës në ditën e furnizimit është më i vogël se 12 muaj, edhe pse medikamentet janë furnizuar në kundërshtim me kushtet e kontratës nga ana e autoritetit kontraktorë këto artikuj janë pranuar.

-Me urdhër shpenzimin nr. 335 datë 17.07.2017 është likujduar fatura nr. 8554 datë 20.04.2017 me vlerë 210,200 lekë, shoqëruar me flet hyrjen nr. 136 datë 20.04.2017 nënshkruar nga përgjegjsja e farmacisë znj. R. P.

Referuar procesverbalit të kolaudit dhe marrjes në dorzim datë 20.04.2017 për faturën nr. 8554 datë 20.04.2017 të hartuar nga komisioni i përbëra nga znj. R. P., znj. A. N., znj. Z. N., z. K. N. dhe znj. E. D. u konstatua se është pranuar një artikuj barna Ceftazidime me datë skadence Shkurt 2018, barna të cilat nuk duheshin pranuar nga komisioni i kolaudit dhe marrjes dorzim duke respektuar një afat minimal skadence prej 12 muajsh pa llogaritur kushtet e ruajtjes se medikamenteve në farmacinë e sptalit që zvoglojnë jetgjatësinë e tyre.

Medikamenti	Dt. Furnizimit	Dt. skadencës	Af. mujor	Vlera
Ceftazidime 1gram	20.04.2017	20.02.2018	10	133,200

Pranimi i barnave jo në përputhje me kushtet e kontratës ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit kolaudit dhe marrjes në dorzim.

10-Me urdhër shpenzimin nr. 207 datë 25.04.2017 me vlerë 1,079,280 është likujduar fatura nr. 4726 datë 16.03.2017 me vlerë 101,280 lekë shoqëruar me flet hyrjen nr. 105 datë 16.03.2017, fatura nr. 8252 datë 30.03.2017 me vlerë 42,400 lekë shoqëruar me flet hyrjen nr. 117 datë 30.03.2017, fatura nr. 8260 datë 03.04.2017 me vlerë 214,800 lekë shoqëruar me flet hyrjen nr. 119 datë 03.04.2017, fatura nr. 8769 datë 20.04.2017 me vlerë 720,800 lekë shoqëruar me flet hyrjen nr. 1345 datë 20.04.2017

Referuar nenit 3 Afati i zbatimit të kontratës do të jetë deri më 31.03.2017.

Në nenin 5 Kushtet e pagesës kemi të shprehur: *Për kontrata me periudhë zabtimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.*

Afati maksimal i furnizimit të gjithë mallit është datë 31.03.2017, deri më këtë datë operatori ekonomik ka furnizuar vetëm 1,577,060 lekë ose 91% të vlerës.

Për furnizimin e datës 20.4.2017 sipas flethyrjes autoriteti kontraktorë duhet ti llogariste penaltetin 430,185 (25% i kontratës) x 2/1000 x 20 ditë = **17,207 lekë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit i pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik “F.” SHPK.**

-Urdhër shpenzimi nr. 445 datë 12.10.2017 me vlerë 266,400 lekë me faturë furnizimi nr. 5927 datë 19.09.2017 shoqëruar me flet hyrjen nr. 257 datë 19.09.2017 të kontratës nr. 634 me vlerë 1,197,900 lekë me operatorit ekonomik “F.” nga ku nuk u konstuan problematika.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

-Urdhër shpenzimi nr. 492 datë 09.11.2017 me vlerë 79,100 lekë me faturë furnizimi nr. 6967 datë 25.10.2017 shoqëruar me flet hyrjen nr. 267 datë 25.10.2017 të kontratës nr. 634 me vlerë 1,197,900 lekë me operatorit ekonomik "F." nga ku nuk u konstauan problematika.

11-Nga auditimi i procedurës së prokurimit 'B3 - Blerje barna sistemi anti-infektiv të përgjithshme, antineoplastik dhe immunomodulare, antiparazitare dhe dermatologjike për nevoja spitalore, ndarë në lotë' me nr. REF-Nr 88 prot., datë 17.02.2017 me operator fitues ""F." dhe vlerë kontrate 1,378,000 lekë me afat zbatimi kontrate deri më 15.12.2017, nuk u konstatuan u konstatua se: nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar afatet e furnizimit sipas kushteve të kontratës ku nën nenin 3 citohet: *Sasia e lëvrimit do të jetë 20% muajin e parë, 20% në muajin e dytë, 10 % në muajin e tretë, 10% në të katërtin dhe pjesa tjetër deri më 15.12.2017, sipas kërkesave të institucionit.* Nga ana e operatorit ekonomik është furnizuar e gjithë sasia e mallit në 2 muaj e parë duke sjellë një menaxhim jo të mirë në afatin e sakadencave të medikamentet, duke qenë se afati i skadimit duhet të jetë jo më vogël se 12 muaj nga data e furnizimit.

12-Nga auditimi i procedurës së prokurimit 'B9 - Blerje barna anti-infektiv të përgjithshme, për nevoja spitalore, ndarë në lotë' me nr. REF-Nr 118 prot., datë 02.02.2017 me operator fitues "M." dhe vlerë kontrate 1,506,000 lekë me afat zbatimi kontrate deri më 15.12.2017, nuk u konstatuan u konstatua se: nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar afatet e furnizimit sipas kushteve të kontratës ku nën nenin 3 citohet: *Sasia e lëvrimit do të jetë 20% muajin e parë, 20% në muajin e dytë, 10 % në muajin e tretë, 10% në të katërtin dhe pjesa tjetër deri më 15.12.2017, sipas kërkesave të institucionit.* Nga ana e operatorit ekonomik është furnizuar e gjithë sasia e mallit në 2 muaj e parë duke sjellë një menaxhim jo të mirë në afatin e sakadencave të medikamentet, duke qenë se afati i skadimit duhet të jetë jo më vogël se 12 muaj nga data e furnizimit.

VITI 2018

13-Nga auditimi i procedurës së prokurimit 'Blerje barna Antineoplastik dhe immunomodulare, hormonale, sistematike, hormone seksuale dhe gjaku dhe organet formuese të gjakut, e ndarë në lotë' marrëveshje kuadër. REF-Nr 122 prot., datë 02.02.2018 me operator fitues "A." SHPK dhe vlerë kontrate 2,046,465 lekë nr. 522 prot., datë 10.05.2018 me afat zbatimi kontrate deri 4 muaj nga nënshkrimi i saj u konstatua se:

Me urdhër shpenzimin nr. 253 datë 07.06.2018 me vlerë 2,045,115 lekë është likujduar fatura tatimore nr. 82078 datë 10.05.2018 me vlerë 307,250 lekë shoqëruar me flet hyrjen nr. 110 datë 10.05.2017. fatura tatimore nr. 85503 datë 15.05.2018, me vlerë 1,737,684 lekë shoqëruar me flet hyrjen nr.129 datë 15.05.2018 Nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar afati i furnizimit me medikamente, pasi furnizimi i fundit i tij ka ardhur më 14.12.2018 duke e tejkaluar afatin maksimal të lëvrimit me 4 muaj ditë.

Referuar nenit 3 Afati i zbatimit të kontratës do të jetë deri në 4 muaj nga nënshkrimi i saj.

Nënshkrimi i kontratës mban datën 15.05.2018 , afati maskimal për furnizim plotësohet më 15.09.2018.

Në nenin 5 Kushtet e pagesës kemi të shprehur: *Për kontrata me periudhë zabtimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.*

Afati maksimal i furnizimit të gjithë mallit është datë 15.09.2019, deri më këtë datë operatori ekonomik nuk e ka respektuar afatin pasi furnizimi i fundit i tij mban datë 14.12.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Për furnizimin e datës 14.12.2018 sipas flethyrjes autoriteti kontraktorë duhet ti llogariste penalitetin 511,616 (25% i kontratës) x 4/1000 x 89 ditë = **182,135 lekë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit i pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik "A." SHPK.**

14-Nga auditimi i procedurës së prokurimit 'Blerje barna Anti infektive të përgjithshëm' marrëveshje kuadër. REF-Nr 118 prot., datë 02.02.2018 me operator fitues "M." SHPK dhe vlerë kontrate 1,506,000 lekë nr. 541 prot., datë 14.05.2018 me afat zbatimi kontrate deri 4 muaj nga nënshkrimi i saj, nuk u konsataun problematika, furnizimi është kryer me faturën tatimore nr. 25392 datë 14.05.2018 me vlerë 1,506,000 dhe fletë hyrje nr. 124 datë 14.05.2018 si dhe likujduar me urdhër shpenzimi nr. 282 datë 20.06.2018 me vlerë 1,506,000 lekë.

15-Nga auditimi i procedurës së prokurimit 'Blerje barna gjaku dhe organet formuese të gjakut' marrëveshje kuadër. REF-Nr 119 prot., datë 02.02.2018 me operator fitues "A." SHPK dhe vlerë kontrate 1,452,590 lekë nr. 544 prot., datë 15.05.2018 me afat zbatimi kontrate deri 4 muaj nga nënshkrimi i saj, nuk u konsataun problematika, furnizimi është kryer me faturën tatimore nr. 85506 datë 15.05.2018 me vlerë 1,452,592 dhe fletë hyrje nr. 131 datë 15.05.2018 si dhe likujduar me urdhër shpenzimi nr. 269 datë 13.06.2018 me vlerë 1,452,590 lekë.

16-Nga auditimi i procedurës së prokurimit 'Blerje barna, Anti-infektive të përgjithshëm' marrëveshje kuadër. REF-Nr 118 prot., datë 02.02.2018 me operator fitues "C. P. & T." SHPK dhe vlerë kontrate 2,427,500 lekë nr. 535 prot., datë 11.05.2018 me afat zbatimi kontrate deri 4 muaj nga nënshkrimi i saj, nuk u konsataun problematika, furnizimi është kryer me faturën tatimore nr. 114662 datë 11.05.2018 me vlerë 1,699,250 dhe fletë hyrje nr. 117 datë 11.05.2018 si dhe likujduar me urdhër shpenzimi nr. 269 datë 20.06.2018 me vlerë 1,699,250 lekë. Urdhër shpenzimi nr. 387 datë 26.07.2018 me vlerë 728,250 lekë, Furnizuar me faturë nr. 257409552 datë 22.06.2018 me vlerë 128,250 lekë dhe faturën nr. 257409551 datë 22.06.2018 me vlerë 600,000 lekë.

17-Nga auditimi i procedurës së prokurimit 'Blerje Materiale mjekimi MM3' marrëveshje kuadër. REF-Nr 118 prot., datë 02.02.2018 me operator fitues "O. D." dhe vlerë kontrate 2,004,979 lekë me TVSH nr. 617 prot., datë 24.05.2018 me afat zbatimi kontrate deri 4 muaj nga nënshkrimi i saj, nuk u konsataun problematika, furnizimi është kryer me faturën tatimore nr. 225933297 datë 01.06.2018 me vlerë 1,163,794 dhe fletë hyrje nr. 178 datë 01.06.2018 si dhe likujduar me urdhër shpenzimi nr. 316 datë 27.06.2018 me vlerë 1,163,795 lekë. Urdhër shpenzimi nr. 427 datë 17.08.2018 me vlerë 561,388 lekë, Furnizuar me faturë nr. 225933712 datë 18.07.2018 me vlerë 561,387.7 lekë dhe fletë hyrje nr. 233 datë 18.07.2018. Urdhër shpenzimi nr. 462 datë 20.09.2018 me vlerë 279,796 lekë, Furnizuar me faturë nr. 225933837 datë 08.08.2018 me vlerë 218,712 lekë dhe fletë hyrje nr. 244 datë 08.08.2018, dhe faturë nr. 225933966 datë 30.08.2018 me vlerë 61,084.8 lekë dhe fletë hyrje nr. 267 datë 30.08.2018.

18-Nga auditimi i procedurës së prokurimit 'Blerje Materiale mjekimi MM4' marrëveshje kuadër. REF-Nr 118 prot., datë 02.02.2018 me operator fitues "O. D." dhe vlerë kontrate 864,049 lekë me TVSH nr. 618 prot., datë 24.05.2018 me afat zbatimi kontrate deri 4 muaj nga nënshkrimi i saj, nuk u konsataun problematika, furnizimi është kryer me faturën tatimore nr. 225933605 datë 05.07.2018 me vlerë 152,064 dhe fletë hyrje nr. 221 datë 05.07.2018 si dhe likujduar me urdhër shpenzimi nr. 367 datë 16.07.2018 me vlerë 152,064 lekë. Urdhër shpenzimi nr. 426 datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

17.08.2018 me vlerë 582,049 lekë, Furnizuar me faturë nr. 225933713 datë 18.07.2018 me vlerë 582,049 lekë dhe fletë hyrje nr. 232 datë 18.07.2018.

19-Në procedurën e prokurimit marveshje kuadër “Shërbimi i lavanterisë dhe hotelirisë Spitali Korçë” me vlerë to kontratës 73,771,765 lekë për 4 vite ose 18,442,940 lekë në vit të fituar nga operatori i vetëm pjesmarrës “G. K.” SHPK u konstatuan se nga furnizimi me materiale të imta për SRK nga ana e operatorit ekonomik nuk janë respektuar specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratën, nga verifikimi i furnizimeve pranuar me fletë hyrjet përkatës dhe marrë në dorzim nga grupi i punës u konstatuan një sasi malli (produkte të buta) në **vlerën 579,120 lekë e e cila është furnizuar në kundërshtim me kushtet e kontratës **dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.****

-Furnizimi datë 05.11.2018 sipas fletë hyrjes nr 7 datë 05.11.2018 zëri 2-Batanije sasia 57 copë me vlerë 123,120 lekë, ky produkt nuk i përmbush specifikimet teknike 60% lesh, 40% akrilik, por sipas ambllazhit ajo është 100% akrilik dhe me përmasa 160x220 ndryshe nga çka është kërkuar 240x170 cm, edhe pse me këto ndryshime është pranuar nga autoriteti kontraktorë.

-Furnizimi datë 05.11.2018 sipas fletë hyrjes nr 7 datë 05.11.2018 zëri 1-Çarçaf mono 200 copë me vlerë 236,000 lekë, pa asnjë të dhënë teknike për sa i përket materilait që duhet të jetë 100% pambuk, edhe pse i tillë është pranuar nga autoriteti.

-Furnizimi datë 04.12.2018 sipas fletë hyrjes nr 10 datë 04.12.2018 zëri 3-Çarçaf 121 copë me vlerë 133,100 lekë, pa asnjë të dhënë teknike për sa i përket materilait që duhet të jetë 100% pambuk, edhe pse i tillë është pranuar nga autoriteti.

-Furnizimi datë 26.12.2018 sipas fletë hyrjes nr 25 datë 26.12.2018 zëri 1-Çarçaf 79 copë me vlerë 86,900 lekë, pa asnjë të dhënë teknike për sa i përket materilait që duhet të jetë 100% pambuk, edhe pse i tillë është pranuar nga autoriteti.

Për sa më sipër mban përgjegjësi grupi i pranimit dhe marrjes në dorzim të mallit.

19-Në procedurën e prokurimit me objekt: “Largim, përpunim i mbeturinave dhe pastrim i territorit nga dëbora, Spitali Korçë”, periudha 2017, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër Prokurimi i titullarit të autoritetit kontraktor Nr. 321 Prot., datë 13.02.2017.	A. L. kryetar A. D. anëtare E. M. anëtare	B. H. kryetar E. R. anëtar E. B. anëtare
Vlera e përllogaritur e kontratës: 913,213 lekë pa TVSH.		
Lloji i procedurës: Kërkesë për propozim		
Operatori ekonomik fitues “K.” SHPK Vlera e ofertës 912,000 lekë pa TVSH. Ulja nga fondi limit: 1,213 lekë pa TVSH.		
Kontrata Nr. 455 Prot., datë 08.03.2017, vlera 1,094,400 lekë me TVSH.		
Raporti përmbljedhës i hartuar nga KVO, Nr. extra Prot., datë 06.03.2017.	Formulari i sigurimit të kontratës lëshuar datë 07.03.2017.	Tenderi i zhvilluar më datë: 27.02.2017.
Titullari i AK: E. B.	Formulari i publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar Nr. 441 Prot., datë 06.03.2017.	Kualifikuar 1 OE. Pjesëmarrës 1 OE.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Kanë marrë pjesë në tender: Shoqëria “K.” SHPK me ofertë 912,000 lekë pa TVSH; kualifikuar.	Njoftimi i klasifikimit datë 06.03.2017.	Njoftim i kontratës së nënshkruar: Publikuar në Buletin e Njoftimeve Publike Nr10, datë 13.03.2017
---	---	--

Me shkresën nr. 315 datë 09.02.2017, titullari i AK znj. E. B. ka ngritur grupin e punës të përbërë nga znj. K. B., znj. M. L. dhe znj. Zh. T., për përcaktimin e fondit limit për evadimin e mbetjeve urbane për vitin 2017, brenda datës 13.02.2017.

Grupi i punës pasi u njoh me përlllogaritjen paraprake të sasive të mbetjeve urbane që prodhohen gjatë vitit, të përpiluara nga krye/infermieri z. G. N., duke rezultuar rreth 200 ton, nga të cilat 60 ton pas procesit të hidroklovizimit, si dhe faktin që spitali ka dy vendgrupime mbetjesh urbane me 5 kontenjerë metalikë, (3 pranë bllokut spitalor dhe 2 pranë Maternitetit dhe Poliklinikës), si dhe kontenjerë plastikë për mbetje e riciklueshme.

Grupi i punës është shprehur se janë mbështetur në metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së shërbimit të pastrimit publik të Bashkisë Korçë.

Përlllogaritjet e grupit të punës janë bazuar në orët e punës të nevojshme për kryerjen e operacioneve. Grupi i punës ka llogaritur shpenzimet për 5 punonjës, një shofer dhe katër punëtorë, duke u shtuar sigurimet shoqërore si dhe shtesën për punë natën, shpenzime karburanti, mirëmbajtje mjetesh, uniforma, doreza për punëtorët, shpenzime administrative etj, dhe ka përcaktuar se për zbrazjen dhe klorifikimin e pesë kontenjerëve duhen katër punëtorë me një kohë pune prej 2.5 orësh në ditë.

Megjithëse grupi i punës në relacion është shprehur se është mbështetur në metodologjinë e përdorur nga Bashkia Korçë, nuk e ka argumentuar dhe dokumentuar kohën e punës për ngarkimin dhe klorifikimin e kontenjerëve. Mënyra e llogaritjes me kohë pune nuk është në përputhje dhe me njësinë e matjes së sasisë së mbetjeve e llogaritur nga krye/infermieri, që është në kg për pavione.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “K.” SHPK, për eksperiencat e ngjashme të shërbimit, ishte dhe kontrata e lidhur me 27.02.2012 e Korsel shpk me Bashkinë Korçë për largimin dhe trajtimin e mbetjeve. Në këtë kontratë kostot e largimit e përpunimit të mbetjeve ishin llogaritur me ton dhe jo me orë pune.

Lidhur me llogaritjen e kostos së largimit dhe përpunimit të mbetjeve, komisioni nuk ka argumentuar arsyen e largimit të mbetjeve gjatë orëve të natës duke llogaritur dhe pagën shtesë si dhe arsyen për pasjen e 4 punonjësve, dy për ngarkim-shkarkim dhe dy për klorifikimin, kur normalisht procesi i klorifikimit do të kryhet pas shkarkimit të 5 kontenjerëve, pra dy punonjësve do tu duhej të prisnin, duke pasur parasysh që dhe koha e punës e përlllogaritur për kryerjen e punës është 2.5 orë.

Duke zbritur pagat e dy punonjësve si dhe shtesat e pagave për punën natën vlera 489.200 lekë me TVSH përbën shpenzime ekonomike jo të argumentuara.

Vlerësimet e mësipërme janë kryer duke mos u mbështetur në asnjë evidencë të matshme dhe të kontrollueshme.

Gjithashtu, sqaruar sa më sipër, **AK nuk argumenton lidhur me sasinë e prokuruar, duke vërtetuar mbi parregullshmërinë e ndjekur, për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, si dhe mos përfshirjen e sasisë së mbetjeve në procesin e përlllogaritjes.**

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrin të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”.

Neni 59 i VKM së mësipërme parashikon se: “Përlllogaritja e vlerësimit të kontratës bëhet nga njësisia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.

2. Në përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës”.

Pika 2 e nenit 57 të VKM së mësipërme, parashikon se:

“Njësisia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);
- përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
- hartimin e urdhrin të prokurimit;
- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
- hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
- administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;
- llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti”.

Veprimet e mësipërme kanë shkaktuar shpenzime jo të justifikuar në vlerën 489.200 lek me TVSH.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të përlllogaritjes së fondit limit.

Specifikimet teknike

Njësisia e prokurimit nuk ka kërkuar për OE, të disponojë licensat e duhura për transportin e mbetjeve urbane si dhe kontratën me landfilllet përkatëse për shkarkimin e tyre në kundërshtim me Ligjin nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar neni 57, ku citohet “Transportuesit e mbetjeve, 1. Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve. 2. Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", pas miratimit të saj nga ministri".

Në DST në Kriteret e veçanta të kualifikimit nga njësia e prokurimit është kërkuar që "Perpunimi i mbetjeve do të bëhet në vend depozitimit e caktuar për trajtimin e mbetjeve spitalore brenda landfill-it, nga firma që do të shpallet fituese."

Ky specifikim teknik është konfuz dhe jo i saktë pasi AK po prokuron largimin e mbetjeve urbane. Njësia e prokurimit në kërkesën për ofertë nuk ka paraqitur asnjë masë sasive për largimin e mbetjeve urbane, kur fillimisht është filluar me një vlerësim prej 200 ton në vit, më pas duke vijuar me komisionin e llogaritjes së fondit limit i cili e ka nxjerrë vlerën bazuar në orë pune (2.5 orë).

Në kapacitet teknike është kërkuar: "3-Të ketë në pronësi ose me qera mjet Teknologjik për largimin e mbeturinave nga kontinieret. 4-Të ketë kontratë me fushën e grumbullimit për hedhjen e mbeturinave spitalore. 5-Të ketë në pronësi apo me qera automjet për pastrimin e dëborës."

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 9 të DST duhet të shoqërohej me dokumentat e mëposhtme:

1. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor); b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS); ç) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit; d) leje transporti nga njësia vendore d. Kur janë me qera, duhet të paraqitet: a) kontrata e qerasë; b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS); ç) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit; d) leje transporti nga njësia vendore

2. Për mjetin, bore pastruese duhet të jetë i kompletuar me paisjet e pastrimit të borës dhe shpërndarjes së kripës, të shoqërohet me dy foto perkatëse, në pjesën e përparme dhe të pasme, në mënyrë që të dallohet qartë targa e mjetit, për këtë mjet duhet të jetë e cilësuar në lejen e qarkullimit "APV".

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit i përbërë nga z. B. H., z. Z. E. R. anëtar dhe znj. E. B. anëtare.

-Në përgjigje të kërkesës së përgjegjëses së Sektorit të Ambientit, znj. E. B. dhe K/Infiermieri të Përgjithshëm z. G. N., datë 19.01.2018, për fillimin e procedurave të prokurimit të shërbimit të largimit të mbetjeve urbane, më datë 23.01.2018, me shkresën nr. 138 prot., drejtori z. A. K., ka ngritur grupin e punës për llogaritjen e fondit limit, me anëtarë znj. E. B., znj. Zh. T. dhe znj. L. P., me afat deri më 29.01.2018.

Në relacionin e përgatitur nga grupi i punës, rezultojnë rreth 200 ton mbetje urbane, nga të cilat 15 ton pas procesit të hidrokлавizimit dhe të tjerat mbetje urbane, të 5 kontenjerëve metalikë dhe 3 kontenjerë plastikë për mbetjet e riciklueshme.

Grupi i punës është shprehur se janë mbështetur në metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së shërbimit të pastrimit publik të Bashkisë Korçë.

Përlllogaritjet e grupit të punës janë bazuar në orët e punës të nevojshme për kryerjen e operacioneve. Grupi i punës ka llogaritur shpenzimet për 5 punonjës, një shofer dhe katër punëtorë, duke u shtuar sigurimet shoqërore si dhe shtesën për punë natën, shpenzime karburanti, mirëmbajtje mjetesh, uniforma, doreza për punëtorët, shpenzime administrative etj, dhe ka përcaktuar se për zbrazjen dhe klorifikimin e pesë kontenjerëve duhen katër punëtorë me një kohë pune prej 2.5 orësh në ditë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Megjithëse grupi i punës në relacion është shprehur se është mbështetur në metodologjinë e përdorur nga Bashkia Korçë, nuk e ka argumentuar dhe dokumentuar kohën e punës për ngarkimin dhe klorifikimin e konternierëve. Mënyra e llogaritjes me kohë pune nuk është në përputhje dhe me njësinë e matjes së sasisë së mbetjeve e llogaritur nga krye/infirmieri, që është në kg për pavione. Lidhur me llogaritjen e kostos së largimit dhe përpunimit të mbetjeve, komisioni nuk ka argumentuar arsyen e largimit të mbetjeve gjatë orëve të natës duke llogaritur dhe pagën shtesë si dhe arsyen për pasjen e 4 punonjësve, dy për ngarkim-shkarkim dhe dy për klorifikimin, kur normalisht procesi i klorifikimit do të kryhet pas shkarkimit të 5 kontenierëve, pra dy punonjësve do tu duhej të prisnin, duke pasur parasysh që dhe koha e punës e përlllogaritur për kryerjen e punës është 2.5 orë.

Duke zbritur pagat e dy punonjësve si dhe shtesat e pagave për punën natën vlera **633,800** lekë me TVSH përbën shpenzime ekonomike jo të argumentuara.

Vlerësimet e mësipërme janë kryer duke mos u mbështetur në asnjë evidencë të matshme dhe të kontrollueshme.

Gjithashtu, sqaruar sa më sipër, **AK nuk argumenton lidhur me sasinë e prokuruar, duke vërtetuar mbi parregullshmërinë e ndjekur, për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, si dhe mos përfshirjen e sasisë së mbetjeve në procesin e përlllogaritjes.**

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikon se: "***Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit***".

Neni 59 i VKM së mësipërme parashikon se: "***Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.***

2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës".

Pika 2 e nenit 57 të VKM së mësipërme, parashikon se:

"Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;***
- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);***
- përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;***
- hartimin e urdhrat të prokurimit;***



KONTROLI I LARTË I SHITETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
- hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
- administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;
- llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti”.

Veprimet e mësipërme kanë shkaktuar shpenzime jo të justifikuara në vlerën 633,800 lek me TVSH.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të përlllogaritjes së fondit limit.

Me shkresën nr. 228 prot., datë 08.02.2018, titullari i AK ka urdhëruar prokurimin e fondit limit prej 1,137,010 lekë, pa TVSH, me objekt “Largim dhe përpunim i mbeturinave dhe pastrim i territorit nga dëbora, Spitali Korçë”.

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër Prokurimi i titullarit të autoritetit kontraktor Nr. 228 Prot., datë 08.02.2018.	A. L. kryetar A. D. anëtare E. M. anëtare	B. H. kryetar E. R. anëtar E. B. anëtare
Vlera e përlllogaritur e kontratës: 1,132,000 lekë pa TVSH.		
Lloji i procedurës: Kërkesë për propozim		
Operatori ekonomik fitues “K.” SHPK Vlera e ofertës 1,132,000 lekë pa TVSH. Ulja nga fondi limit: 5,010 lekë pa TVSH.		
Kontrata Nr. 350 Prot., datë 08.03.2018, vlera 1,358,400 lekë me TVSH.		
Raporti përmbledhës i hartuar nga KVO, Nr. extra Prot., datë 05.03.2018.	Formulari i sigurimit të kontratës lëshuar datë 07.03.2018.	Tenderi i zhvilluar më datë: 22.02.2018.
Titullari i AK: A. K.		Kualifikuar 1 OE. Pjesëmarrës 1 OE.
Kanë marrë pjesë në tender: Shoqëria “K.” SHPK me ofertë 1,132,000 lekë pa TVSH; kualifikuar.		Njoftim i kontratës së nënshkruar: Publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr10, datë 12.03.2018

Në përgjigje të observacionit dërguar nga subjekti, në lidhje me akt konstatimin e KLSH-së, nuk është sjellë asnjë dokumentacion ose argumentim shtesë i cili nuk është trajtuar më sipër.

Në lidhje sa më sipër, ju bëjmë me dije që nuk merret në konsideratë pasi nuk është paraqitur asnjë element i ri, i pa trajtuar në akt konstatimin e lënë pranë jush.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

19-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”-Janar 2017.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1.Urdhër Prokurimi nr. 61 prot.datë 15.01.2018 z. A. K.	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 69, datë 02.11.2017 B. H. Gj. G. E. R.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1167, datë 02.11.2017 A. L. Kryetar A. D. E. M.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7,336,000lekë pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) “I.” SHPK 7,322,000lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 14,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 13.11.2017 Ora 10:00	9.Burimi Financimit Fondet e SDKSH	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 2 O.E. b)S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b.Zbatimi i Kontratës me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”		
14.Lidhja e kontratës Nr.1212 prot., datë 24.11.2017	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 8,786,400lekë	16.Likuiduar 8,786,400

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nisja e procedurës ka ardhur nga kërkesa e z. E. R. përgjegjës i sektorit teknik ku cilësohet se për periudhën tetor –dhjetor 2017 nevoiten 140,000 kg pellet.

Në iniciimin e kësaj procedurë autoriteti kontraktorë ka ngritur komisionin për përllogaritjen e fondit limit të përbërë nga, z. E. R., znj. Zh. T. dhe z. L. P. Fondin limit për këtë procedurë është kompleks duke përfshirë dhe huapërdorjen e kaldajës së sipërmarrësit, autoriteti kontraktorë nuk është shprehur por i ka ngarkuar në cmimin për kg të pelletit edhe pse janë dy procese krejt të kundërta, njëra është pajisje furnizim vendosje me huapërdorimi dhe tjetra është mall konsumi.

Hartimi i specifikimeve teknike për kaldajën dhe brucatorin dhe lëndën djegëse Pellet janë hartuar nga z. B. H., z. Gj. G. dhe z. E. R.. Janë hartuar specifikimet teknike për lëndën djegëse “Pellet” **si dhe specifikimet teknike për kaldajën** e cila do të ofrohet nga operatori fitues i kësaj procedure.Nga verifikimi i këtyre specifikimeve u konstatua se:

Specifikimet teknike të hartuara nga NJP për kaldajën dhe Brucatorët janë hartuar jo në përputhje me nenin 23 “specifikimet teknike” të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj.

Hartimi i këtyre specifikimeve ka bërë që të ngushtohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomik në këtë procedurë nga specifikimet teknike për kaldajën dhe brucatorët që do ofrohen, disa nga elementet e specifikuara kufizojnë konkurrencën në pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë dhe orientojnë tregun dhe autoritetin kontraktorë tek operatori fitues “I.” SHPK janë: dimensione në një ekzaktësi fikse në mm, L= 2750 mm, Gjatësi= 2180 mm, Gjërësi= 1720 mm si dhe peshën ekzakte në kg= 1855 kg. Është e pamundur të gjindet një kaldajë tjetër e ngjashme me këto të dhëna, kjo vihet re dhe në operatorët pjesëmarrës si dhe ato fitues që është vetëm një.

Për hartimin e specifikimeve teknike jo në përputhje me nenin 23 të ligjit 9643 datë datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj, me pasojë kufizimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

e konkurrencës dhe orientimin apo paracaktimin e operatorit fitues ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga z. B. H., z. Gj. G. dhe z. E. R. për hartimin dhe miratimin e këtyre specifikimeve në DST e procedurës.

-Drejtori i Spitalit z. A. K. ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 69 datë 02.11.2017 për procedurën e prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 7,336,000 lekë pa TVSH si dhe ka krujaur Njësinë e prokurimit të përbërë nga: z. B. H., z. Gj. G. dhe z. E. R.

-Me shkresën nr. 1167 prot., datë 02.11.2017 titullari i AK ka nxjerrë urdhërin dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga: z. A. L. kryetarë, znj. A. D. dhe znj. E. M. anëtare.

-AK ka nxjerrë Formualrin e Njoftimit të Kontratës për procedurën e prokurimit Kërkesë për propozim “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 7,336,000 lekë pa TVSH datë zhvillimi tenderi 13.11.2017 ora 10:00.

-Me datë 03.11.2017 Njësia e prokurimit dhe Tirullari i autirtetit kontraktorë kanë përzgjedhur dhe miratur operatorët ekonomik që do ftohen për pjesmarrje minimalisht 5 sipas kërkesave të ligjit si më poshtë:

1. “A. ”.
2. “A. ”.
3. “N. M.”.
4. “E. M.”.
5. “I. ”.

-Sipas procesverbalit datë 13/11/2017 për hapjen e ofertave vlerësimin e procedurës së prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 7,336,000 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 2 operatorë ekonomik:

1-Operatori ekonomik “S.” me ofertë ekonomike 6,146,000 lekë.

2-Operatori ekonomik “I” SHPK me ofertë ekonomike 7,322,000 lekë.

-Sipas procesverbalit datë 14/11/2017 për vlerësimin e ofertave procedurës së prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 7,336,000 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 2 operatorë dhe u kualifikua 1 operatorë ekonomik me ofertë 7,322,000 lekë.

Me shkresën datë 22.11.2017 nga komisioni i vlerësimit të ofertave është hartuar Relacioni përmbledhës i cili është nënshkruar dhe nga Njësia e prokurimit por nuk është nënshkruar dhe miratur nga titullari në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Me shkresën nr. 1206 datë 22.11.2017 titullari i autoritetit kontraktorë z. A. K. ka miratur procedurën e prokurimit shpalluar fitues operatorin ekonomik “I.” SHPK si oferta e vetme e vlefshme me vlerë 7,322,000 lekë.

Nga AK është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP.

a. Me operatorin ekonomik fitues është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 1212 prot., datë 24.11.2017, me vlerë 7,322,000lekë pa TVSH (8,786,400 lekë me TVSH), me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2017. Kjo kontratë është nënshkruar nga drejtori i spitalit Korçë Agron Kurro dhe nga operatorin ekonomik “I.” SHPK përfaqësuar nga z. K. M.

Nga ana e drejtorit të institucionit nuk është ngritur grup për mbikqyrjen e kontratës së lidhur dhe marrjen në dorzim të kaldajës dhe pelletit të furnizuar dukë vënë në rrezik realizimin e saj me sukses në kohë e cilësinë kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX, “Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës” neni 77, gjithashtu në përfundim të kontratës autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX neni 77, pika 1. Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish drejtorin z. A. K.

-Nga verifikimi fizik i kaldajës u konsatua se: kaldajës i mungon targeti i të dhënave i cili duhet të ishte i stampuar në trupit e kaldajës në pllaket metalike për të dëshmuar përmbajtjen e specifikimeve sipas kësaj procedure si dhe kjo kaldajë e instaluar dhe e marrë në dorzim nga drejtori i spitalit pasi nuk ka ngritur grup marrje në dorzim pa plotësuar asnjë nga dimensionet sipas specifikimeve teknike të kërkuar nga autoriteti kontraktorë dhe të kualifikuar nga ky i fundit ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin z. A. K.

Ngan auditimi i zbatimit të kontratës dhe nga verifikimi i furnizimeve u konstatua se pelleti i furnizuar nuk është sipas specifikimeve teknike të kërkuar.

20-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”- Janar 20018.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1.Urdhër Prokurimi nr. 125 prot.datë 12.01.2018 z.A. K.	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 1, datë 22.01.2018 B. H.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 126,datë 22.01.2018 A. L. Kryetar A. D. E. M.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur”	Gj. G. E. R	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 17,259,000lekë pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) “IGMA” sh.p.k 17,193,000 lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 66,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 15.03.2018 Ora 10:00	9.Burimi Financimit Fondet e SDKSH	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 2 O.E. b)S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b.Zbatimi i Kontratës me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”		
14.Lidhja e kontratës Nr.451 prot., datë 17.04.2018	15.Vlera e kontratës (me tvsh)	16.Likuiduar

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nisja e procedurës ka ardhur nga kërkesa e z. E. R. datë 15.01.2018 përgjegjës i sektorit teknik për nevojën për blerje pelleti për ngrohjet.

Në iniciimin e kësaj procedurë autoriteti kontraktorë ka ngritur komisionin për përlllogaritjen e fondit limit të përbërë nga, z. E. R., znj. Zh. T. dhe znj. L. P. Fondin limit për këtë procedurë është kompleks duke përfshirë dhe huapërdorjen e kaldajës së sipërmarrësit, autoriteti kontraktorë nuk është shprehur por i ka ngarkuar në cmimin për kg të pelletit edhe pse janë dy procese krejt të kundërta, njëra është pajisje furnizim vendosje me huapërdorimi dhe tjetra është mall konsumi.

Hartimi i specifikimeve teknike në procesverbalin datë 22.01.2018 për kaldajën dhe brucatorin dhe lëndën djegëse Pellet janë hartuar nga z. B. H., z. Gj. G. dhe z. E. R. Janë hartuar specifikimet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

teknike për lëndën djegëse "Pellet" si dhe specifikimet teknike për kaldajën e cila do të ofrohet nga operatori fitues i kësaj procedure. Nga verifikimi i këtyre specifikimeve u konstatua se:

Specifikimet teknike të hartuara nga NJP për kaldajën dhe Brucatorët janë hartuar jo në përputhje me nenin 23 "specifikimet teknike" të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj.

Hartimi i këtyre specifikimeve ka bërë që të ngushtohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomik në këtë procedurë nga specifikimet teknike për kaldajën dhe brucatorët që do ofrohen, disa nga elementet e specifikuara kufizojnë konkurrencën në pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë dhe orientojnë tregun dhe autoritetin kontraktorë tek operatori fitues "I." SHPK janë: dimensione në një ekzaktësi fikse në mm, L= 2750 mm, Gjatësi= 2180 mm, Gjërësi= 1720 mm si dhe peshën ekzakte në kg= 1855 kg. Është e pamundur të gjindet një kaldajë tjetër e ngjashme me këto të dhëna, kjo vihet re dhe në operatorët pjesëmarrës si dhe ato fitues që është vetëm një.

Për hartimin e specifikimeve teknike jo në përputhje me nenin 23 të ligjit 9643 datë datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj, me pasojë kufizimin e konkurrencës dhe orientimin apo paracaktimin e operatorit fitues ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga z. B. H., z. Gj. G. dhe z. E. R. për hartimin dhe miratimin e këtyre specifikimeve në DST e procedurës.

-Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 1 datë 22.01.2018 për procedurën e prokurimit "Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje" me fond limit 17,259,000 lekë pa TVSH si dhe ka krujaur Njësinë e prokurimit të përbërë nga: z. B. H., z. Gj. G. dhe z. E. R..

-Me shkresën nr. 126 prot., datë 22.01.2018 titullari i AK ka nxjerrë urdhërin dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga: z. A. L. kryetarë, znj. A. D. dhe znj. E. M. anëtare.

-Sipas procesverbalit datë 20/03/2018 për hapjen e ofertave vlerësimin e procedurës së prokurimit "Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje" me fond limit 17,259,000 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 2 operatorë ekonomik:

1-Operatori ekonomik "S." pa ofertë.

2-Operatori ekonomik "I." SHPK me ofertë ekonomike 17,193,000 lekë.

-Sipas procesverbalit datë 23/03/2018 për vlerësimin e ofertave procedurës së prokurimit "Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje" me fond limit 17,259,000 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 2 operatorë dhe u kualifikua 1 operatorë ekonomik me ofertë 17,193,000 lekë.

-Me shkresën datë 03.04.2018 nga komisioni i vlerësimit të ofertave është hartuar Relacioni përmbledhës i cili është nënshkruar dhe nga Njësia e prokurimit por nuk është nënshkruar dhe miratur nga titullari në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Me shkresën nr. 417 datë 03.04.2018 titullari i autoritetit kontraktorë z. A. K. ka miratur procedurën e prokurimit shpalluar fitues operatorin ekonomik "I." SHPK si oferta e vetme e vlefshme me vlerë 17,193,000 lekë.

Nga AK është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP nr. 416 prot., datë 03.04.2018.

a. Me operatorin ekonomik fitues është lidhur kontrata e furnizimit marrëveshje kuadër me nr. 451 prot., datë 17.04.2018, për çmimin për njësi 52.1 lek për kg dhe mini kontrata nr. 452 datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

17.04.2018 me vlerë 7,294,000lekë pa tvsh (8,752,800 lekë me tvsh), me afat 5 muaj. Kjo kontratë është nënshkruar nga drejtori i spitalit Korçë z. A. K. dhe nga operatori ekonomik “I.” SHPK përfaqësuar nga z. K. M.

Nga ana e drejtorit të institucionit nuk është ngritur grup për mbikqyrjen e kontratës së lidhur dhe marrjen në dorzim të kaldajës dhe pelletit të furnizuar dukë vënë në rrezik realizimin e saj me sukses në kohë e cilësinë kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX, “Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës” neni 77, gjithashtu në përfundim të kontratës autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX neni 77, pika 1. Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish drejtorin z. A. K.

-Nga verifikimi fizik i kaldajës u konsatua se: kaldajës i mungon targeti i të dhënave i cili duhet të ishte i stampuar në trupit e kaldajës në pllaket metalike për të dëshmuar përmbajtjen e specifikimeve sipas kësaj procedure si dhe kjo kaldajë e instaluar dhe e marrë në dorzim nga drejtori i spitalit pasi nuk ka ngritur grup marrje në dorzim pa plotësuar asnjë nga dimensionet sipas specifikimeve teknike të kërkuar nga autoriteti kontraktorë dhe të kualifikuar nga ky i fundit ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin z. A. K.

Nga auditimi i abtimit të kontratës dhe nga verifikimi i furnizimeve u konstatua se pelleti i furnizuar nuk është sipas specifikimeve teknike të kërkuar.

Si konkluzion

Komisioni nuk ka bërë studim tregu në lidhje me:

-Vlerën e instalimit (FV-furnizimim vendosje të kaldajave në spital),nuk ka asnjë arsytim ekonomik, teknik a ligjor pse nuk janë prokuruar kaldajat por është kërkuar marrja me qira e tyre.

-Vlerat e qirasë e cila duhet të dalin sipas llojit, madhësinë e kaldajave, harxhimin e pelletit, konsumin energjinë elektrike etj. Por vlera e qirasë është e injektuar në çmimin për kg pellet të ofruar nga operatori ekonomik.

Kaldaja e ngrohjes është instaluar në ambjentin e kaldajave të vjetra që ky spital disponon, me një sipërfaqe aseti (afersisht prej 75 m²). Kaldaja e ngrohjes instalohet në muajin nentorë dhe hiqet nga aty në muajin prill sipas kontratës.

Nga verifikimet në terren dhe deklaratimet të punonjësve të kaldajës dhe verifikimi fizik i kaldajës kaldaja e ngrohjes nuk është lëvizur nga vendi për periudhën mbas përfundimit të kontratës. Nga ana e titullarit të institucionit nuk është marrë asnjë masë për lirimin e hapsirës prej 400m² aq më tepër nuk i është kërkuar operatorit fitues lirimin e ambjenteve apo llogaritja e një qeraje mujore sipas përcaktimeve të VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.

Referuar paragrafit III të kësaj VKM ndryshuar me VKM nr. 992, datë 9.12.2015 Tarifat dysHEME të qirasë mujore për ndërtesat sipas qarqeve, në qytetin e Korçës tarifa dysHEME është përcaktuar 150 lek/m², (400m² x 150 lek/m² = 60,000 lekë në muaj qira e po llogaritur ndaj operatorit ekonomik për zënie hapësire përtej afatit kontraktorë.

Për periudhën Prill-Tetor, kohë në të cilën kjo kaldajë nuk duhet të ishte në këto ambiente operatori ekonomik i detyrohet Spitalit Rajonal Korçë vlerën prej 60,000 lekë/muaj x 7 muaj = 420,000 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për institucionin dhe ngarkon me përgjegjësi titullarët e tij z. A.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

K. dhe z. A. K. për dhënien e mundësisë të operatorit ekonomik të shfrytëzimit të aseteve të spitalit pa asnjë detyrim.

-Në përgjigje të observacionit dërguar me shkresën nr. 1141 datë 05.07.2019 nga SRK për aktkostatimin nr.14 ju bëjmë me dije se ky observacion nuk merret në konsideratë:

Së pari: Ju shpreheni se Grupi i auditimi shprehet gabim; pasi flet për një kaldajë dhe një brucatorë; Grupi i auditimit i ka lexuar DSt dhe ndryshimin e DSt në procedurën e vitit 2018 për shtimin e numrit të kaldajës dhe brucatorëve nga ajo e 2017 por për të folur në përgjithësi nuk ka shprehur numër. Në rastin konkret nga verifikimi fizik në ambjete e Juaja disponohen 4 kaldaja, 1 poshtë ambajentev të administratës, 2 në ambientet e magazinës dhe 1 në ambientin e kaldajave ekzistuese e cila më saktë aty ndodhet një brucator i cili futet në dhomën e djegjes së asaj kaldaje që disponohet aty. Në kërkesën Tuja bëhet fjalë për 3 kalldaja sic e cilësoni me fuqi (me fuqi 480 – 500 KW) dhe Ju dhe 2 brucatorë BP500 kw, sipas DSt pika 2.3 Kapaciteti teknik JU keni në dispozicion 3 kaldaja dhe 1 brucator që implemnetohet në dhomë e ngrohejs së kaldajës apo kazanit.. Sipas verifikimit në terre.

-Pra dhe në pranimin e mallit nuk jeni të sakt, gjithashtu Ju kërkonti kaldaja 500KW në ato kaldaja nuk ka asnjë të dhen teknike, mbi të gjitha që dhe fizikisht madhësia është e ndryshme si dhe të dhënat e elktromotrëve janë të ndryshëm, por edhe pse shfaqet me këto ndryshime JU e pranoni.

Operatori ekonomik paraqet deklaratën për disponimin e kaldajave dhe thotë:

*Vendodhja e këtyre pajisjeve është në selinë e shoqërisë sipas ekstraktit të QKR, deklaratë absolutisht e rreme dhe e pranuar nga ju që me veprimet dhe mosveprimet e juaj beheni pala me OE, në kundërshtim me veprime në kundërshtim me Ligjin 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar neni **Neni 47 ku citohet:** Autoriteti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme², për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratë. Autoriteti kontraktor për çdo skualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji.*

Pasi këto kaldaja ndodhen prej kohësh në ambjete e Juaja

-Në dokumentat e ofertës të OE për kualifikim paraqiten fatura zhdoganimi me emërtimin Kladaja por në asnjë moment të dhënat teknike të saj si fuqia apo parametrat e tjera, dhe nga diskutimet verbale me Ju, jeni shprehur që është verifikuar në vend, JU keni bërë një kualifikim nëkundërshti me Ligjin pa plotësuar kriteret për kualifikim, kjo e vërtetuar dhe verifikuar dhe bga verifikimi i pajisjeve në vend. Në rastin konkret Ju shfaqeni si observacion i OE dhe jo i AK.

-Gjithashtu në flet zhdoganimi flitet për dy kaldaja qëndrore komplet me peshë neto dhe bruto 1900kg, pra nga 850 kg secila, ju në specifikimet teknike kërkonti një kaldajë me peshë 1855 kg, pra as këtu këto dokumentacione që ju keni marrë të mirqenë nuk e kualifikojnë këtë operatorë.

-Për sa I përket ngritjes së grupit të punë merret në konsideratë.

-Për sa I përket cilësisë së pelletit nuk merret nëkonsideratë, grupi I auditimit gjatë verifikimit në ambjentet e Kaldajës në prezencë të Z. Artan Loci, Edmond Rëmacka dhe kaldaistit konstatoi disa thasë plastic amabllazhi pellet njëpjesë me të dhna teknike si mëposhtë dhe njëpjesë pa asnjë të dhënë por nga ana e grupit të punës së pritjes së mallit si specialist të mirfilltë dallohet peleti me tëprekur ose me të parë. Në specifikimet teknike të kerkuara dhe ato të furnizuara siaps thasit të ambllazhit u vërejtën këto devijime.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Nr	Treguesit	Njesia	kërkuar	furnizuar
1	Densiteti	Kg/m ³	650	740
2	Fuqia kalorifike	Kw	4 – 4.2	
3	Mbetja mbas djegjes (hirit)	%	0.1 – 0.2	<0.7
4	Permbajtja e squfurit	%	0.0025 – 0.0030	
5	Ambalazhimi	Thase	15 kg	
6	Lageshtira	%	8.5 – 9.5	
7	Dimensioni	mm	6 – 8	
8	Gjatesia	mm	30 – 40	25max



Sic shikohet dhe në tabelë këmi disa devijime në specifikimet teknike të kërkuara por që grupi I marrjes në dorzim dhe I hartimit të këtij observacioni nuk I ka vënë re, bashkangjitur foto e ambalaxhit.

JU thonë që kjo procedurë ka qenë procedurë e hapur elektronike ku të gjithë operatorët mund të marrin pjesë; Po e vërtet por në kualifikim JU thonë që Operatori ekonomik S.... nuk disponon brucatorë me dokumentacion si më poshtë: *(Ju per sa i perket brucatoreve keni dorezuar ne sistemin e Prokurimit Publik vetem nje dokument doganor per brucator djeges nafte cope 1, dhe nje deklarate ku deklararoni qe keni gjendje 2 (dy) cope brucator me pellet sipas karakteristikave te kerkuara ne dst, dhe kete deklarate nuk e keni te shoqeruar me dokumentat e kerkuara nga ana jone si me siper. Ne keto kushte kjo kerkese e kerkuar nga ana jone mbetet e pa plotesuar nga ana juaj.)*

Thelbi i një procedure prokurimi është shpenzimi me efeciencë i fondeve publike si dhe respektimi i DST dhe kushteve e specifikimeve të Tenderit.

Sa më sipër observacion nuk merret në konsideratë dhe ngarkohet me përgjegjësi Grupi i parnimit dhe marrjes në dorzim dhe KVO.

-Në përgjigje të observacionit ardhur me shkresën nr. 1380 prot. Datë 22.08.2019 si dhe shkresën e operatorit ekonomik “I.”SHPK, Ju bëjmë me dije, se Spitali rajonal Korçë ka vënë në dispozicion ambjetet e tij për instalimin e kaldajës tuaj për periudhën 4-5 mujore për të cilën ofroni shërbim në këtë spital dhe jo për të gjithë vitin siç ju veproni duke zënë hapsirat e këtij institucioni. Sic cilësohet dhe në kontratë që afati i saj është deri më 15.03.2018, pra nga ky moment nëse skem shtyerje afati si shkak i motit, kjo kaldajë duhet të lëvizet dhe të lirohet hapsira e zënë.

*Gjithasht në observacion paragrafi dytë Ju deklaroni: “Mbështetur në kriteteret e tenderit dhe kontratën e lidhur për furnizim me pellet kërkohet përveç kritereve të tjera **dhe instalimi i kaldajës nga ana e subjektit** në ...” Pra siç deklarohet dhe nga ju në shkresën e dërguar për kundërshtimin e vlerës së qiras JU **detyrohemi të kryeni dhe instalimin e kaldajës.***

D. Në zbatim të pikës D të programit të auditimit, u shqyrtua organizimi dhe funksionimi strukturave drejtuese bazuar në Strukturën Analitike të Sistemit Spitalor Korçë miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me nr. 1369 Prot. datë 10.03.2017.

Titulli i Gjetjes: Në Spitalin Rajonal Korçë nuk janë ngritur Këshilli Administrativ, Komisioni Mjekësor dhe Komiteti për Planifikimin Spitalor Publik.

Situata: Spitali Rajonal Korçë është person juridik publik dhe organizohet, administrohet dhe vepron sipas Ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe VKM-së nr. 1661 datë 29.12.2008 “Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, si edhe të gjitha ligjeve dhe akteve të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

tjera nënligjore për shërbimin spitalor dhe kujdesin shëndetësor. Në mbështetje të këtij ligji, ky spital kategorizohet de jure si spital rajonal (spital qarku) dhe organet drejtuese të autoritetit spitalor të qarkut duhet të jenë 1. Këshilli Administrativ; 2. Drejtoria; 3. Komisioni mjekësor.

Në Spitalin Rajonal Korçë nuk është ngritur Këshilli Administrativ, si një organ kolegjal, i cili merr vendime me shumicë votash, duke miratuar politikën, hartuar programet tekniko-financiare për konkretizimin e planeve afatshkurtra dhe afatgjata në fushën e shërbimit spitalor të qarkut, në përputhje me strategjinë dhe politikën shtetërore shëndetësore, të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë; programimin dhe propozimin Ministrisë të Shëndetësisë për ndryshimet strukturore të autoritetit spitalor të qarkut; propozimin e projektbuxhetit, ndarjen dhe destinacionin e tij; pranimin e dhuratave nga individë ose fondacione dhe shoqata me qëllim bamirësie, si dhe binjakëzimin me spitalet simotra; propozimet për Ministrinë e Shëndetësisë për emërimin dhe shkarkimin e drejtorit ekzekutiv të autoritetit spitalor të qarkut; emërimet dhe shkarkimet e drejtorëve e spitalit të qarkut, në bazë të propozimit të bërë nga drejtori.

Në Spitalin Rajonal Korçë nuk është ngritur Komisioni Mjekësor, si një organ i këshillimit teknik i Drejtorisë së Spitalit, i cili ka për kompetencë: propozimet për blerjen e pajisjeve mjekësore, diagnostike dhe terapeutike; vendimet që përfshijnë aspektet mjekësore të punës; rregullat e organizimit të shërbimeve mjekësore të institucionit; vlerësimin, krijimin, mbylljen ose modifikimin e reparteve, spitaleve ose të gjitha njësive funksionale në varësi; vlerësimin e treguesit cilësor të shërbimeve; zbatimin e protokolleve të mjekimit; trajnimin e personelit mjekësor dhe atij ndihmës; shërbimet dhe pajisjet e reja që janë kompetencë e Komisionit Mjekësor, në fakt kryhen nga Drejtoria e Spitalit.

Nuk është ngritur gjithashtu Komiteti për Planifikimin Spitalor Publik të qarkut.

Drejtoria e Spitalit Rajonal Korçë sipas përcaktimeve të ligjit duhet të përbëhet prej 1. Drejtorit Ekzekutiv; 2. Zëvendësdrejtorit Teknik 3. Zëvendësdrejtorit Ekonomik; 4. Kryeinfermierit të Përgjithshëm. De fakto titullari i institucionit nuk është drejtor ekzekutiv me të drejta dhe kompetenca të plota, pikërisht prej boshllëkut të krijuar strukturalisht, për shkak të mungesës së organeve të përcaktuara në ligj, me të cilët janë të lidhura ngushtësisht detyrat ekzekutive të titullarit.

Struktura analitike e Sistemit Spitalor Korçë është miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me nr. 1369 Prot. datë 10.03.2017. Emërtimet në këtë strukturë nuk përputhen me ato të nenit 18 të Ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 të ndryshuar, pasi ZV. Drejtori teknik është emërtuar si ZV. Drejtor i shërbimeve klinike ndërsa ZV. Drejtori ekonomik është emërtuar si ZV. Drejtori i shërbimeve administrative.

Statusi konkret juridik i Spitalit Rajonal Korçë paraqitet i paqartë pasi: Kategorizimi i pagave të personelit administrativ dhe atij spitalor të kësaj qendre, e cila konsiderohet Spital Rajonal, është i njëjtë me të gjitha spitalet e tjera të bashkive. Pra, Spitali Rajonal Korçë kategorizohet në të njëjtin rang juridik si spitalet e tjera të nivelit bashkiak. Struktura analitike, organizative dhe administrative, e cila vjen e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë është e njëjtë si për Spitalin Rajonal Korçë që ligjërisht organizohet si Spital Rajonal, ashtu edhe për Spitalet e Qarkut që organizohen si spitale bashkiake. Miratimi i tarifave të shërbimeve bëhet me urdhër të brendshëm të titullarit të Institucionit (Drejtori), në mungesë të Këshillit Administrativ.

Bazuar në Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, organi përgjegjës për njohjen, hapjen dhe klasifikimin e spitaleve publike, miratimin e strukturës organike, ofrimit të llojeve të shërbimeve spitalore, etj, është Ministria e Shëndetësisë, e cila duhet të bëjë një përcaktim juridik në lidhje me statusin juridik të spitaleve publike, përfshirë edhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Spitalin Rajonal Korçë. Veprimtaria e administratës është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, që miratohet nga Ministria e Shëndetësisë. Po ashtu dhe Ministria e Shëndetësisë ka të drejtë të urdhërojë ushtrimin e kontrolleve të plota ose të pjesshme për veprimtarinë e Spitalit Rajonal Korçë nëpërmjet strukturave të specializuara.

Kriteri: Sa më sipër është në kundërshtim me me Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. dhe Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Ndikimi/Efekti: Mos ngritja e Këshillit Administrativ, ka sjellë uljen e besueshmërisë dhe saktësisë e zbatimit të politikave të Ministrisë së Shëndetësisë në Spital duke krijuar problematika në zbatimin e pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në këto kushte të gjitha funksionet që duhet të kryheshin nga Këshilli Administrativ, de fakto kryhen nga Drejtoria e Spitalit duke krijuar mos-përmbushjen e plotë si dhe tejkalim të kompetencave e detyrave të drejtorit ekzekutiv.

Mos ngritja e Komisionit Mjekësor në Spitalin Rajonal Korçë ka bërë që Drejtoria e Spitalit të funksionojë pa këshillim teknik lidhur me propozimet për blerjen e pajisjeve mjekësore, vendimet që përfshijnë aspektet mjekësore të punës si dhe rregullat e organizimit të shërbimeve mjekësore të institucionit.

Mungesa e Komitetit për Planifikimin Spitalor ka sjellë mangësi në hartimin dhe raportimin e planit spitalor.

Shkaku: Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e moszbatimit të Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. dhe Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Drejtoria e Spitalit Rajonal Korçë të marrë masa menjëherë dhe në vazhdimësi për ti kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Instancave të tjera kompetente, përcaktimin konkret të statusit juridik që duhet të ketë ky Spital, në lidhje me funksionimin dhe aktivitetin e Tij.

Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi Znj. E. B. ish-Drejtoresh e Spitalit Rajonal Korçë për periudhën janar- shtator 2017 z. A. K., ish Drejtor i Spitalit Rajonal Korçë për periudhën shtator 2017 – mars 2018 dhe z. A. K. me detyrë Drejtor i Spitalit Rajonal Korçë për periudhën mars-dhjetor 2018.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 2 datë 28/06/2019 dhe për këtë çështje subjekti i audituar me shkresën nr. 1141 prot., datë 05/07/2019 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht sqarohet se nuk ekziston asnjë shkresë apo bazë ligjore që e kategorizon Spitalin e Korçës si Spital Rajonal. Duke ju referuar sistemit të pagave Spitali i Korçës është në të njëjtin nivel pagash me spitalet bashkiake. Ngritja e Këshillit Administrativ bëhet me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërkohë që Spitali Korçë qoftë nga mënyra e organizimit, struktura e personelit, pagat, mënyra e funksionimit si dhe shërbimet që ofron funksionon me varësi vertikale nga Ministria e Shëndetësisë, njësoj si spitalet bashkiake, në këtë kuadër nuk mund të ketë Këshill Administrativ e organe të tjera.

Mos përputhja e Strukturës analitike me nenin 18 të Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003, është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë e cila miraton strukturën snalitike.

Pas kometeteve të bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit sqaron se bazuar në nenet 33 dhe 36 të Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, për klasifikimin e spitaleve, për nga shërbimet që ofron spitali dhe kabinetve që



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

operojnë si p.sh. ai i hemodializës, ai kategorizohet si një spital rajonal, për më tepër vetë Ministria e Shëndetësisë në kategorizimin e publikuar të spitaleve këtë spital e kategorizon si një Spital Rajonal. Në këto kushte konform përcaktimeve ligjore organet drejtuese të autoritetit spitalor të qarkut duhet të jenë 1. Këshilli Administrativ; 2. Drejtorja; 3. Komisioni mjekësor. Për sa më sipër komentet merren në konsideratë pjesërisht dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

E. Zbatimi i strukturës organizative, dhënies së pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi

Spitali Rajonal i Korçës vepron në bazë të rregullores së miratuar me shkresën nr.4884, datë 31.12.2008 e cila është e papërshtatur dhe e pa përditësuar me ndryshimet e bëra në strukturë gjatë viteve të fundit për këtë institucionin.

Struktura analitike miratohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Me shkresën nr. 1369 prot., datë 10.03.2017 Ministria e Shëndetësisë ka miratuar strukturën analitike të shërbimit spitalorë Korçë për vitin 2017, numri total që parashikon kjo strukturë është 565 punonjës.

Me shkresën nr. 4994/1 prot., datë 05.12.2017 Ministria e Shëndetësisë ka miratuar ndryshimet në strukturën e vitit 2017, në të cilën nuk kemi ndryshime në numrin total të punonjësve por ndryshime në pozicione pune; Mjek ORL ishin të miratuar 2 dhe bëhet 1 si dhe Mjek gjinekolog nga 1 që ishte bëhen 2 punonjës.

Me shkresën nr. 2501/1 prot, datë 18.04.2018 Ministria e Shëndetësisë ka miratuar ndryshimet në strukturën e vitit 2018, në të cilën nuk kemi ndryshime në numrin total të punonjësve por ndryshime në pozicione pune; Banka e gjakut ishin të miratuar 5 dhe bëhet 4 punonjës si dhe infermier nga 2 që ishte bëhen 3 punonjës.

Me shkresën nr. 1939/1 prot, datë 18.04.2018 Ministria e Shëndetësisë ka miratuar ndryshimet në strukturën e vitit 2018, në të cilën nuk kemi ndryshime në numrin total të punonjësve por ndryshime në pozicione pune; Mjek pediatër infeksionist ishin të miratuar 1 dhe bëhet 0 punonjës si dhe në klinikën e terapi së intensive të pediatriisë nga 0 që ishte bëhen 1 punonjës.

Rregullorja e miratuar me shkresën nr.4884, datë 31.12.2008 mbi të cilën ka vepruar Spitali Rajonal i Korçë është e papërshtatur me ndryshimet e bëra në strukturë gjatë viteve të fundit për këtë institucionin.

Nga auditimi i sistemit tatimor rezultojnë **gjoba** në vlerën **5,000 lekë** si gjobë për deklarim të vonuar të tvsh të muajit tetor 2018 e cila përbën **efekt negativ financiar**.

Janë audituar listëprezencat dhe listëpagesat për muajt mars, gusht, dhjetor 2017 dhe mars, gusht, dhjetor 2018 ku janë vënë re diferenca në përlllogaritjen e pagave të cilat vijnë si pasojë e:

- mosllogaritjes së saktë ose mos përditësimit të vjetërsisë në punë
- mospozicionimit të saktë të pagës së grupit
- luhajtjeve të theksuara të pagës së grupit për të njëjtët punonjës për të njëjtat pozicione pune, për të njëjtat nivele arsimore nga muaji në muaj e cila ka krijuar diferenca pozitive dhe negative në pagën e grupit dhe për pasojë edhe në pagën totale bruto.
- ka punonjës me paga grupi të cilat nuk ekzistojnë në legjislacion edhe pse kanë punuar gjatë muajit 22 ditë pune
- mosllogaritje e saktë e pagës bazë mujore



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Baza ligjore e përdorur për muajt e marrë në shyrtrim është VKM nr. 188 datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar”, Lidhja nr. 1 (Kreu 1.3) dhe Lidhja nr. 2 (Kreu 2.3) e cila shërben për llogaritjen e pagës së pozicionit, shtesës për kushtet e punës dhe nivelit të vjetërsisë duke u bazuar gjithashtu në librezat e punës dhe dosjet individuale të këtyre punonjësve, Lidhja nr. 3 për përcaktimin e pagës së grupit (mbi të cilën llogaritet edhe vjetërsia) si dhe VKM nr. 555, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e forcave të armatosura”, pika 4 shtesa për vjetërsi në punë, pika 7 shtesa për kushte pune, pika 12/1 a dhe b për llogaritjet e turneve roje dhe pagave në ditë festash dhe ditë të zakonshme, pika 12.2 Për punonjësit e infermieristikës e cila shërben për llogaritjen e shtesave të turneve të dyta dhe të treta, si dhe Vendim nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” si dhe VKM nr. 202, datë 15.03.2017, VKM nr. 264, datë 16.05.2018 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, pika 7 për llogaritjen e vjetërsisë për pozicionet mbështetëse, pika 9 për aplikimin e shtesavë për vështirësi në punë, pika 18/1 për shtesat që përfitojnë shoferët e urgjencës së spitaleve për natyrë të veçantë pune, Lidhja nr. II për pagën bazë mujore të pozicioneve mbështetëse sipas secilës klasë, Lidhja nr. II/1 (2) për klasifikimin e pozicioneve mbështetëse sipas secilës klasë.

Tabela nr. 01: Ri-llogaritje e vjetërsisë së punës në Aneks

Janë shqyrtuar 20 raste për 2 muajt mars, gusht 2017 dhe janë konstatuar diferenca pozitive dhe negative në llogaritjen e vjetërsisë.

Diferencat pozitive tregojnë që këta persona janë paguar më shumë se ç’ju takonte realisht kurse diferencat negative tregojnë se janë paguar më pak se ç’ju takonte realisht të paguheshin për vjetërsinë në punë.

Janë rillogaritur pagat e grupit për një grup punonjësish për muajt janar-gusht 2017

Tabela nr. 02: Ri-llogaritje e pagave të grupit sipas nivelit arsimor përkatës në aneks

Diferencat negative tregojnë se punonjësit janë paguar më shumë se sa niveli i tyre arsimor.

Diferencat pozitive tregojnë se janë paguar më pak se niveli i tyre arsimor.

Nga 22 punonjës të marrë në shyrtrim, për 16 prej tyre rezultojnë diferenca për muajt janar-gusht 2017, keq – aplikim i pagës së grupit, mos njohje e saktë e ligjit.

Në bazë të komunikimeve shkresore që Spitali ka pasur me Ministrinë dhe në bazë të shkresave, fillimisht paga e grupit që duhej të aplikohet ishte PG që ishte vendosur me shkresën e parë, jo dhe aq në përputhje me legjislacionin.

Problematika më e lartë është hasur në muajin maj 2017 ku për infermierët aplikohet pagë grupi 20,000 lekë ose 6,000 lekë më shumë se niveli maksimal arsimor i masterit shkencor prej 14,000 lekësh.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Të gjithë këta punonjes janë paguar për muajin maj 2017 me 6,000 lekë më shumë duke i shkaktuar diferenca në shumën 645,955 lekë. Këto diferenca kanë ardhur si pasojë e mosaplikimit të legjislacionit të pagave që në muajin mars 2017, dhe në muajin maj janë kompensuar diferencat që nuk janë paguar në muajt mars, prill 2017. Sektori financës në rast mosaplikimi në kohë reale të legjislacionit, mban përgjegjësi për mos njohje të ligjit dhe të gjitha gabimet në përlllogaritje në çdo kohë duhet të raportohen. Nuk lejohet ndërhyrja në komponentë paga si pasojë e mosnjohjes së ligjit.

Gjithashtu nga aplikimi i pasaktë i pagës së grupit rrjedhin diferenca të vjetërsisë në punë duke shkaktuar një **efekt negativ financiar** në shumën **148,546 lekë**. Paga e grupit ishte paguar më pak në muajt para ardhës dhe në muajt pasardhës është bërë korrigjimi, por aplikimi i shtësës së vjetërsisë duhet të kryhej mbi pagën reale të grupit. Mos aplikimi në kohë i ligjit dhe mos njohja e tij kanë sjellë efektet negative të mësipërme.

Titulli i Gjetjes: Mos aplikim i saktë i pagës

Gjetja: Nga auditimi i listëpagesavë të spitalit janë konstatuar problematika në lidhje me -mosllogaritjen e saktë ose mos përditësimin të vjetërsisë në punë duke shkaktuar diferenca pozitive dhe negative. Diferencat negative tregojnë se punonjësit janë paguar më shumë se sa niveli i tyre arsimor. Diferencat pozitive tregojnë se janë paguar më pak se niveli i tyre arsimor - mospozicionimit të saktë të pagës së grupit - luhajtjeve të theksuara të pagës së grupit për të njëjtët punonjës për të njëjtat pozicione pune, për të njëjtat nivele arsimore nga muaji në muaj e cila ka krijuar diferenca pozitive dhe negative në pagën e grupit dhe për pasojë edhe në pagën totale bruto. - mosllogaritje e saktë e pagës bazë mujore

Pasoja: Problematika ka sjellë efekt negativ financiar në vlerën **148,546 lekë**

Niveli Riskut: I mesëm

Rekomandimi: Nga Departamenti i Financës të Spitalit Rajonal Korçë të merren masa që të ri-strukturohet mënyra e përlllogaritjes së pagave për çdo të punësuar në Spital duke rritur transparencën në afrimin e informacionit përkatës për të gjithë komponentët e pagës, duke shënuar vitet e punës në numër dhe në vlerë, pozicionin e punës sipas emërimit përkatës të gjithsecilit, pagën e grupit sipas arsimimit përkatës të gjithsecilit, mënyrën e llogaritjes së komponentëve të pagës të cilat duhet të paraqiten në listë pagesë, duke qenë në përputhshmëri të plotë edhe me bazën referuese ligjore.

-Të merren masa që të bëhet përditësimi i regjistrit të punonjësve si dhe librezave të punës me lëvizjet përkatëse dhe periudhat përkatëse për çdo të punësuar si edhe plotësimi i dosjeve për çdo të punësuar sipas inventarit të dosjes.

Kjo problematikë ka nisur të rregullohet në shtator 2017 pas komunikimeve shkresore me Ministrinë e Shëndetësisë në lidhje me aplikimin e pagës së grupit për sistemin e vjetër arsimor. Gjithsesi, disa prej pagave të grupit kanë vazhduar të aplikohen gabim.

Disa punonjës edhe pse kanë punuar 22 ditë pune në muajt shtator 2017- dhjetor 2018 kanë një pagë grupi e cila nuk ekziston në legjislacion, si psh znj. P. B. me pagë grupi 18,000 lekë për muajin dhjetor 2018 edhe pse u morën shkresa nga Ministria e Shëndetësisë për aplikimin e saktë të pagës së grupit. Po kështu, znj. M. P. me pagë grupi 10,500 lekë për të gjithë muajt janar - dhjetor 2017 dhe janar-dhjetor 2018 duke u paguar 500 lekë më shumë çdo muaj dhe duke krijuar një efekt negativ prej 12,000 lekë për të 2 vitet vetëm kjo punonjëse.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Ka raste të punonjësve të cilët janë diplomuar pas vitit 2011 për të cilët legjislacioni është shumë i saktë dhe niveli arsimor nis nga bachelor sistemi i ri 3 vjeçar dhe prap ka lëvizje të pagës së grupit nga muaji në muaj si psh z. E. M., znj. A. S., z. Dh. F., znj. D. L., z. R. K., znj. M. Zh., znj. D. O. etj, emra që gjithashtu mund të gjenden në tabelat e mësipërme. Në bazë të vjetërsisë së tyre në punë që nuk kalon 5 vjet në vitin 2017 dhe që janë diplomuar me sistemin e ri bachelor, i cili brezin e parë e diplomoi në vitin 2012, paga e grupit nuk duhet të lëvizte asnjë muaj për këta punonjës pasi diplomat e tyre nuk krijojnë konfuzion me ligjin e ri të pagave.

Të gjitha këto diferenca kanë ndikuar në llogaritjen e pasaktë të pagës reale bruto që këta punonjës duhet të përfitonin.

Të gjithë komponentët e tjerë të pagës janë llogaritur saktë.

Në lidhje me emërimet janë marrë në shqyrtim emërimet për muajt shkurt- mars 2017 dhe për 2 raste, znj. E. B. dhe znj. J. D., pas emërimit kanë qenë prezent në listëprezencë por jo në listëpagesën e muajit mars 2017. Gjithsesi janë regjistruar në sistemin tatimor dhe janë harruar të shënohen në listëpagesën e muajit kur kanë nisur punën.

Në lidhje me shoferët, të cilët janë 27 në stukturë, të gjithë e kanë emërimin në sektorin teknik por ndërkohë paguhet si shoferë të urgjencës duke përfituar dhe shtesat përkatëse sipas ligjit. Emërimi krijon konfuzion në mënyrën e aplikimit të pagës dhe në çdo kohë duhet të përputhet saktësisht me pozicionin, duke u quajtur shoferë të urgjencës së spitaleve, pasi emërimi si shoferë në sektorin teknik i ekspozon në një nivel tjetër page sipas Vendimit nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” si dhe VKM nr. 202, datë 15.03.2017, VKM nr. 264, datë 16.05.2018 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”.

Nga auditimi i proceseve gjyqësore të largimeve nga puna për periudhë objekt auditimit në Spitalin Rajonal Korçë janë dëshmshpërblyer pas fitimit të procedurave gjyqësore dy punonjës të cilët kanë përfituar në total **911,067 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar** për buxhetin e shtetit.

Titulli i Gjetjes: Konfuzion në emërimet, shkarkime të pa studiura nga puna, deklarime me vonesë në sistemin tatimor

Gjetja: Nga auditimi i listëpagesave të spitalit janë konstatuar problematika në lidhje me emërimet e paqarta për pozicione pune si dhe shkarkime nga puna të pa studiura mirë për të cilat spitali ka paguar procese gjyqësore.

Gjithashtu nga verifikimi i deklarimeve në sistemin tatimor janë konstatuar vonesa në deklarin e listë pagesave për të cilat nuk janë respektuar afatet e deklarinimit dhe për këto veprime janë aplikuar gjoba në sistem në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Vlera e tyre prej **5,000 lekë** përbën efekt negativ financiar.

Pasoja: Problematika ka sjellë **efekt negativ financiar** në vlerën **916,067 lekë**

Niveli Riskut: I mesëm

Rekomandimi: Nga Departamenti i Financës dhe ekonomisti i pagave të Spitalit Rajonal Korçë të merren masa për shqyrtimin e efektit negative financiar në vlerën totale **916,067 lekë** të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna dhe raportimeve me vonesë në sistemin tatimor, të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës. (911,067 lekë prej proceseve gjyqësore dhe 5,000 lekë prej deklarimeve të vonuara në sistemin tatimor)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

-Nga Drejtimi i Spitalit Spitalit Rajonal Korçë dhe Sektori Juridik, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimi i detyrimeve të shtuara përmbartimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për buxhetin e Spitalit.

-Nga sektori i Burimeve Njerëzore të merren masa që në çdo kohë emërimet të kryhen konform strukturës së miratuar dhe legjislacionit në fuqi.

Në përgjigje të observacionit nr.1141 datë 05.07.2019 sqarojmë se observacioni merret pjesërisht në konsideratë sepse:

-Mosaplikimi i saktë i pagës së grupit për muajt e audituar dhe kompensimi në muajt pasardhës është përgjegjësi e sektorit Tuaj. Mosnjohja e ligjit nuk shmanë përgjegjësitë. Ju në rast moskuptimi të legjislacionit duhet të kryeni tarjnimet e domosdoshme dhe në çdo rast të raportoni për gabimet në përlllogaritje.

-Mos aplikimi i saktë i pagës së grupit ka sjellë diferencë negative dhe pozitive, punonjësit nuk janë paguar për aq sa i takon ose janë paguar më shumë se çfarë i takon, në asnjë rast grupi i auditimit nuk ka përmendur dëm ekonomik. Efektet negative kanë ardhur si pasojë e ndryshimeve të shpeshta të pagës së grupit

-Observacioni në lidhje me punonjësit invalidë dhe rilloaritjen e pagave të grupit për një pjesë të punonjësve është marrë parasysh dhe është pasqyruar në material.

-Difektet teknike të pagave të grupit nuk merren parasysh pasi janë audituar listëpagesat dhe këto diferencë tashmë kanë ndodhur. Diferencat duhet të reflektohen për periudhën aktuale dhe në çdo kohë të kryhet rakordimi me sektorin e burimeve njerëzore.

F. Mbi auditimin me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë, (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta, sponsorizime, etj)

Në zbatim të pikës F të programit të auditimit "Nr.211/1 prot, datë 18.04.2019", u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Dokumentacioni i pagesave të bankës (urdhër shpenzime të Degës së Thesarit).

Dokumentacioni i arkëtimeve, pagesave të arkës.

Dokumentacioni hyrjeve dhe daljeve të magazinës.

Dokumentacioni i mbajtur mbi marrjen në dorëzim të furnizimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Titulli i Gjetjes: Kontrata për shërbimin e telefonisë, që kanë sjell dëm ekonomik për institucionin

Situata: - Me vendimin nr. 85/6 Prot, datë 15.05.2017 të përmbartuesit gjyqësor të shoqërisë "D.", SHPK, institucioni është detyruar të kryej pagesën për shoqërinë "T.A.", SHA, vlerën 1,796,991 lekë, si dhe vendimin nr.75/19 prot., datë 15.05.2017 për vlerën 347,832 lekë, më datë 16.05.2017 me urdhër shpenzimin nr. 237. Kjo vlerë ka ardhur sipas pretendimeve se Spitali Rajonal Korçë, ka përdorur shërbimet e kompanisë për disa vjet dhe kishte mbetur papaguar vlerën më sipër. Nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se palët kishin lidhur marrëveshje për ofrimin e shërbimit të telefonisë për punonjësit e Spitalit Rajonal me kontratat e lidhura nga 20.07.2007 deri më 04.04.2008, nga ish drejtori z. I. J. Megjithë pretendimet se faturimi i çdo numri bëhej në mënyrë individuale, gjykata vendosi në favor të kompanisë.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me LPP, si dhe VKM nr. 343, datë 11.07.2002, "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë", i ndryshuar, ku përcaktohet:

"...punonjësit e Spitalit Rajonal Korçë, nuk përfshihen në asnjë nga pikat që ka parashikuar vendimi i mësipërm, duke e kthyer dhe kontratën në të pavlefshme "

Ndikimi: *Vlera 2,144,823 lekë përbën dëm ekonomik që duhet të dëmshpërblehet nga z. I. J.*

Shkaku: Mungesa e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Të kërkohet në mënyrë ligjore, duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës prej **2,144,823 lekë** e cila ka ardhur si rezultat i lidhjes së kontratës së shërbimit të telefonisë nga ish titullari z. Ilia Jatagani.

Titulli i Gjetjes: **Efekte negative ekonomike në llogaritjen e fondit limit për trajtimin e mbetjeve spitalore**

Situata: -Gjatë auditimit të procedurës së "Trajtimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme periudha 2017", u konstatua se, grupin e punës i ngritur për llogaritjen e fondit limit që do të prokurohet për evadimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore me përbërje znj. E. B., znj. K. B. dhe znj. M. L., me urdhrin nr. 897 prot., datë 28.06.2017, llogaritjen e çmimit e ka kryer mbështetur në kontratën e vitit 2016, kur AK, ka pasur një kontratë të lidhur në 6-mujorin e parë të vitit 2017.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me nenin 59 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku citohet:

1. " Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe
- a) çmimet e tregut;ose/dhe
 - b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

Ndikimi: *Vlera 30,690 lekë përbën efekt negativ ekonomik për Spitalin Rajonal Korçë.*

Shkaku: Mungesa e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Të merren masa nga drejtimi i institucionit, që përlllogaritja e vlerave të kontratave të kryhet duke verifikuar me përgjegjshmëri të gjitha mundësitë që i ofrohen institucionit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Titulli i Gjetjes: Shpenzime jo të justifikuar në pagesën e OE "M."SHPK.

Situata: -Gjatë auditimit të pagesave të procedurës së prokurimit për evadimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, për periudhat 2017-2018, u konstatua se OE fitues, nuk ka sjellë dokumentacion justifikues, për pjesën e trajtimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore si dhe dokumentacion provues që materialet janë trajtuar sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me vendimin Nr. 798, datë 29.9.2010, Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore", kreu II, detyrimet e prodhuesve të mbetjeve spitalore, citohet

" Objekti i kontratave sa më sipër është **"Grumbullimi, transporti, trajtimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme, përjashtuar mbetjet me rrezik kimik dhe radioaktiv"**. Në pikën 2, Të drejtat dhe detyrimet e porositësit, (Drejtoria e Shërbimit Spitalor, Korçë), 2.1.2, citohet:” *Të kërkojë informacion për çdo fazë që lidhet me zbatimin e kësaj kontrate. Kur konstatohen shmangie nga kërkesat e paraqitura prej tij, porositësi kërkon zbatimin e tyre."*

Në vendimin Nr. 798, datë 29.9.2010, Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore", kreu II, detyrimet e prodhuesve të mbetjeve spitalore, citohet:

5. Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për:

- a) grumbullimin e kontrolluar të mbetjeve spitalore pranë institucionit shëndetësor;
- b) ndarjen e mbetjeve spitalore të parrezikshme (të llojit urban) nga mbetjet spitalore të rrezikshme;
- c) ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe asgjësimin në mënyrë të përshtatshme, të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre;
- d) shpenzimet e transportit, asgjësimit ose riciklimit të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre. Kjo përgjegjësi është e pashmangshme dhe e pavarur nga përgjegjësia e ndonjë personi të tretë të ngarkuar nga prodhuesi, për të ndërmarrë këto veprimtari;
- e) **të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre.**

Kreu III, trajtimi i mbetjeve spitalore, pika 8 citon: “Çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve që nga prodhimi, grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe deri tek asgjësimi i tyre.” 8.10 Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhet me metodat sipas shtojcës 3. 8.11 Impiantet për përpunimin e mbetjeve spitalore respektojnë kushtet e asgjësimit dhe normat e shkarkimeve në ajër të përcaktuara në pikën 5.1.2 "Linja për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe spitalore" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë", si dhe kërkesat specifike sipas shtojcës 5.

-Shtojca 5, Standarde teknike për incenerimin dhe autoklavimin e mbetjeve spitalore.

Standardet teknike për incenerimin e mbetjeve spitalore përfshijnë standardet e përcaktuara në tabelën 6.1 "Krematori" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".

Të gjitha mbetjet spitalore që mund të digjen, duhet të shndërrohen nga inceneratori në hi që nuk përkon me formën e mbetjeve para djegies. Ky hi që rezulton nga djegia, të paktën një herë çdo tre muaj analizohet duke përdorur përzjerje kampionaturash të rastit për përmbajtjen e karbonit organik total dhe çdo vit analizohet për përmbajtjen e plumbit, merkurit, kaliumit dhe metaleve të rënda. Hiri që rezulton nga djegia nuk duhet të ketë më shumë se 5% karbon



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

(minimalisht 95% djegie). Mbetja nga djegia ose hiri që përftohet nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore është mbetje e ngurtë dhe asgjësohet në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta".
Procesi i sterilizimit nëpërmjet autoklavimit duhet të përfshijë në të njëjtin moment procesin e reduktimit volumor dhe të sterilizimit të mbetjeve spitalore. Sterilizimi duhet të bëhet me avull në temperaturën jo më të vogël se 130°C dhe në presionin jo më të vogël se 1.1 bar.

Ndikimi: Mos pasja e sigurisë së procesit të trajtimit të mbetjeve, rrit riskun e përgjegjësive për të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre.

Vlera 627,000 lekë përbën shpenzime jo të justifikuar nga OE "M." SHPK.

Shkaku: Mungesa e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Të merren masa nga drejtimi i institucionit që në zbatim të kushteve, rregullave dhe përgjegjësive që ka prodhuesi i mbetjeve, (Spitali Rajonal, Korçë), duhet të ndjekë deri në fund procesin e asgjësimit, duke marrë evidenca vërtetuese nga kompania e kontraktuar për transportin dhe trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme se operacionet për kryerjen e tyre janë bërë në përputhje me vendimet, standardet dhe rregulloret e aprovuara. Përveç faturës zotëruesi dhe asgjësuesi i mbetjeve duhet të disponojë mënyrën e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, analizat e kampionëve të hirit që përfitohet nga trajtimi i mbetjeve, të kryera sipas kërkesave si dhe të dokumentojë se kjo mbetje e ngurtë është asgjësuar në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta".

Titulli i Gjetjes: Referuar auditimit me zgjedhje, u konstatua mos plotësimi i kushteve kontraktore, për afatin e dorëzimit të barnave nga OE "T." SHPK.

Situata: Nga verifikimi i zbatimit të kontratës me nr. 617 prot., datë 19.04.2017, lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë "T.", SHPK, me objekt "Blerje barna", me vlerë 1,018,247 lekë pa TVSH, me afat levering deri më 15.12.2017, u konstatua shkelje në afatin e leveringit.

Në lidhje me leveringimet e medikamentit Amikacinë, u konstatuan shkelje të afateve për 20 % e sasisë që duhej të dorëzohej në muajin e parë, për sasinë që duhej të dorëzohej në muajin e dytë si dhe atë të tretë. **Penalitetet e maturuara janë në vlerën 137,463 lekë.**

Në lidhje me leveringimet e medikamentit Amoksilinë, u konstatuan shkelje të afateve për 20 % e sasisë që duhej të dorëzohej në muajin e parë, për sasinë që duhej të dorëzohej në muajin e dytë si dhe atë të tretë. **Penalitetet e maturuara janë në vlerën 222,996 lekë.**

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me kushtet e kontratës, "Afati i leveringit dhe marrja në dorëzim.

Ndikimi: Lidhur me mos dorëzimin e barnave sipas afateve të kontratës OE ka maturuar penalitete në vlerën **360,459 lekë** pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, dhe duhet të dëmshpërmbledhet nga OE "T." SHPK.

Shkaku: Mungesa e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **360,459 lekë** pa TVSH, përkatësisht nga kontraktori "T." SHPK, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të Spitalit Rajonal, Korçë, si rrjedhojë e mos leveringit të barnave sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

Titulli i Gjetjes: Referuar auditimit me zgjedhje, sipas vlerësimit të rrishtit, u konstatua mos plotësimi i kushteve kontraktore, për afatin e dorëzimit të barnave nga OE "M." SHPK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Situata: Nga verifikimi i zbatimit të kontratës me nr. 401 prot, datë 27.02.2017, lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë " M.", SHPK, me objekt "Blerje materiale mjekimi për nevojat spitalore", me vlerë 1,561,830 lekë pa tvsh, dhe me vlerë 1,874,196 lekë me tvsh me afat lëvrimit deri më 31.03.2017, u konstatua shkelje në afatin e lëvrimit.

Afatet e zbatimit të kontratës përcaktojnë se të paktën 20 % e sasive të kontraktuara duhet të lëvroheshin brenda 10 ditëve dhe pjesa tjetër brenda muajit mars.

Me faturat nr. 10022, 10029, dhe 10030, të datës 10.03.2017, OE "M."SHPK, ka lëvruar sasi të para të materialeve të mjekimit.

Afati i dorëzimit është tejkualuar me dy ditë duke maturuar **penalite në vlerën 142,439 lekë me Tvsh, për OE.**

Me faturën nr. 10164, të datës 19.04.2017, OE "M."SHPK, ka lëvruar sasi të mbetura për 5 materiale të mjekimit.

Afati i dorëzimit është tejkualuar me 10 ditë duke maturuar **penalite në vlerën 93,709 lekë me Tvsh për OE.**

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me kushtet e kontratës, "Afati i lëvrimit dhe marrja në dorëzim.

Ndikimi: Lidhur me mos dorëzimin e barnave sipas afateve të kontratës OE ka maturuar penalite në vlerën **236,148 lekë** pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik.

Shkaku: Mungesa e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **236,148 lekë** pa TVSH, përkatësisht nga kontraktori "M." SHPK, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të Spitalit Rajonal, Korçë, si rrjedhojë e mos lëvrimit të barnave sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

Titulli i Gjetjes: Shpenzime jo të justifikuar në konsumin e karburantit nga autoambulancat

Situata: -Gjatë auditimit të shpenzimeve për konsumin e karburantit nga ambulancat e Spitalit, u konstatuan diferenca të dhënat e dërguara nga Qendra Kombëtare e Urgjencave për lëvizjet e automjeteve të marra nga sistemi GPS me sasi të naftës të marra në dorëzim dhe normativat e konsumit të automjeteve.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, ku citohet:

" Neni 5. Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë

- garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:
- Veprimtarive efektive, eficiente dhe me ekonomi.
- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme të kontratave.

Ndikimi: **Vlera 971,263 lekë përbën dëm ekonomik për Spitalin Rajonal, Korçë.**

Shkaku: Mungesa e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **971,263 lekë**, përkatësisht nga përfituesit, drejtuesit e autoambulancave, të cilët kanë shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të Spitalit Rajonal, Korçë, si rrjedhojë e mos zbatimit të normativave të konsumit të karburantit për autoambulancat që kanë drejtuar gjatë periudhës 2017-2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

-Në lidhje me pagesat institucioni vepron vetëm nëpërmjet llogarisë së Degës së Thesarit, Korçë. Në Spitalin Rajonal, Korçë të ardhurat realizohen dhe arkëtohen nga 5 (pesë) recepsione. Këto 5 pika recepsioni ndodhen në poliklinikën e Spitalit, Maternitet, Urgjenca e spitalit, Senatorium dhe Imazheri.

Mbledhja e të ardhurave bëhet në pikat e recepsionit, nga personat e pa siguruar sipas tarifave të përcaktuara dhe të miratuara nga MSHMS në zbatim të Urdhrit Nr. 28 datë 26.01.2016 Ministrit të Shëndetësisë ” Për zbatimin e sistemit të referimit dhe tarifave të sistemit shëndetësor publik “ si dhe nga tarifave për formular patente, kml, ekzaminime etj.

Nga arkëtaria qendrore bëhet mbyllja ditore e cila i regjistron në mënyrë kronologjike në librin e arkës. Të ardhurat derdhen në banke për llogari të Degës së Thesarit. Të gjitha arkëtimet regjistrohen në ditarin e arkës. Në fund të çdo muaji ekonomistja përpilon evidencën e arkëtimit të ardhurave dytësore sipas sektorëve dhe çdo muaj përgjegjësjë e sektorit të financës kuadron me degën e thesarit duke bërë akt rakordimin për të ardhurat.

Shpenzimet bëhen ndërmjet llogarisë së Thesarit.

Gjatë shqyrtimit të urdhër-shpenzimeve të Degës së Thesarit u konstatuan:

Me vendimin nr. 85/6 prot., datë 15.05.2017 të përmbartësit gjyqësor të shoqërisë “D.”, SHPK, institucioni është detyruar të kryej pagesën për shoqërinë “T. A.” SHA, vlerën 1,796,991 lekë, si dhe vendimin nr.75/19 Prot., datë 15.05.2017 për vlerën 347,832 lekë, më datë 16.05.2017 me urdhër shpenzimit nr. 237. Kjo vlerë ka ardhur sipas pretendimeve se Spitali Rajonal Korçë, ka përdorur shërbimet e kompanisë për disa vjet dhe kishte mbetur papaguar vlerën më sipër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se palët kishin lidhur marrëveshje për ofrimin e shërbimit të telefonisë për punonjësit e Spitalit Rajonal me kontratat e lidhura nga 20.07.2007 deri më 04.04.2008, nga ish drejtori z. I. J. Megjithë pretendimet se faturimi i çdo numri të bëhej në mënyrë individuale, gjykata vendosi në favor të kompanisë.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me VKM nr. 343, datë 11.07.2002, “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë”, i ndryshuar, pasi punonjësit e Spitalit Rajonal Korçë, nuk përfshihen në asnjë nga pikat që ka parashikuar vendimi i mësipërm, duke e kthyer dhe kontratën në të pavlefshme.

Kontrata e lidhur me kompaninë “T.A”, (A.), është në kundërshtim me LPP, si dhe në kundërshtim me VKM nr. 343, datë 11.07.2002, “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë”, i ndryshuar.

Me veprimet apo mosveprimet është shkaktuar një dëm ekonomik prej 2,144,823 lekë.

Z. I. J. mban përgjegjësi për lidhjen e një kontrate të paligjshme, si dhe mos marrjen e masave për mbledhjen e detyrimeve nga personat debitorë në Spitalin Rajonal Korçë.

-Në observacionin e subjektit të audituar me Nr.1111 Prot., datë 03.07.2019 konstatohet se:

Z. I. J. i referohet nenit 29, të Kodit Civil të RSH, duke parashtruar se Spitali Rajonal, Korçë, si një person juridik ka zotësi të kryej çdo veprim juridik të lejuar me ligj, dhe se ka në cilësinë e drejtorit ka lidhur kontratat e sipërpërmendura për të përmirësuar shërbimin dhe lehtësimin e komunikimit të shërbimit mes personelit të spitalit. Duke iu referuar citimeve të tij ky shërbim nuk do të ofrohet personit juridik po personelit të saj, si shërbim ndaj të tretëve pra dhe detyrimi është individual për çdo person. Gjithashtu, z. I. J. citon dhe se ai personalisht nuk ka përfituar shërbimin e telefonisë nga operatori i sipërpërmendur.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë pasi z. I. J. duhet të kishte dijeni se kur firmoste kontrata si drejtor i Spitalit e bënte këtë gjë si përfaqësues ligjor i institucionit duke pasur dhe përgjegjësitë përkatëse dhe jo si person i tretë.

Blerjet me vlerë të vogël

Trajtimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme periudha 2017.

Me shkresën nr. 1334 Prot., datë 09.03.2017, ministri z. I. B. ka autorizuar të gjitha institucionet spitalore për vijimin e procedurave të prokurimit për evadimin dhe trajtimin e mbetjeve spitalore deri në përfundimin e prokurimit të përqëndruar të Ministrisë së Shëndetësisë.

Me shkresën nr. 473 prot., datë 15.03.2017 drejtori znj. E. B., ka ngritur grupin e punës për llogaritjen e fondit limit që do të prokurohet për evadimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore me përbërje znj. E. B., znj. K. B. dhe znj. M. L.. Planifikimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore që kërkojnë trajtim të specializuar, u krye nga kryeinfiermieri i përgjithshëm z. G. N., në sasinë prej 1200 kg për periudhën 2017. Për parashikimin e fondit limit për evadimin për periudhën 3 mujore, grupi i punës u bazua në çmimin e kontratës së vitit 2016, 381.16 lekë/kg, duke rezultuar në vlerën 114,348 lekë pa tvsh dhe 137,218 lekë me tvsh.

Me shkresën nr. 495 prot., datë 17.03.2017, titullari i Ak, ka urdhëruar për prokurimin me vlera të vogla, për evadimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, me fond limit 137,218 lekë me TVSH.

Nga zhvillimi i procedurës së blerjeve me vlera të vogla, komisioni i vlerësimit të ofertave ka zgjedhur ofertën me vlerën më të ulët, të OE "M.", në shumën 99,000 lekë pa TVSH. Më datë 23.03.2017, AK ka lidhur kontratën me OE fitues, me afat 3 mujor.

Me urdhrin nr. 897 prot., datë 28.06.2017, drejtori znj. E. B. ka ngritur grupin e punës i përbërë nga znj. E. B., znj. K. B. dhe znj. M. L. për përllogaritjen e fondit limit.

Në relacionin e përgatitur nga grupi llogaritja e çmimit është kryer mbështetur në kontratën e vitit 2016, kur AK, ka pasur një kontratë të lidhur në 6-mujorin e parë të vitit 2017.

Diferenca në llogaritje nga çmimi 381.16 lekë/kg me 330 lekë/kg, në shumën 30,690 lekë përbën efekt negativ ekonomik për Spitalin Rajonal Korçë.

Lidhur me observacionin tuaj, ku pretendohet se çmimi i kontraktuar më pas, është më i ulët se çmimi i vlerësuar merret pjesërisht në konsideratë, por për këtë arsye nuk u vlerësua si dëm ekonomik.

Me urdhër prokurimin nr. 905 prot., datë 29.06.2017, titullari i AK, znj. E. B. ka urdhëruar kryerjen e procedurës së prokurimit për evadimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, me fond limit 228,696 lekë pa tvsh, me kryetar z. Gj. G., znj. E. M., dhe z. B. H. anëtarë.

Në proces verbalin e mbajtur me datë 04.07.2017, komisioni i ngarkuar për procedurën sa më sipër ka vendosur të shpallë fitues ofertuesin "M." SHPK, me vlerën më të vogël, me 325 lekë/kg, në total në shumën 195,000 lekë pa TVSH ose 234,000 lekë me TVSH.

Më datë 04.07.2017, me nr. 924 prot., u lidh kontrata mes AK dhe OE "M." SHPK, me afat deri më 31.12.2017 dhe me vlerë 234,000 lekë me TVSH.

Pas kërkesës së krye/infermierit të përgjithshëm dhe përgjegjëses së sektorit ambientit për fillimin e procedurave të prokurimit të shërbimit të evadimit të mbetjeve të rrezikshme, më datë 19.01.2018, titullari i AK, z. A. K. më datë 31.01.2018 ka urdhëruar me shkresën nr. 187 prot., fillimin e procedurave dhe ngritjen e komisionit të blerjeve me vlera të vogla, i përbërë nga z. A. L. kryetar, dhe z. Gj. G. e z. B. H. anëtarë, me fond limit 327,000 lekë pa tvsh dhe 393,000 lekë me TVSH.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Nga përzgjedhja doli fitues OE "M." me ofertën 327,500 lekë pa TVSH. Më datë 13.02.2018, titullari i AK, z. A. K., ka lidhur kontratën me nr. 241 prot., me afat deri në 31.12.2018.

Objekti i kontratave sa më sipër është **"Grumbullimi, transporti, trajtimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme, përjashtuar mbetjet me rrezik kimik dhe radioaktiv"**. Në pikën 2, Të drejtat dhe detyrimet e porositësit, (Drejtoria e Shërbimit Spitalor, Korçë), 2.1.2, citohet: *"Të kërkojë informacion për çdo fazë që lidhet me zbatimin e kësaj kontrate. Kur konstatohen shmangie nga kërkesat e paraqitura prej tij, porositësi kërkon zbatimin e tyre."*

Në vendimin Nr.798, datë 29.9.2010, Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore", kreu II, detyrimet e prodhuesve të mbetjeve spitalore, citohet:

5. Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për:

- a) grumbullimin e kontrolluar të mbetjeve spitalore pranë institucionit shëndetësor;
- b) ndarjen e mbetjeve spitalore të parrezikshme (të llojit urban) nga mbetjet spitalore të rrezikshme;
- c) ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe asgjësimin në mënyrë të përshtatshme, të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre;
- d) shpenzimet e transportit, asgjësimit ose riciklimit të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre. Kjo përgjegjësi është e pashmangshme dhe e pavarur nga përgjegjësia e ndonjë personi të tretë të ngarkuar nga prodhuesi, për të ndër marrë këto veprimtari;
- e) **të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre.**

Kreu III, trajtimi i mbetjeve spitalore, pika 8 citon: *"Çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve që nga prodhimi, grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe deri tek asgjësimi i tyre."* 8.10 Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhet me metodat sipas shtojcës 3. 8.11 Impiantet për përpunimin e mbetjeve spitalore respektojnë kushtet e asgjësimit dhe normat e shkarkimeve në ajër të përcaktuara në pikën 5.1.2 "Linja për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe spitalore" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë", si dhe kërkesat specifike sipas shtojcës 5.

-Shtojca 5, Standarde teknike për incenerimin dhe autoklavimin e mbetjeve spitalore.

Standardet teknike për incenerimin e mbetjeve spitalore përfshijnë standardet e përcaktuara në tabelën 6.1 "Krematori" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".

Të gjitha mbetjet spitalore që mund të digjen, duhet të shndërrohen nga inceneratori në hi që nuk përkon me formën e mbetjeve para djegies. Ky hi që rezulton nga djegia, të paktën një herë çdo tre muaj analizohet duke përdorur përzierje kampionaturash të rastit për përmbajtjen e karbonit organik total dhe çdo vit analizohet për përmbajtjen e plumbit, merkurit, kaliumit dhe metaleve të rënda. Hiri që rezulton nga djegia nuk duhet të ketë më shumë se 5% karbon (minimalisht 95% djegie). Mbetja nga djegia ose hiri që përftohet nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore është mbetje e ngurtë dhe asgjësohet në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr. 9010, datë 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta".



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Procesi i sterilizimit nëpërmjet autoklavimit duhet të përfshijë në të njëjtin moment procesin e reduktimit volumor dhe të sterilizimit të mbetjeve spitalore. Sterilizimi duhet të bëhet me avull në temperaturën jo më të vogël se 130°C dhe në presionin jo më të vogël se 1.1 bar.

Pra në zbatim të kushteve, rregullave dhe përgjegjësi që ka prodhuesi i mbetjeve, (Spitali Rajonal, Korçë), duhet të ndjekë deri në fund procesin e asgjësimit, duke marrë evidenca vërtetuese nga kompania e kontraktuar për transportin dhe trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme se operacionet për kryerjen e tyre janë bërë në përputhje me vendimet, standartet dhe rregulloret e aprovuara. Përveç faturës zotëruesi dhe asgjësuesi i mbetjeve duhet të disponojë mënyrën e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, analizat e kampionëve të hirit që përfitohet nga trajtimi i mbetjeve, të kryera sipas kërkesave si dhe të dokumentojë se kjo mbetje e ngurtë është asgjësuar në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”.

Nga verifikimi i urdhër shpenzimeve të pagesave për shërbimin e mësipërm, për periudhën 2017-2018 u konstatua se në shumë raste fatura tatimore ishte lëshuar në datën e marrjes në dorëzim nga komisioni i dorëzimit të mbetjeve, dhe si dokumentacion shoqërues ishin vetëm formularët e dorëzimit dhe transportit të mbetjeve mjekësore.

Objekti i kontratës është dhe trajtimi i mbetjeve dhe jo vetëm marrja në dorëzim dhe transporti si dhe nga kushtet që parashtrajnë udhëzimet sa më sipër dhe pikat e kontratës nga OE nuk janë sjellë dokumentacion vërtetues për trajtimin e mbetjeve të marra në dorëzim.

NR	SUBJEKTI	SHUMA E KONTRATES	SHUMA E LIKUJDUAR në LEK	NR	DATE
1	“M.-T.”	234,000	48,672	390	16.08.2017
			54,483	409	06.09.2017
			41,620	431	11.10.2017
			31,600	490	09.11.2017
			31,434	527	05.12.2017
			26,191	614	27.12.2017
	SHUMA	234,000	234,000		
NR	SUBJEKTI	SHUMA E KONTRATES	SHUMA E LIKUJDUAR në LEK	NR	DATE
2	“M.-T.”	393,000	56,042	62	21.02.2018
			35,409	136	21.03.2018
			80,054	217	16.05.2018
			41,815	217	19.06.2018
			52,623	424	17.08.2018
			21,379	444	06.09.2018
			29,554	488	08.10.2018
			39,536	560	06.12.2018
			36,588	587	19.12.2018
	SHUMA	393,000	393,000		

Për sa më sipër vlera 627,000 lekë përbën shpenzime jo të justifikuar nga OE “M.”SHPK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

Në përgjigje të observacionit dërguar nga subjekti, në lidhje me akt konstatimin e KLSH-së, pretendohet se nga subjekti i kanë ardhur dokumenta të tjerë shtesë.

Në lidhje sa më sipër, ju bëjmë me dije që nuk merret në konsideratë pasi dokumentacioni i sjellë nga OE, nuk plotëson në tërësi kërkesat e parashtruara ligjore të sipërpërmendura.

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës me nr. 617 prot., datë 19.04.2017, lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë "T" SHPK, me objekt "Blerje barna", me vlerë 1,018,247 lekë pa TVSH, me afat lëvrimit deri më 15.12.2017, u konstatua shkelje në afatin e lëvrimit.

Në lidhje me lëvrimet e medikamentit Amikacinë, u konstatuan shkelje të afateve për 20 % e sasisë që duhej të dorëzohej në muajin e parë, për sasinë që duhej të dorëzohej në muajin e dytë si dhe atë të tretë. **Penalitetet e maturuara janë në vlerën 137,463 lekë.**

Në lidhje me lëvrimet e medikamentit Amoksilinë, u konstatuan shkelje të afateve për 20 % e sasisë që duhej të dorëzohej në muajin e parë, për sasinë që duhej të dorëzohej në muajin e dytë si dhe atë të tretë. **Penalitetet e maturuara janë në vlerën 222,996 lekë.**

Vlera 360,459 lekë përbën dëm ekonomik që duhet të dëmshpërblehet nga OE "T."SHPK.

Në përgjigje të observacionit dërguar nga subjekti, në lidhje me akt konstatimin e KLSH-së, ku pretendohet për mënyrën e llogaritjes së penaliteteve, ju bëjmë me dije që nuk merret në konsideratë pasi llogaritjet janë kryer për çdo medikament që duhej të furnizohej, me 25% të vlerës së kontratës, ditët vonesë, si dhe çdo afat të parashikuar në kontratë.

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës me nr. 401 prot., datë 27.02.2017, lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë "M." SHPK, me objekt "Blerje materjale mjekimi për nevojat spitalore", me vlerë 1,561,830 lekë pa TVSH, dhe me vlerë 1,874,196 lekë me TVSH me afat lëvrimit deri më 31.03.2017, u konstatua shkelje në afatin e lëvrimit.

Afatet e zbatimit të kontratës përcaktojnë se të paktën 20 % e sasive të kontraktuara duhet të lëvroheshin brenda 10 ditëve dhe pjesa tjetër brenda muajit mars.

Me faturat nr. 10022, 10029, dhe 10030, të datës 10.03.2017, OE "M." SHPK, ka lëvruar sasi të para të materjaleve të mjekimit.

Afati i dorëzimit është tejkalluar me dy ditë duke maturuar **penalitete në vlerën 142,439 lekë me Tvsh, për OE.**

Me faturën nr. 10164, të datës 19.04.2017, OE "M." SHPK, ka lëvruar sasi të mbetura për 5 materjale të mjekimit.

Afati i dorëzimit është tejkalluar me 10 ditë duke maturuar **penalitete në vlerën 93,709 lekë me Tvsh për OE.**

Vlera 236,148 lekë përbën dëm ekonomik që duhet të dëmshpërblehet nga OE "M."SHPK.

Në përgjigje të observacionit dërguar nga subjekti, në lidhje me akt konstatimin e KLSH-së, ku pretendohet për mënyrën e llogaritjes së penaliteteve, ju bëjmë me dije që nuk merret në konsideratë pasi llogaritjet janë kryer për çdo medikament që duhej të furnizohej, me 25% të vlerës së kontratës, ditët vonesë, si dhe çdo afat të parashikuar në kontratë.

Për sa më sipër mban përgjegjësi, përgjegjësjë e financës znj. A. D.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Lidhur me shpenzimet për konsumin e karburantit nga ambulancat e Spitalit, u verifikuan të dhënat e dërguara nga Qendra Kombëtare e Urgjencave për lëvizjet e automjeteve të marra nga sistemi GPS me sasitë e naftës të marra në dorëzim dhe normativat e konsumit të automjeteve.

Fletë udhëtimet pasi plotësoheshin nga drejtuesi i automjetit dhe përgjegjësi i transportit z. E. R., kishin dhe autorizimin e drejtorit të bashkëlidhur.

Nga shqyrtimi u konstatuan diferencat si më poshtë:

Për periudhën 2017

Targa	Distancat e kryera të matura nga sistemi GPS në km	Normativa e konsumit për 100 km në litra	Sasia e karburantit që duhej furnizuar në litra	Sasia e karburantit e furnizuar në litra	Diferenca e marrë më tepër në litra	Çmimi i karburantit në lekë	Diferenca në lekë
AA512AR	42,214	14.5	7071	7411	340	169	57,401
AA528AR	43,233	14.5	6792	6954	162	169	27,370
KO 4282 B	37,308	14	5361	5624	263	169	44,498
KO 5493 B	37,635	14	5379	5614	235	169	39,740
KO 6789 A	6,110	14	1616	2144	528	169	89,249
KO 7856 A	34,772	14	6389	6756	367	169	62,057
KO 4280 B	40,412	14	6400	6745	345	169	58,305
KO 4281 B	39,750	15.2	6571	6780	209	169	35,346
KO 8018 A	26,671	15.2	3867	4079	212	169	35,828
Totali							449,794

Për periudhën 2018

Targa	Distancat e kryera të matura nga sistemi GPS në km	Normativa e konsumit për 100 km në litra	Sasia e karburantit që duhej furnizuar në litra	Sasia e karburantit e furnizuar në litra	Diferenca e marrë më tepër në litra	Çmimi i karburantit në lekë	Diferenca në lekë
AA512AR	44,288	14.5	7433	7607	174.3	178.9	31,182
AA528AR	42,330	14.5	6353	6645	292.1	178.9	52,257
KO 4280 B	42,200	14	6370	6580	209.6	178.9	37,497
KO 4281 B	34,003	14	5269	5726	457	178.9	81,804
KO 4282 A	38,966	14	5690	6119	428.7	178.9	76,694
KO 5493 B	39,638	14	6162	6436	273.7	178.9	48,965



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

KO 6789 A	6,553	14	2112	2564	452.2	178.9	80,899
KO 7856 A	33,354	15.2	5522	5850	327.7	178.9	58,626
KO 8018 A	29,103	15.2	5541	5840	299.3	178.9	53,545
Totali							521,469

Ambulancat e mësipërme kanë qenë në përdorim nga drejtues të mjetit të organizuar me dy dhe me tre turne, 24 orë, gjatë gjithë javës.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, përgjegjësi i transportit z. E. R. dhe të gjithë drejtuesit e ambulancave që i kanë pasur në përdorim gjatë periudhës 2017-2018.

Vlera 971,263 lekë përbën dëm ekonomik për Spitalin Rajonal, Korçë, që duhet të dëmshpërblehet nga personat përfutës.

Në përgjigje të observacionit dërguar nga subjekti, me nr. 211/4 datë 27.08.2019 në lidhje projektraportin e KLSH-së, ku kundërshtohet mënyra e llogaritjes së konsumit të karburantit duke u mbështetur në të dhënat e sistemit të GPS-së, pasi sipas hartë së qarkut Korçë zona e mbulimit me shërbim e Autoambulancave përfshinë dhe zona shumë të thella ku mbulimi me sinjal GPS është i pamundur e për rrjedhojë nuk reflektohen KM e përkrahura, si dhe nisur nga fakti se keto makina kanë mesatarisht mbi 500,000 km të përshkruara secila, rendimenti i motorit të tyre ka rënë për rrjedhojë nga ana jonë është kryer një testim i ri për normat e konsumit. Ju bëjmë me dije se, për sa më sipër observacioni merret në konsideratë dhe janë reflektuar ndryshimet në pasqyrën e përlllogaritjes së dëmit në konsumin e karburantit sipas normave të konsumit të paraqitura nga ju dhe miratuara nga titullari juaj me shkresën nr. 1379 prot., datë 22.08.2019.

G. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Zbatimi i rekomandimeve bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Në mbështetje të dokumentacionit të vendosur në dispozicion grupit të auditimit nga Spitali Rajonal Korçë rezultoi si më poshtë:

Auditimi i mëparshëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë institucion rezultoi të jetë bërë më datë 03.01.2007, nga ana e institucionit tonë janë lënë rekomandimet përkatëse në të cilën Spitali Rajonal Korçë kthen përgjigje me shkresën nr.169 prot., datë 07.06.2007. Spitali Rajonal Korçë ka pasur auditime të përvitshme nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) si dhe DSHSUKS, raporte të cilat grupi i auditimit i ka marrë në shqyrtim për të krijuar një vlerësim të situatës në këtë institucion. Për ato gjetje dhe rekomandime për të cilat në arsyetimin tonë të pavarur qëndrojnë, nga grupi i auditimit është kryer një auditim më i thellë për të pasqyruar situatën reale të këtij institucioni.

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin e organeve drejtuese, u konstatua se në Spitalin Rajonal Korçë nuk janë krijuar dhe si rrjedhojë as nuk kanë funksionuar organet kryesore drejtuese dhe konkretisht: Këshilli Administrativ, Komisioni Mjekësor, Komiteti për Planifikimin Spitalor Publik të qarkut. Funksionet e këtyre organeve drejtuese kryhen nga Drejtoria e Spitalit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Mos ngritja e Këshillit Administrativ, ka sjellë uljen e besueshmërisë dhe saktësisë së zbatimit të politikave të Ministrisë së Shëndetësisë në Spital, ka krijuar problematika në zbatimin e komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, ka ndikuar në tejkalim të kompetencave e detyrave të drejtorit ekzekutiv.

Mos ngritja e Komisionit Mjekësor në Spitalin Rajonal Korçë ka bërë që Drejtoria e Spitalit të funksionojë pa këshillim teknik lidhur me propozimet për blerjen e pajisjeve mjekësore, vendimet që përfshijnë aspektet mjekësore të punës si dhe rregullat e organizimit të shërbimeve mjekësore të institucionit.

Mungesa e Komitetit për Planifikimin Spitalor ka sjellë mangësi në hartimin dhe raportimin e planit spitalor.

Statusi konkret juridik i Spitalit Rajonal Korçë paraqitet i paqartë pasi kategorizimi i pagave të personelit administrativ dhe atij spitalor të kësaj qendre, e cila konsiderohet Spital Rajonal, është i njëjtë me të gjitha spitalet e tjera të Bashkive. Pra, Spitali Rajonal Korçë kategorizohet në të njëjtin rang juridik si spitalet e tjera të nivelit bashkiak dhe kjo ndikon tek pagat e personelit në kuptim negativ.

Struktura analitike, organizative dhe administrative, e cila vjen e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë është e njëjtë si për Spitalin Rajonal Korçë që ligjërisht organizohet si Spital Rajonal, ashtu edhe për Spitalet e Qarkut që organizohen si spitale bashkiake. Miratimi i tarifave të shërbimeve bëhet me urdhër të brendshëm të titullarit të Institucioni (Drejtori), në mungesë të Këshillit Administrativ.

Nga auditimi i strukturës analitike të sistemit spitalor Korçë miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me nr. 1369 prot., datë 10.03.2017 rezulton se në 2 raste emërtimet në këtë strukturë nuk përputhen me ato të nenit 18 të Ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 të ndryshuar

Struktura e Auditit të Brendshëm në Spitalin Rajonal Korçë përbëhet nga më pak se 3 (tre) punonjës dhe varësia e saj nga Drejtoria e Spitalit ka çënuar parimin e pavarësisë, misionin, funksionimin dhe të drejtat e auditit të brendshëm në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe pikën 3 të vendimit nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”(Më hollësisht trajtuar në pikën D, në faqet 90-93 të Raportit të Auditimit).

1.1- Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal Korçë të marrë masa për ti kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Instancave të tjera kompetente, përcaktimin konkret të statusit juridik që duhet të ketë ky Spital, në lidhje me funksionimin dhe aktivitetin e Tij.

1.2- Ministria e Shëndetësisë të marrë masa dhe të përcaktojë qartë statusin juridik të Spitalit Rajonal Korçë, si dhe të orientojë Drejtorinë e Spitalit për ndjekjen e rregullave dhe procedurave për ngritjen e organeve ndihmëse Drejtuese.

Menjëherë dhe në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

2.-Gjetje nga auditimi: Nga ana e strukturave drejtuese të Spitalit Rajonal Korçë nuk është implementuar Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ky ligj nuk njihet nga strukturat drejtuese të institucionit e punonjësit e tij, nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Spitali Rajonal Korçë, nuk ka të përcaktuar misionin, strategjinë dhe objektivat, në hartimin e planeve konkrete të veprimit, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Në këtë institucion stafi drejtues nuk ka njohje të ligjit dhe koncepteve të tij. Nëpunësi autorizues është Drejtori i Spitalit, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e programit ekonomik. Nga drejtimi i institucionit nuk njihen komponentët e MFK me qëllim zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë për menaxhimin e riskut.

Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues nuk janë emëruar sipas mënyrës dhe përcaktimeve të nenit 9 dhe 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiare dhe kontrollin*”.

Nuk është përgatitur “*Deklarata e cilësisë*” dhe Raporti përkatës për vitet 2017-2018, për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, e cili e ka afatin deri në fund të muajit Shkurt të vitit pasardhës.

Nuk është përgatitur pyetëtori i vetëvlerësimit për vitet 2017 dhe 2018 në funksion të realizimit të 5 fushave të kontrollit në të cilat funksionon Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli. Spitali Rajonal Korçë nuk ka të përcaktuar koordinatorin e riskut, njësia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut.

Kjo njësi publike nuk ka të miratuar, një plan afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit të të gjithë niveleve të njësisë publike dhe përgatitjen e gjurmëve të auditimit për procedurat specifike të njësisë, bazuar në kërkesat e Kreut III të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 të ndryshuar.

Njësia nuk ka të përcaktuara procedura të brendshme të anti-korrupsionit dhe të sinjalizimit të parregullsive referuar nenit 8, pika 8 /e dhe nenit 17 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 të ndryshuar.

Spitali Rajonal Korçë për vitet 2017 dhe 2018 ka funksionuar nëpërmjet Rregullores së Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Dytësor 2007, ndryshuar me nr. 4884/1, dt. 28.01.2008 dhe Rregullores së Brendshme të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2013. Për periudhën objekt auditimi, njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” të ndryshuar. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “*Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike*”. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr 16, datë 20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”, Urdhrit të Ministrit të Financave 108, datë 17.11.2016, “*Për miratimin e Manualit për MFK*” (Më hollësisht trajtuar në pikën A, në faqet 15-20 të Raportit të Auditimit).

2.1- Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Rajonal Korçë të marrë masa për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues i ligjit të MFK dhe komponentëve të tij, për implementimin e ligjit në të gjitha nivelet, për hartimin e një plan-veprimi, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë menaxhimin e riskut. Në planet konkrete të veprimit të përcaktohen misioni, strategjia dhe objektivat e çdo sektori, të kryhen analiza të detajuara të riskut në çdo sektor duke përcaktuar afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.-Gjetje nga auditimi: Nga vlerësimi i aktiviteteve të auditit të brendshëm në Spitalin Rajonal Korçë, rezulton se struktura e auditit të brendshëm të Spitalit Rajonal Korçë nuk është e plotë por operon me 1 auditues dhe në kushtet e një strukture jo të qartë nuk mund të përmbushin misionin dhe objektivat e tyre.

Për vitin 2017, njësia e auditit të brendshëm nuk ka zhvilluar asnjë auditim duke mos përmbushur detyrën në zbatim të planit vjetor të auditit të brendshëm.

Për vitin 2018, njësia e auditit të brendshëm të Spitalit Rajonal Korçë nuk ka hartuar e miratuar një plan vjetor auditimi.

Auditi i brendshëm i Spitalit Rajonal Korçë ka kryer një auditim mbi karburantin dhe lëndët djegëse mbi bazën e programi auditimi miratuar me shkresën nr. 634 prot., datë 28.05.2018, i cili nuk është miratuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Korçë.

Për vitet 2017 dhe 2018 nga auditimi i brendshëm i Spitalit Rajonal Korçë nuk janë hartuar Karta e Auditit të Brendshëm dhe Kodi i Etikës të auditit të brendshëm. Për periudhën objekt auditimi, auditimi i brendshëm i Spitalit Rajonal Korçë ka zhvilluar gjithsej vetëm dy auditime, përkatësisht në qershor dhe në gusht 2018.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" (Më hollësisht trajtuar në pikën A, në faqet 15-20 të Raportit të Auditimit).

3.1- Rekomandimi: Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Korçë dhe Njësia e Auditit të Brendshëm të analizohet situata dhe të nxirren përgjegjësitë si dhe, të merren masa për krijimin e një strukture të plotë të auditit të brendshëm për përmbushjen e rolit të auditimit të brendshëm në dhënien e mbështetjes së titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve vjetore të auditimit, hartimin e Kartës së Auditit të Brendshëm dhe Kodit të Etikës si dhe formulimin e raporteve të auditit konform kërkesave të manualit të auditimit të brendshëm me të gjithë elementët përbërës të tij.

Në vazhdimësi

4.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i buxhetit në zërit debitorë të ndryshëm, rezulton se shuma për tu paguar në fund viti 2018 është 30,319,970 lekë. Këto detyrime i takojnë furnizimeve me medikamente dhe materiale mjekimi të lëvruara gjatë periudhës 2018 për të cilat nuk është kryer pagesa në vlerën 23,186,070 lekë, detyrimeve të krijuara në proceset gjyqësore për punonjës të larguar dhe ankimimeve nga ish-pacientë në vlerën 5,585,366 lekë, si dhe furnitorë të tjerë në vlerën 1,548,534 lekë. Nga departamenti i financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, janë dërguar situacionet në Degën e Thesarit në afatet kohore përkatëse, por likuidimi i tyre është vonuar. Më datë 16.01.2019, me shkresën nr. 96, institucioni i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Mos veprimet në kohën e duhur për pagesën e borxheve, sjellin kalimin e afateve ligjore si dhe përbëjnë rrisqe potenciale me dëme për Buxhetin e Shtetit (Më hollësisht trajtuar në pikën B, në faqet 20-36 të Raportit të Auditimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

4.1-Rekomandim: Drejtori i Spitalit Rajonal dhe Departamenti i Financës, të marrin masa për ndjekjen e procesit të likuidimit të situacioneve të furnitorëve, në të gjitha fazat e tij, për të respektuar afatet ligjore të pagesave sipas përcaktimeve të kontraktuara, për të evituar krijimin e situatave debitore në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë pagesave të Spitalit Rajonal Korçë janë konstatuar problematika në lidhje me përditësimin e bazës ligjore të aplikuar me pasojat e më poshtme:

-llogaritjen e pasaktë ose mos përditësimin e vjetërsisë në punë duke shkaktuar diferenca pozitive dhe negative. Diferencat negative tregojnë se punonjësit janë paguar më shumë se sa niveli i tyre arsimor, Diferencat pozitive tregojnë se janë paguar më pak se niveli i tyre arsimor

- mos përcaktim të saktë të pagës së grupit

- mos unifikim të pagës së grupit për të njëjtët punonjës për të njëjtat pozicione pune, për të njëjtat nivele arsimore nga muaji në muaj e cila ka krijuar diferenca pozitive dhe negative në pagën e grupit dhe për pasojë edhe në pagën totale bruto.

- llogaritje e pasaktë e pagës bazë mujore.

Të gjitha këto problematika kanë sjellë **efekt negativ financiar** në vlerën **148,546 lekë** dhe janë në kundërshtim me VKM nr. 188 datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar”, Lidhja nr. 1 (Kreu 1.3) dhe Lidhja nr. 2 (Kreu 2.3) e cila shërben për llogaritjen e pagës së pozicionit, shtesës për kushtet e punës dhe nivelit të vjetërsisë duke u bazuar gjithashtu në librezat e punës dhe dosjet individuale të këtyre punonjësve, Lidhja nr. 3 për përcaktimin e pagës së grupit (*Më hollësisht trajtuar në pikën E në faqet 93-103 të Raportit të Auditimit*).

5.1-Rekomandime: -Nga Departamenti i Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Spitalit Rajonal Korçë të merren masa për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive si dhe të ri-strukturimin e mënyrës së përlllogaritjes të pagave për çdo të punësuar në Spital duke rritur transparencën në afrimin e informacionit përkatës për të gjithë komponentët e pagës, duke shënuar pagën e grupit sipas nivelit arsimor përkatës, vitet e punës në numër dhe në vlerë, pozicionin e punës sipas emërimit përkatës të gjithë secilit, si dhe pagën e sektorit në përputhshmëri të plotë me bazën referuese ligjore duke u përditësuar në kohë me ndryshimet e mundshme ligjore.

Në vazhdimësi

6.-Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit me zgjedhje të likuidimeve nëpërmjet bankës rezultoi se gjatë viteve 2017 dhe 2018 janë pranuar dhe likuiduar nga komisioni i pritjes së mallit barna, kite dhe reagente të cilat e kanë pasur afatin e skadencës më të vogël se 1 vit, veprim që bie në kundërshtim me DST të paraqitura në procedurën e prokurimit dhe në kontratën e nënshkruar mes palëve neni 4 “Kushtet e furnizimit” si dhe në dokumentet standarde të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe APP, ku përcaktohet se afati minimal i skadencës për pranimin e barnave është 12 muaj edhe pse në vlera apo sasi të vogla të cilat janë konsumuar para afatit të skadimit përbjnë shkelje të bazës ligjore në fuqi (*Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 103-114 të Raportit të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

6.1-Rekomandime: Nga Drejtoria e Spitalit të analizohen shkaqet dhe nxirren përgjegjësitë si dhe nga komisionet e marrjes në dorëzim të barnave, kite dhe reagente të zbatohen me përpikëri marrja e tyre konform të gjithë kërkesave dhe specifikimeve teknike të kontraktuara. Nga AK duhet që, konform legjislacionit në fuqi, politikat e nevojave për mallra emergjente të jenë pjesë e procedurave të menaxhimit të fondeve dhe procedurave të prokurimit, të ndara nga praktikat e plotësimit të kërkesave të operatorëve konform përcaktimeve kontraktuale, duke monitoruar dhe shmangur çdo rast të pranimit të barnave, kiteve dhe reagenteve nën afatet e kontraktuara të skadencës dhe argumentuar ato si pasojë e nevojës emergjente.

Në vazhdimësi

7.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua se:

-Për vitin 2017 janë realizuar 26 procedura prokurimi, ngatë cilat janë audituar 9 procedura ose 34 %, në vlerë nga 111,056,636 lekë janë audituar 52,849,123 lekë ose 47%.

Për vitin 2018 janë audituar 101,019,900 lekë shpenzime, ku 53,915,472 lekë e zënë investimi në furnizim vendosje paisjesh mjeksore ose 45% e totalit të shpenzimeve.

-Nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 83/2.

- Në 5 raste nga procedurat e audituara, nuk konstatohet të jetë argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Në 6 raste, zbatimi i kontratave për mallra, shërbime dhe punë, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 60, pika 1

-Në 2 raste, janë kryer dy furnizimi me medikamente jo në përputhje me specifikimet teknike duke e patur afatin e skadencës më të vogël se 12 muaj (*Trajtuar më hollësisht në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit*).

7.1-Rekomandime: Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomikë dhe ofertave të ofertuesve duke marrë masa për trajnimin e stafit mbi prokurimet publike, me qëllim rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike.

Të mërren masa dhe të zhvillohen procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara për plotësimin e nevojave të saj. Gjithashtu, duhet të merren masat përkatëse, lidhur me zbatimin e kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues, sipas kushteve të rënë dakord midis palëve.

Vazhdimisht

8.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël "Trajtimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme periudha 2017", u konstatua se, grupi i punës i ngritur për llogaritjen e fondit limit, me urdhrin nr. 897 Prot, datë 28.06.2017, ka kryer llogaritjen e çmimit për këtë procedure mbështetur në kontratën e vitit 2016, ndërkohë që AK ka pasur një kontratë të lidhur në 6-mujorin e parë të vitit 2017 me një diferencë në përlllogaritjen e fondit limit në shumën prej 30,690 lekë vlerë e cila përbën efekt financiarë negativ për buxhetin e shtetit, veprime këto në kundërshtim me nenin 59 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit*).

8.1-Rekomandime: Të merren masa nga drejtimi i institucionit, që përlogaritja e vlerave të kontratave të kryhet duke verifikuar me përgjegjshmëri të gjitha mundësitë që i ofrohen institucionit, dhe duke marrë në analizë kontratat e mëparshme dhe alternativat më të mira nëpërdorimin me efikasitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9.-Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 341 prot., datë 07.03.2018, lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë “V. S.” SHPK, me objekt “Shërbim me roje private Spitali Korçë”, me afat shërbimi nga 01.03.2018 – 31.03.2019, si dhe nga verifikimi i librave të ndërrimit të turneve u konstatua se:

-Ka punonjës të cilët kanë kryer shërbimin e rojeve mbi 40 orë në javë ose mbi 22 ditë pune në muaj, në kundërshtim me ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Kreu IX, Pika.

-Ka punonjës që kanë ofruar shërbimin e rojeve të cilët nuk janë paguar sipas ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik në DST ku cilësohet se kohëzgjatja maksimale e punës në muaj për çdo roje është 174 orë në muaj. Kjo situatë ka sjellë shfrytëzimin e tyre në punë dhe mos respektim të kushteve të ofertuara dhe të kontraktuara të procedurës së prokurimit për këtë shërbim (*Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit*).

9.1-Rekomandime: Nga ana e drejtoris së spitalit grupit të monitorimit të kontratave të marrë masa për verifikimin e shërbimit të rojeve për çdo vendroje, të kushteve të punës dhe pagesës për çdo roje, të verifikojë librat e ndërrimit të turneve për çdo vendroje në “Spitalin Rajonal Korçë” të mbuluar me shërbim nga operatori ekonomik “V.” S., pasi nga sa trajtuar më sipër ky operator nuk respekton kushtet e vendosura në kontratë duke i mbajtur rojet në shërbim përtej afateve maksimale, të kryejë identifikimin e rasteve të tjera të tejkalimit të kohëzgjatjes në punë dhe shfrytëzimin e punonjësve për të punuar përtej afateve maksimale të lejuara në Kodin e Punës dhe në ofertën e prokuruar të shërbimit të rojeve për 174 orë/muaj ose 22 ditë në muaj si dhe të kryejë procedurat e duhura për marrjen e masave ligjore mbi shkeljet e konstatuara të këtij operatori ekonomik.

Deri më 31.12.2019

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.-Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 341 prot, datë 07.03.2018, lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë “V. S.” SHPK, me objekt “Shërbim me roje private Spitali Korçë”, me vlerë 1720 lekë/ditë për roje ose 20,089,600 lekë si vlerë totale e kontratës pa tvsh, me afat shërbimi nga 01.03.2018 – 31.03.2019, u konstatua se:

Nga verifikimi i listë pagesave punonjësit e ofrimit të shërbimit të rojeve në Spitalin Rajonal Korçë paguhen me 36,000 lekë në muaj pagë bazë pa përfshirë shtesat e përcaktuara për këtë pozicion pune ku sipas ofertës dhe kontratës duhet të paguheshin me 50,146 lekë pagë në muaj.

Operatori ekonomik “V. S.” ka përfituar padrejtësisht 14,146 lekë në muaj nga secili punonjës shërbimi dhe në total **shumën e pagave bruto prej 5,432,064 lekë** për 32 punonjës për 12 muaj të papaguara ndaj punonjësve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Për pasojë operatori ka shmangur detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për pagat e papaguara në shumën **1,515,264 lekë**, si dhe detyrimin për Tatimin mbi të ardhurat personale në shumën **705,792 lekë**, vlera të cilat përbëjnë shmangie të detyrimeve dhe **dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit** (Më hollësisht trajtuar në pikën C, në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit).

1.1-Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore kryerja e pagesës prej **7,653,120 lekë** nga të cilat vlerën prej **5,432,064 lekë** ndaj 32 punonjësve duke i mbajtur detyrimet tatimore përkatëse, të cilët ofrojnë shërbimin e rojeve duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për përfitim të drejtë të pagës sipas kushteve të ofertës së tenderuar dhe kontratës së kontraktuar mes operatorit ekonomik dhe Spitalit Rajonal Korçë.

1.2- Të kryhet pagesa e sigurimeve shoqërore, shëndetësore **1,515,264 lekë** dhe pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale (TAP) **705,792 lekë** të pallogaritura e të papaguara, sipas kushteve të kontratës.

1.3-Të njoftohen Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Inspektorati Shtetëror i Punës për analizimin e situatës, kushteve të ngjarjes dhe marrjen e masave përkatëse për subjektin “V. S.”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.-Gjetje nga auditimi:- Në kontratën e furnizimit; **“Furnizim vendosje pajisje mjekësore dhe pajisje mobilimi spitalor” për Spitalit Korçë me vlerë kontrate 5,582,450 lekë** pa TVSH dhe operatorë ekonomik fitues “O. D.” u konstatua se ky operator i ka kryer furnizimet përtej afateve të parashikuara në kontratë nr. 955 Prot., datë 17.08.2018 dhe në shkelje të nenit nr. 3 afati i kontratës i cili është 45 ditë me afat përfundimi 18.10.2018, si dhe nga mos llogaritjen e penaliteve në respektim të nenit 5 “kushtet e kontratës” ku citohet: *...Në rast se kontraktuesi vonon furnizimin sipas kërkesave të institucionit atëherë detyrohet të paguaj penalitet në masën, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës së mbetur pa furnizuar...Nga furnizimi përtej afatit të miratuar operatorit ekonomik “O. D.” i lind detyrimi të shlyej penalitet në vlerën 1,451,235 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit .*

Ky operator ka furnizuar me produkte pa asnjë origjinë dëshmuuese e vërtetuese për origjinalitetin e tyre, mungesa e tyre në katalogun e produkte të kompanisë prodhuese të deklaruar nga “O. D.” dhe mos identifikimi të asnjë të dhëne për origjinalitetin e tyre nga prodhuesi, si dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, **në vlerën 1,751,448 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit** dhe duhen zëvendësuar me produktet e kërkuara dhe deklaruar në procedurën e prokurimit (Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit).

2.1-Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **3,202,683 lekë**, nga të cilët 1,451,235 lekë si penalitet i mos furnizimit nëafat të paisjeve dhe 1,751,448 lekë si paisje të furnizuara jo nëpërputhje me katalogun e deklaruar në procedurën e prokurimit, përkatësisht nga shoqëria **“O. D.” SHPK** deri në zëvendësimin e plotë të paisjeve.

Deri më 31.12.2019

3.-Gjetje nga auditimi: Me vendimin nr. 85/6 Prot., dhe nr. 75/19 Prot., datë 15.05.2017 të përmbaruesit gjyqësor të shoqërisë “D.”, SHPK, institucioni është detyruar të kryej dy pagesa për shoqërinë “T.A.” SHA përkatësisht në vlerën 1,796,991 lekë datë 15.05.2017 dhe në vlerën 347,832 lekë datë 16.05.2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

Këto detyrime kanë lindur nga kontrata e lidhur midis Spitalit Rajonal Korçë me shoqërinë “T.A.” SHA, për Kontratën Kolektive për përdorimin e shërbimit të telefonisë së lëvizshme në periudhën 20.07.2007 deri më 04.04.2008. Nga mos likuidimi i faturave nga përdoruesit e numrave shoqëria “T.A.” SHA ka kërkuar shlyerjen e detyrimit nga Spitali Rajonal Korçë si nënshkrues i kontratës dhe jo nga përdoruesit, lidhja e kontrate nga ish drejtori z. I. J. është bërë në kundërshtim VKM nr. 343, datë 11.07.2002, “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë”, i ndryshuar, duke shkaktuar për institucionin **dëm ekonomik në vlerën 2,144,823 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën F, në faqet 103-114 të Raportit të Auditimit).

3.1-Rekomandime: Të kërkohe në mënyrë ligjore, duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës prej **2,144,823 lekë** nga përdoruesit e këtyre numrave, vlerë e cila ka ardhur si rezultat i lidhjes së kontratës së shërbimit të telefonisë me shoqërinë “T.A.” SHA.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4.-Gjetje nga auditimi:- Gjatë auditimit të shpenzimeve për konsumin e karburantit nga ambulancat e Spitalit, u konstatuan diferenca të dhënat e dërguara nga Qendra Kombëtare e Urgjencave për lëvizjet e automjeteve të marra nga sistemi GPS me sasitë e naftës të marra në dorëzim dhe normativat e konsumit të automjeteve, veprime në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, duke sjell një **dëm ekonomik** për Spitalin Rajonal Korçë, në vlerën **971,263 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën F, në faqet 103-114 të Raportit të Auditimit).

4.1-Rekomandime: Të kërkohe në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës prej **971,263 lekë**, përkatësisht nga përfituesit, drejtuesit e autoambulancave, të cilët kanë shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të Spitalit Rajonal, Korçë, si rrjedhojë e mos zbatimit të normativave të konsumit të karburantit për autoambulancat që kanë drejtuar gjatë periudhës 2017-2018.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5.-Gjetje nga auditimi:- Në kontratën e furnizimit; **“Furnizim vendosje pajisje biomjeksore dhe pediatrike” për Spitalit Korçë me vlerë kontrate 25,087,510 lekë** pa TVSH dhe operatorë ekonomik fitues “B. A.” dhe “M.” u konstatua se; Nga furnizimi me vonesë në mosrespektim të kontratës nr. 1570/1 datë 02.10.2018 neni 2 i saj, “Afati i lëvrimit’ ku në pikën 2.4 citohet; *Nëse furnizuesi vonon lëvrimin e mallit në depon e blerësit , përtej afateve kohore të përcaktuara në kontratë, do ti paguaj blerësit penalitet prej 4/1000 të vlerës së mallit të pa lëvruar për çdo ditë vonesë, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.* Nga llogaritja e ditë vonesave për furnizimi nga operatori ekonomik atij i lind detyrimi ndaj SRK në vlerën **752,625 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik, dhe duhet paguar nga operatori ekonomik “M.” dhe “B. A.”** (Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit).

5.1-Rekomandime: Të kërkohe në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës prej **752,625 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “M.” SHPK vlera **351,225 lekë** dhe nga shoqëria “B. A.” vlera **401,400 lekë** si furnizime përtej afatev të miratuara në DST dhe kontratën mes palëve.

Deri më 31.12.2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

6.-Gjetje nga auditimi:- Nga verifikimi i zbatimit të kontratës me nr. 617 prot., datë 19.04.2017, lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë “ T.”, SHPK, me objekt “Blerje barna”, me vlerë 1,018,247 lekë pa TVSH, me afat lëvrimi deri më 15.12.2017, u konstatua shkelje në afatin e lëvrimin. Në lidhje me lëvrimet e medikamentit Amikacinë, u konstatuan shkelje të afateve për 20 % e sasisë që duhej të dorëzohej në muajin e parë, për sasinë që duhej të dorëzohej në muajin e dytë si dhe atë të tretë. Penalitetet e maturuara janë në vlerën 137,463 lekë. Në lidhje me lëvrimet e medikamentit Amoksilinë, u konstatuan shkelje të afateve për 20 % e sasisë që duhej të dorëzohej në muajin e parë, për sasinë që duhej të dorëzohej në muajin e dytë si dhe atë të tretë. Penalitetet e maturuara janë në vlerën 222,996 lekë.

Lidhur me mos dorëzimin e barnave sipas afateve të kontratës OE ka maturuar penalitete në vlerën **360,459 lekë** pa TVSH, e cila përbën **dëm ekonomik** (*Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 103-114 të Raportit të Auditimit*).

6.1-Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **360,459 lekë** pa TVSH, përkatësisht nga kontraktori “T.” SHPK, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të Spitalit Rajonal, Korçë, si rrjedhojë e mos lëvrimin të barnave sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7.-Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 401 prot., datë 27.02.2017, lidhur nga Spitali Rajonal Korçë me shoqërinë “M.” SHPK, me objekt “Blerje materiale mjekimi për nevojat spitalore”, me vlerë 1,561,830 lekë pa tvsh, dhe me vlerë 1,874,196 lekë me tvsh me afat lëvrimi deri më 31.03.2017, u konstatua shkelje në afatin e lëvrimin. Afatet e zbatimit të kontratës përcaktojnë se të paktën 20 % e sasive të kontraktuara duhet të lëvroheshin brenda 10 ditëve dhe pjesa tjetër brenda muajit mars. Me faturat nr. 10022, 10029, dhe 10030, të datës 10.03.2017, OE “M.” SHPK, ka lëvruar sasi të para të materialeve të mjekimit. Afati i dorëzimit është tejkaluar me dy ditë duke maturuar penalitete në vlerën 142,439 lekë me Tvsh, për OE. Me faturën nr. 10164, të datës 19.04.2017, OE “M.” SHPK, ka lëvruar sasi të mbetura për 5 materiale të mjekimit. Afati i dorëzimit është tejkaluar me 10 ditë duke maturuar penalitete në vlerën 93,709 lekë me Tvsh për OE.

Lidhur me mos dorëzimin e barnave sipas afateve të kontratës OE ka maturuar penalitete në **vlerën 236,148 lekë pa Tvsh**, e cila përbën **dëm ekonomik** (*Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 103-114 të Raportit të Auditimit*).

7.1-Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **236,148 lekë** pa Tvsh, përkatësisht nga kontraktori “M.” SHPK, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të Spitalit Rajonal, Korçë, si rrjedhojë e mos lëvrimin të barnave sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8.-Gjetje nga auditimi:- Në kontratën e furnizimit; **“Furnizim vendosje pajisje salle operatore” për Spitalit Korçë me vlerë kontrate** 14,259,600 lekë pa TVSH dhe operatorë ekonomik fitues “M.” u konstatua se; Nga furnizimi me vonesë në mos respektim të kontratës nr. 1569/1 datë 02.10.2018 neni 2 i saj, “Afati i lëvrimin’ ku në pikën 2.4 citohet; *Nëse furnizuesi vonon lëvrimin e mallit në depon e blerësit, përtej afateve kohore të përcaktuara në kontratë, do ti paguaj blerësit penalitet prej 4/1000 të vlerës së mallit të pa lëvruar për çdo ditë vonesë, por kjo vlerë do të*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

*llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës. Nga llogaritja e ditë vonesave për furnizimi nga operatori ekonomik atij i lind detyrimi ndaj SRK në vlerën **242,413 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik, dhe duhet paguar nga operatori ekonomik “M.”** (Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit).*

8.1-Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **242,413 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “M.” SHPK si furnizime përtej afatev të miratuara në kontratën mes palëve.

Deri më 31.12.2019

9.-Gjetje nga auditimi:-Nga auditimi i ushtruar mbi procedurën ‘Blerje barna Antineoplastik dhe immunomodularë, hormonale, sistematike, dhe gjaku dhe organet formuese të gjakut, e ndarë në lotë’ me afat furnizimi prej 4 muajsh, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 182,135 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e mallit, mbi penalitetet të pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik “A.” (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqet 36-90 të Raportit të Auditimit).

9.1-Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **182,135 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “A.” si furnizime përtej afatev të miratuara në kontratën mes palëve.

Deri më 31.12.2019

10.-Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i ushtruar mbi procedurën “Blerje medikamente për nevojat spitalore viti 2017” me afat furnizimi deri më datë 31.03.2017, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 34,446 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e mallit, mbi penalitetet të pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik “F.” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit).

10.1-Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **34,446 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “F.” SHPK si furnizime përtej afatev të miratuara në kontratën mes palëve.

Deri më 31.12.2019

11.-Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje lëndë djegëse pelet” dhe furnizim me kaldaja për ngrohejn e spitalit, për periudhë Prill –Tetor nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është llogaritur qiraja për zënia e hapësirës nga ana e kaldajave në referencë të vkm nr. 54 datë 05.02.2014 “Për dhënien me qira ose enfiletozë të pasurive shtetërore”, sipërfaqja e zënë sipas inventarit të pronave $75 \text{ m}^2 \times 150 \text{ lek/m}^2 = 11,250 \text{ lekë} \times 7 \text{ muaj} = \mathbf{78,750 \text{ lekë}}$, **vlerë e cila përbën dëm ekonomik** (Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit).

11.1-Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **78,750 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “I” SHPK.

Deri më 31.12.2019



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë pagesave të spitalit janë konstatuar problematika në lidhje me emërimet e paqarta për pozicione pune të strukturës mbështetëse në kundërshtim me Vendim nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” pika 18/1 për shtesat që përfitojnë shoferët e urgjencës së spitaleve për natyrë të veçantë pune.

-Nga auditimi i proceseve gjyqësore të largimeve nga puna për periudhë objekt auditimit në Spitalin Rajonal Korçë janë dëmshpërblyer pas fitimit të procedurave gjyqësore dy punonjës të cilët kanë përfituar në total **911,067 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar** për buxhetin e shtetit.

-Nga auditimi i listë pagesave në aplikimin të pagës së grupit pas ndryshimeve ligjore në mars 2017 për pozicionet e Infermierit u konstatuan mos aplikime të sakta të pagës së grupit në muajin Maj 2017 me një **efekt financiar negativ në vlerën prej 645,955 lekë**, si pasojë mos aplikimit të saktë të pagës së grupit është shkaktuar një rritje e pasaktë në përfitimin e vjetërsisë në punë në masën **148,546 lekë vlerë e cila përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e shtetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën Y në faqet 93-103 të Raportit të Auditimit*).

1.1-Rekomandime: -Nga sektori i Financës dhe ekonomisti i pagave të Spitalit Rajonal Korçë të merren masa për shqyrtimin e efektit negativ financiar në vlerën totale **916,067 lekë** të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna, të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës me qëllim shmangien e krijimit të problematikave në paga dhe të efekteve negative.

-Nga Drejtimi i Spitalit Spitalit Rajonal Korçë dhe Sektori Juridik, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimi i detyrimeve të shtuara përmbare, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për buxhetin e Spitalit

1.2-Rekomandime: -Nga Drejtimi i Spitalit Spitalit Rajonal Korçë sektori i burimeve njerëzore të merrin masa për trajnimin e stafit, marrjen në kohë të informacioneve për ndryshimet ligjore si dhe nga sektori i personelit dhe ekonomisti i pagave të Spitalit Rajonal Korçë të merren masa për shqyrtimin e efektit negativ financiar në vlerën totale **645,955 lekë** të ardhur si pasojë e mos aplikimit të saktë të pagës së grupit dhe shtesës së vjetërsisë në punë në vlerën **148,546 lekë** për mënjanimin e situatave të tilla dhe mbarëvajtjen e punës.

Në vijimësi

2.-Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i rregullshmërisë së shpenzimeve, evidentimit dhe njohjes së detyrimeve që SRK ka ndaj të tretëve rezultoi se:

-Në vitin 2018 nga ana e Spitalit Rajonal Korçë në zbatim të vendimit të gjykatës është dëmshpërblyer familja Ll. për mjekim të pakujdesshëm të mjekut me pasojë humbje jete të pacientit në vlerën **6,725,476 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e shtetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën F në faqet 103-114 të Raportit të Auditimit*).

2.1-Rekomandime: Nga Drejtori i Spitalit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirqënies Sociale të bëjnë të mundur trajnimin dhe kualifikimin në mënyrë të vazhdueshme stafi mjekësorë me përditësimet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

e fundit në shkencën e mjekësisë për ofrimin e një shërbimi sa më korrekt ndaj pacientëve për të shmangur ngjarje të tilla.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.-Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i rregullshmërisë së shpenzimeve, evidentimit dhe njohjes së detyrimeve që SRK ka ndaj të tretëve rezultoi se:

Nga lidhja e kontratës në fund të vitit buxhetorë si pasojë e nevojës emergjentë me operatorin ekonomik "J. F." dhe mos pranimi për likuidim nga thesari i kontratës me vlerën 3,048,007 lekë për furnizim me oksigjen, operatori ekonomik ka kërkuar nëpërmjet gjykatës shlyerjen e detyrimit nga ana e Spitalit Rajonal Korçë për vlerën **3,048,007 lekë** e cila përbën efekt finaciare negativ për buxhetin aktual të Spitalit (*Më hollësisht trajtuar në pikën F në faqet 103-114 të Raportit të Auditimit*).

3.1-Rekomandime: Nga Drejtori i Spitalit, Sektori Juridik, të analizohen në mënyrë të detajuar kushtet dhe afatet e lidhjes së kontratave për të shmangur rastet e ngjashme dhe për të mënjanuar shpenzimet shtesë përmbartimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale dhe të merren vendimet përkatëse, pasi shumat e mësipërme janë në vlera të konsiderueshme për institucionin dhe buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4.-Gjetje nga auditimi:- Në procedurën e prokurimit "*Largim, përpunim i mbeturinave dhe pastrim i territorit nga dëbora, Spitali Korçë*", për vitet 2017 dhe 2018, u konstatua se grupi i punës i ngritur nga titullari i AK, për përcaktimin e fondit limit nuk e ka argumentuar dhe dokumentuar kohën e punës për ngarkimin dhe klorifikimin e kontenierëve. Mënyra e llogaritjes me kohë pune nuk është në përputhje me njësinë e matjes së sasisë së mbetjeve e llogaritur nga krye/infirmieri, që është në kg/pavione.

Lidhur me llogaritjen e kostos së largimit dhe përpunimit të mbetjeve, komisioni nuk ka argumentuar arsyen e largimit të mbetjeve gjatë orëve të natës duke llogaritur dhe pagën shtesë si dhe arsyen për nevojën e e 4 punonjësve për pastrim, dy për ngarkim-shkarkim dhe dy për klorifikimin, kur normalisht procesi i klorifikimit do të kryhet pas shkarkimit të kontenierëve. Nga zbritja e pagës së dy punonjësve si dhe shtesat e pagave për punë nëorët e natës vlera 1,123,000 lekë për dy vitet me tvsh përbën shpenzime ekonomike jo të argumentuara. Vlerësimet e mësipërme janë kryer duke mos u mbështetur në asnjë evidencë të matshme dhe të kontrollueshme **duke shkaktuar shpenzime jo të justifikuara në vlerën 1,123,000 lekë me tvsh** (*Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit*).

4.1-Rekomandime: Të merren masa nga drejtimi i institucionit, që përlllogaritja e vlerave të kontratave të kryhet duke marrë në konsideratë kontrata të ngjashme pune,gjithashtu stafi i ngarkuar për përlllogaritje e fondit limit të verifikoj me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm situatën duke kryer vlerësimet përkatëse për një shfrytëzim me ekonomikitet dhe efijencë të fondeve të buxhetit të shtetit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5.-Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt "Riparim, mirëmbajtje të automjeteve për nevojat spitalore, të spitalit Korçë", për vitin 2017-2018 rezultoi se; Në riparimin e mjeteve u konstatuan shpenzimet riparimi të pa parashikuara në kontratën e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL "TENI KONOMI" KORÇË.

lidhur mes palëve në shumën **335,040 lekë** për vitin 2017, dhe në shumën **111,360 lekë** për vitin 2018, vlerë e cila përbën shpenzime të pa parashikuara për buxhetin e shtetit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Nga auditimi i kontratës me objekt: "Shtesë kontrate për Riparim, mirëmbajtje të automjeteve për nevojat spitalore, të Spitalit Korçë", datë lidhjes së kontratës 22.01.2018 nr. 123 Prot.,, është konstatuar se vlera e kontratës prej **493,104 lekë përbën efekt ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit**, duke mos justifikuar dhe argumentuar arsyen e saj nisur dhe nga fakti i mos qenies në kushtet e emergjencës pasi riparimi i mjeteve të SRK është kryer në muajt nëntor 2017, pra rreth 2 muaj përpara lidhjes së kësaj kontrate shtesë edhe pse këto mjete kryejnë mesatarisht 5000-6000 km në muaj. Veprime këto në kundërshtim me Kreun IX neni 76 Kohëzgjatja e kontratës të VKM 914 datë 29.12.2014 "për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit*).

5.1-Rekomandime: Nga ana e Drejtorit të institucionit të ngrihet një grup pune me specialist të fushës për verifikimin rast pas rasti për secilin mjet nëse këto pajisje janë ndërruar dhe zëvendësuar sipas procesverbaleve të nënshkruar nga palët si dhe të merren masat përkatëse për identifikimin e nevojave reale për shërbimin e mjeteve ose përdorimin e marveshjeve kuadër në riparimin e tyre dhe jo procedurave konkrete me zëra paisjesh të përcaktuara duke lënë të pa mbuluar pjesë të tjera që mund të dëmtohen nisur nga fakti i sasisë së madhe të km të përshkruara nga këto auto-ambulanca.

Deri më 31.12.2019

6.-Gjetje nga auditimi:- Gjatë auditimit të pagesave të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël për evadimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, për periudhat 2017-2018, u konstatua se OE fitues, nuk ka sjellë dokumentacion justifikues, për pjesën e trajtimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore si dhe dokumentacion provues që materialet janë trajtuar sipas ligjeve dhe rregullores në fuqi, veprime në kundërshtim me vendimin Nr. 798, datë 29.9.2010, Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore", kreu II, detyrimet e prodhuesve të mbetjeve spitalore, duke ndikuar në mos pasjen e sigurisë së procesit të trajtimit të mbetjeve, rritjen e riskut të përgjegjësive për **të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre. Vlera 627,000 lekë përbën shpenzime jo të justifikuara nga OE "M."SHPK**(*Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 36-90 të Raportit të Auditimit*).

6.1-Rekomandime: Të merren masa nga drejtimi i institucionit që në zbatim të kushteve, rregullave dhe përgjegjësive që ka prodhuesi i mbetjeve, (Spitali Rajonal, Korçë), duhet të ndjekë deri në fund procesin e asgjësimit, duke marrë evidenca vërtetuese nga kompania e kontraktuar për transportin dhe trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme se operacionet për kryerjen e tyre janë bërë në përputhje me vendimet, standardet dhe rregulloret e aprovuara. Përveç faturës zotëruesi dhe asgjësuesi i mbetjeve duhet të disponojë mënyrën e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, analizat e kampionëve të hirit që përfitohet nga trajtimi i mbetjeve, të kryera sipas kërkesave si dhe të dokumentojë se kjo mbetje e ngurtë është asgjësuar në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 9010, datë 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta".

Menjëherë dhe në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës nr. 17 Prot., datë 07.01.2014 kontratave individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal “Teni Konomi” Korçë që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, si më poshtë:
“Vërejtje me shkrim” për:

1. Zj. R. P.

2. Z. K. N.

3. Zj. A. N.

4. Zj. Z. N.

5. Zj. E. D , në cilësinë e komisionit të kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për arsye se:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit ‘B1 - Blerje barna sistemi anti-infektiv të përgjithshme për nevoja spitalore, ndarë në lotë’ me nr. REF-Nr 86 Prot.,, Datë 17.02.2017 me operator fitues “F.” dhe vlerë kontrate 1,197,900 lekë me afat zbatimi kontrate deri më 15.12.2017, u konstatua se:

Nga auditimi i furnizimeve u konstatua se për disa artikujt nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar cilësia e medikamenteve sipas nenit 4 të kontratë ku citohet: *Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës por në çdo rast jo më e vogël se 12 muaj, nga data e lëvrimit të mallit.*

Nga auditimi i procedurës së prokurimit ‘Blerje Medikamentesh për nevojat Spitalore, Spitali Korçë, e ndarë në lot’ me nr. REF-Nr 286 Prot.,, datë 06.02.2017 me operator fitues “F.” dhe vlerë kontrate 1,720,740 lekë nr. 382 Prot.,, me afat zbatimi kontrate deri më 31.03.2017 u konstatua se:

Si dhe nga auditimi i furnizimeve u konstatua se për disa artikujt nga ana e operatorit ekonomik nuk është respektuar cilësia e medikamenteve sipas nenit 3 të kontratë sku citohet: *Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës por në çdo rast jo më e vogël se 12 muaj.*

6. Zj. E. K.

7. Z. Gj. N.

8. zj. E. M.

9. Z. A. P., në cilësinë e komisionit të pranimit dhe kolaudimit të mallit për arsye se: Në kontratën e furnizimit nr. 955 prot., datë 17.08.2018 midis operatorit ekonomik “O. D.” dhe Spitalit Rajonal Korçë në zbatim të procedurës së prokurimit nr. REF-Nr 376 datë 08.05.2018, kanë pranuar produkte pa asnjë origjinë dëshmuese e vërtetuese për origjinalitetin e tyre, mungesa e tyre në katalogun e produkte të kompanisë prodhuese dhe mos identifikimi të asnjë të dhëne për origjinalitetin e tyre nga prodhuesi i deklaruar në procedurën e prokurimit.

10. z. E. R. në cilësinë e përgjegjësit teknik për arsye se:

Në kontrata shërbimi të mirëmbajtjes së mjeteve nuk disponon dokumentacionin e plotë argumentues dhe justifikues për kryerjen e shpenzimit si dhe në zbatimin e normave të konsumit të karburantit ka shpërndarë më shumë lëndë djegëse naftë sesa normat e miratuara



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN
RAJONAL “TENI KONOMI” KORÇË.

11. Znj. A. D., në cilësinë e Shefes së sektorit të finacës, për arsye se: Në likuidimin e faturave për blerje medikamente në 4 raste nuk ka përllogaritur kamatëvonesat e faturuara deri në momentin e funizimit nga operatorët ekonomik.

12. z. B. H., në cilësinë e juristit të procedurave të prokurimeve, për arsye se:

Në procedurën e prokurimit “blerje pelet për ngrohje” në hartimin e Dokumnetave standarte të tendrit nuk ka respektuar nenin 23 “specifikimet teknike” të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj.

D. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjës të mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Largim nga detyra”, për:

Zj. E. B., me detyrë ish. Drejtor i Spitalit “Teni Konomi”Korçë

Z. I. J., me detyrë ish. Drejtor i spitalit “Teni Konomi”Korçë

F. Të tjera: Në periudhën objekt auditimi në “Spitalin Rajona Korçë” është realizuar dhe kontrata me objekt “Rikonstruksioni i një godine 4 kate dhe shtesë ansësore për zhvendosjen e maternitetit brenda korpusit të Spitalit Korçë” më vlerë 122,825,000 lekë, nisur nga ngarkesa dhe angazhimet audituese, zbatimi i kësaj kontrate nuk është audituar. Duke qenë se dhe vlera e kontratës në raport me investimet në total që ka kryer në vite Spitali Rajonal Korçë është në vlerë të konsiderueshme, zbatimi i saj do të jetë objekt në auditimin e rradhës të këtij institucioni ose në një auditim tematik i cili mund të jete kur të bëhet auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve, apo edhe brenda vitit 2019.

G. Shënim i Kryetarit: Auditimi rezulton me gjetje të dobëta. Përgjatë vitit 2019 duhet të analizohet nga Drejtori i Përgjithshëm , Drejtori i Departamentit dhe Drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Cilësisë.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT